

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		19. 01 2024	
Nj. 000.	Numër	Shtojca	Vlera
01	052/01	3722	



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS



Janar, 2024

Fjala e kryetarit Lladrovci

Të nderuar asambleistë,

Zonja e zotërinj,

Viti 2023, mund të cilësohet si shumë i suksesshëm për komunën tonë dhe me shumë të arritura. Po ashtu, patëm sfida të cilat, shumica prej tyre, nuk ishin në kompetencë as mundësi tonën që t'i rregullojmë.

Në këtë fjalë të shkurtër rasti, dua të falënderoj për bashkëpunim qytetarët, administratorët e fshatrave, asamblastët e të gjitha partive të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës, zyrtarët dhe drejtorët e drejtorive.

Ne i përfundam shumë projekte dhe u përpoqëm, jo vetëm ta realizojmë planin e parashtruar vjetor, por, edhe ta tejkalojmë. Gjithsesi, nuk ishte e lehtë, përkundër vlerësimit si komuna me performancën më të mirë në nivel nacional, disa nga investimet kapitale mbesin në këtë vit të fillojnë e disa të realizohen.

Për disa projekte të rëndësishme, të planifikuara nga niveli qendror, kemi zhvilluar takime të ndryshme si me Kryeministrin, ministrat e dikastereve të caktuara për projektet e përbashkëta, agjencitë, donatorët, të cilët e kanë përgjegjësi dhe vullnet për të kontribuar për projektet tona. Diku kemi pasur sukses e diku jo, por, ne nuk do të ndalemi të promovojmë nevojat tona në dobi të mirëqenies së të gjithë qytetarëve të komunës së Drenasit.

Bashkëpunimi në Kuvend ka ndikim kyç për projekte dhe për këtë, i falënderoj të gjithë asamblastët, duke i përgëzuar për unitet me rastin e votimeve të projekteve në interes të qytetarëve.

Përkundër sfidave, ne, fjalët i bëjmë vepra, dëshmi është ky raport i punës për vitin 2023. Mirëqenia dhe perspektiva e qytetarëve me barazinë para ligjit, mbesin synim yni. Bashkë për Drenasin!

Faleminderit!

Ramiz Lladrovci

Përmbajtja

Fjala e kryetarit Lladrovci.....	2
Zyra e Kryetarit të Komunës.....	5
Zyra për Komunikim me publikun	5
Auditimi i brendshëm, Janar – Dhjetor 2023.....	6
Departamenti Ligjor, Raport pune për vitin 2023	8
Zyra Komunale për Integritet Evropian, Janar-Dhjetor 2023.....	9
Njësia për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Drejtat e Njeriut Barazi Gjinore	12
Zyra për Komunitete dhe Kthim, Raporti i punës për vitin 2023	27
Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore - Raporti Vjetor 2023.....	30
Raport i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023	32
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme, Raport pune për vitin 2023	35
Qendra për Shërbim me qytetarë	35
Sektori i Shërbimeve të Përbashkëta.....	37
Sektori i Arkivit	39
Aktivitete tjera me rëndësi:	40
Drejtoria për Arsim	40
Objektivat, strategjitë dhe aktivitetet për avancimin e procesit arsimor	42
Vizita në institucione arsimore publike	42
Marrëveshjet (realizimi i marrëveshjeve)	43
Organizimi i garave të ndryshme për nxënësit në nivel shkolle	43
Statistikat e vitit shkollor 2022/2023	44
Trajnime, fushata vetëdijesuese - janar-dhjetor 2023	46
Përmbledhje e projekteve kryesore për vitin 2023 në drejtorinë e Arsimit:	47
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Raporti vjetor i punës (janar – dhjetor 2023)	58
Zhvillimi dhe promovimi i turizmit;	69
Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Raport i punës, Janar – Dhjetor 2023	69
Sektori i Buxhetit	71
Sektori i Financave	72
Zyra e Tatimit në Pronë	72
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Raport pune për vitin 2023	73
Numri i shfrytëzuesve të ndihmës sociale sipas muajve	102
Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural - Raporti vjetor për vitin 2023	106

Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Raport i punës për vitin 2023	110
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Raport vjetor i punës - 2023	111
Misioni	111
Sektori i Gjeodezisë	113
Sektori i Kadastrit	115
Sektorit të Pronës	117
Drejtoria për Infrastrukturë Lokale, Raport pune për vitin 2023	118
Projektet kapitale që janë realizuar gjatë vitit 2023:	120
Hartimi i projekteve zbatuese	121
Projektet kapitale të përfituara nga donacionet me bashkëfinancim me komunën e Drenasit	122
Aktivitetet	123
Pengesat dhe vështirësitë	123
Propozimet	124
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	124
Rinia	128
Sporti	129
Përmbledhja e aktiviteteve në objektet sportive Janar- Dhjetor 2023	130
Drejtoria e Inspeksionit, Raporti i punës Janar - Dhjetor 2024	130
Pasqyra e punës në shifra për periudhën janar-dhjetor 2024	131
Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Raporti i punëve të kryera gjatë vitit 2023	137

Zyra e Kryetarit të Komunës

Në periudhën raportuese janar-dhjetor 2023 të Kryetarit, janë regjistruar përmes intranetit të brendshëm (arkivitet aktiv) 2284 lëndë të ndryshme dhe të gjitha janë procesuar me kohë, 324 prej tyre janë dorëzuar në arkivin e Komunës, ndërsa janë kthyer përgjigje të gjithë atyre që kanë adresuar kërkesat përmes intranetit të brendshëm të komunës.

Janë nxjerr 371 vendime të ndryshme, ku ato që kanë pasur karakterin e përgjithshëm, janë publikuar edhe në ueb faqen e Komunës, ndërsa lista e vendimeve mujore, çdo herë është publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës. Po ashtu në ueb faqe të Komunës është publikuar edhe agjenda e kryetarit për takimet.

Zyra e kryetarit ka organizuar dy (2) takime me publikun, sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, për të diskutuar aktivitetet e gjashtëmujorit të parë të vitit raportues dhe gjashtëmujorit të dytë të vitit raportues. Po ashtu janë mbajtur nëntë (9) dëgjime buxhetore, një (1) për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2023-2026 për kërkesat fillestare me qytetarët e Komunës së Drenasi dhe tetë (8) të tjera për investime kapitale.

Po ashtu janë mbajtur edhe 6 mbledhje të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), janë mbajtur edhe 52 mbledhje të Bordit të Drejtorëve, ku janë diskutuar pika të ndryshme dhe për të gjitha është mbajtur proces mbi diskutimet dhe konkluzionet e nxjerra nga mbledhjet, ku secili drejtor në baza javore ka raportuar për aktivitetet, punët dhe angazhimet si dhe janë diskutuar tema të ndryshme.

Të gjitha njoftimet, komunikatat, ftesat dhe dokumentet janë të publikuara në ueb faqen zyrtare të Komunës dhe në rrjetin social Facebook.

Kryetari i Komunës, gjatë vitit raportues, ka pritur në takime delegacione të ndryshme, qytetarë dhe ka vizituar vend punishtet ku janë kryer projektet në komunën e Drenasit. Po ashtu, Kryetari gjatë vitit raportues, ka nënshkruar edhe dy kontrata për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim, pas kalimit me vota të kuvendit dhe ligjshmëria nga MAPL si dhe ka nënshkruar 41 memorandume me ministri të linjës, OJQ dhe ndërmarrje të tjera vendore e ndërkombëtare.

Zyra për Komunikim me publikun

Zyra për Komunikim me Publikun, gjatë periudhës janar-dhjetor 2023, ka përcjellë aktivitetet ditore, javore dhe mujore të Komunës.

Përmes linkut <http://kk.rks-gov.net/glllogoc/>, ueb faqes zyrtare të Komunës, ZKP ka publikuar të gjitha aktivitetet e mbajtura dhe ka publikuar të gjitha vendimet, rregulloret, raportet, projektet, njoftimet, konkurset, njoftimet e zyrës së prokurimit si; kontratat e nënshkruara, njoftimet për anulim, njoftimet për dhënien e kontratave, njoftimet për kontratë, njoftimet për nënshkrimin e kontratave dhe shkresa të tjera në interes të gjithë qytetarëve të Komunës.

Ka mbajtur kontakte të rregullta me media, ku i ka përcjellë njoftime e lajme ditore për aktivitetet e zhvilluara në Komunë, ftesa, reagime etj., ku gjithsejtë ka lëshuar mbi 450

komunikata të karakterit të ndryshëm informues në ueb faqen zyrtare dhe në rrjetin social Facebook.

Ka përcjell agjendën e Kryetarit dhe ka caktuar takime në bashkëpunim me Kryetarin me delegacione të ndryshme nga niveli qendror dhe ai lokal, si dhe më delegacione të ndryshme ndërkombëtare. Në kuadër të kësaj zyre, janë pranuar dhe shqyrtuar edhe kërkesat për qasje në dokumente publike dhe gjatë periudhës raportuese, janë pranuar 45 kërkesa për qasje, 44 prej tyre kanë qenë të qasshme sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe 1 e pjesshme.

Raporti vjetor për qasje në dokumente publike është dërguar në Agjencinë për Informim dhe Privatësi dhe i njëjti është publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës. Ju ka përgjigjur të gjitha OJQ-ve për plotësimin e formularëve të pyetjeve të dërguara dhe kontakti i përhershëm me Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal si dhe me nivele të tjera qeveritare.

Po ashtu ka mbajtur kontakte të rregullta me media dhe i ka kthyer përgjigje të gjitha atyre që janë interesuar për çështjet e Komunës së Drenasit dhe ka dhënë intervista të ndryshme për televizione e portale. Zyra për Komunikim me Publikun kryen edhe punë të tjera sipas përshkrimit të detyrave të secilit punonjës.

Auditimi i brendshëm, Janar – Dhjetor 2023

Auditimi i Brendshëm si Njësi e auditimit në vartësi të drejtpërdrejtë të Udhëheqësit të Subjektit të Sektorit Publik, sipas nenit 19, pika 2.1 të Ligjit nr. 06/L-021 bën Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike në pajtim edhe me Rregulloren QRK, nr. 01/2019.

Kjo Njësi është e përbërë prej dy auditorëve, Drejtorit të Njësisë dhe një Auditor. Kërkesat ligjore janë që ne të kemi së paku edhe një auditor për shkak të buxhetit mbi 23 milion euro dhe për shkak të numrit të personelit prej 1368 punëtorë, mirëpo në mungese të masës buxhetore për paga dhe në mungesë të numrit të certifikuar për punëtorë të rinj, nuk kemi pasur mundësi që ta rrisim numrin e auditorëve. Po ashtu në pajtim me nenin 20 të këtij Ligji është i formuar edhe Komiteti i Auditimit të Brendshëm.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në fund të vitit 2022, ka hartuar dhe aprovuar para Komitetit të Auditimit të Brendshëm Planin Strategjik të zhvillimit të aktiviteteve audituese për vitet 2023 -2025 si dhe duke u bazuar në këtë Plan, ka miratuar edhe Planin vjetor të Punës për vitin 2023.

Me Planin e Punës së kësaj Njësie, për vitin 2023 janë paraparë që të kryhen gjithsej shtatë auditime të rregullta. Njësia e Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2023 ka përbushur në tërësi Planin vjetor të punës duke kryer të gjitha auditimet e parapara me këtë Plan.

Auditimet e kryera kanë pasur për qëllim arritjen e përbushjes së objektivave të parapara me Planin Strategjik të kësaj Njësie për vitet 2023-2025. Ato mund të përmbledhen në këto pika kryesore si:

- ❖ Arritja e një pajtueshmërie të plotë me kornizën ligjore
- ❖ Ruajtja dhe menaxhimi i mirë me buxhetin dhe pasuritë e komunës;

- ❖ Shfrytëzimi më ekonomik i pasurisë komunale dhe rritja e vlerës së kësaj pasurie;
- ❖ Shfrytëzimi më ekonomik i resurseve humane dhe materiale në dispozicion të komunës;
- ❖ Shtimi i sigurisë dhe integritetit të të dhënave të pasqyruara;
- ❖ Rritja e vlerës së burimeve humane dhe materiale; dhe
- ❖ Krijimi i një qeverisje të mirë të bazuar në rrezik.

Të gjitha auditimet e parapara kanë përfunduar me Raporte të shkruara në formën finale. Raportet e finalizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm janë shqyrtuar nga ana e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në katër mbledhjet e rregullta të mbajtura nga ky Komitet dhe janë nxjerrë konkluzionet për hapat që duhet të ndërmerren për jetësimin e rekomandimeve të Auditorit.

Komiteti i Auditimit të Brendshëm ka qenë mjaft aktiv dhe gjatë këtij viti ka mbajtur katër mbledhje të parapara për çdo tremujor sipas ligjit ku ka shqyrtuar dhe miratuar të gjitha raportet e auditimit, Planin vjetor dhe atë strategjik, raportet gjashtëmujore dhe vjetore mbi gjendjen e rekomandimeve të dhëna, si dhe raportin gjashtëmujor dhe atë vjetor të cilët janë dërguar në Ministrinë e Financave, përkatësisht në Njësinë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm.

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka ndërmarrë një qasje gjithëpërfshirëse dhe profesionale për ofrimin e rekomandimeve të dobishme për menaxhmentin e komunës. Aktivitetet e kësaj Njësie ishin në përputhje me detyrat e planifikuara në fillim të vitit në aspektin kohor.

Gjatë auditimeve janë zhvilluar intervista me menaxherët dhe janë shqyrtuar mostra për të identifikuar shkallën e implementimit të rekomandimeve dhe aktivitetet që janë ndërmarra në këtë drejtim.

Fushat e audituara gjatë këtij viti kanë qenë: Auditimi i procesit të menaxhimit me pasuritë jofinanciare të Komunës, Auditimi i proceseve të inkasimit të të hyrave vetanake nga dhënia e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër,

Auditimi i menaxhimit me resurset humane në sektorin e Arsimit, Auditimi i proceseve të inkasimit të të hyrave vetanake në Drejtoratin e Administratës së Përgjithshme, Drejtoratin e Arsimit dhe Drejtoratin e Shëndetësisë, Auditimi i proceseve të shpërndarjes së subvencioneve gjatë vitit 2023, Auditimi i proceseve të prokurimit gjatë vitit 2023, dhe Auditimi i procesit të pagesave/shpenzimeve gjatë vitit 2023.

Gjatë kësaj periudhe janë dhënë një numër i rekomandimeve dhe shumica prej tyre janë implementuar ku janë ndërmarrë një numër i madh i aktiviteteve për adresimin e drejtë të tyre.

Menaxhmenti i komunës ka ndërmarrë gjithsejtë 58 aktivitete konkrete për jetësimin e rekomandimeve edhe përkundër kohës së shkurtër, një numër i madh i rekomandimeve janë përmbushur.

Gjatë kësaj periudhe, Komuna ka pranuar edhe Raportin e rregullt vjetor të auditimit të Pasqyrave Financiare nga Zyra Kombëtare e Auditimit, dhe Raportin e Auditimit të performancës nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Ne falënderojmë të gjithë menaxherët për aktivitetet që kanë ndërmarrë për të implementuar këto rekomandime si dhe inkurajojmë që edhe më tutje të vazhdojnë me aktivitete në përmbushjen e implementimit të rekomandimeve dhe në arritjen e objektivave të përgjithshme të Komunës.

Departamenti Ligjor, Raport pune për vitin 2023

Komuna e Drenasit, përkatësisht, zyrtarët përgjegjës për Departamentin Ligjor në kuadër të Zyrës së Kryetarit në komunën e Drenasit, gjatë vitit 2023, në vazhdimësi janë përpjekur për realizimin e detyrave dhe përgjegjësive që dalin nga kjo pozitë si në aspektin e hartimit të akteve normative si dhe akteve të tjera juridike të cilat dalin nga fushë veprimtaria e Institucionit në bazë të procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi .ashtu edhe në ndërmarrjen e të gjitha veprimeve procedurale për mbrojtjen e interesit pasurorë dhe juridik të Komunës dhe mbikëqyrjen e të gjitha aktiviteteve juridike të procedurave gjyqësore dhe procedurave të tjera të organeve të Institucionit për garantimin e cilësisë dhe pajtueshmërisë. Departamenti ligjor, në vazhdimësi punon drejt krijimit të një sistemi ligjor i cili garanton hartimin e akteve juridike sipas legjislacionit në fuqi, hartimin dhe procesimin e shkresave juridike për lëndët gjyqësore në të cilat Komuna Drenas/Gllogoc, është palë në procedurë si me vetiniciativë ashtu edhe sipas obligimit të dhënë nga gjykata, përmbajtje dhe formë të aktit normativ sa më të saktë si nga aspekti përmbajtjesor ashtu edhe nga aspekti teknik , mendime juridike profesionale dhe rekomandime të tjera në përmbushjen e ligjshmërisë sa i përket organeve komunale si dhe përshtatje të procedurave , teknikave dhe mjeteve materiale me nevojat e fushë veprimtarisë përkatëse.

Gjatë vitit 2023 sa i përket lëndëve të cilat prekin lëmi të ndryshme të të gjitha sektorëve në kuadër të institucionit tonë janë pranuar, shqyrtuar dhe proceduar tutje në organet administrative, gjyqësore apo edhe brenda vet institucionit këto lëndë:

- 163 Përgjigje në padi Pranë Gjykatës Themelore
- 8 përgjigje në Ankesë lidhur me çështje pronësore pranë Gjykatës Themelore
- 3 përgjigje për masë të sigurisë
- 8 Ankesa për në Gjykatën e Apelit
- 1 Revizion për në Gjykatën Supreme
- 122 Seanca Gjyqësore
- 99 Deklarime për seancë
- Mbi 23 parashtresa
- 1.008 Propozime përmbartimore
- 172 prapësime
- Janë inicuar afër 450 procedura përmbartimore nga ana e Institucionit tonë në mesin e të cilave si vazhdimësinë e tyre ka të ndërmarra edhe veprime të tjera të shumta procedurale

Të tjera: Në kuadër të departamentit ligjor, mes tjerash janë kryer edhe hartimi i Detyrimeve Kontigjente, sipas kërkesës së ZKF-së dhe brenda afateve të parapara me ligj pastaj raportimi dhe verifikimi i listave financiare për ekzekutim sa i përket lëndëve gjyqësore nga të cilat edhe rrjedhë detyrimi financiar, realizimi i detyrave në përputhje me politikat e institucionit, me standardet administrative dhe procedurat teknike dhe duke marr parasysh praktikat profesionale si dhe janë dhënë këshilla dhe opinione ligjore në të gjitha rastet që është kërkuar nga ana e Drejtorive përkatëse.

Në këtë drejtim vlen të theksohet se zyrtaret ligjore, me autorizim, kanë qenë të angazhuara edhe në komisione të caktuara qoftë si anëtarë apo kryesues i komisioneve përkatëse varësisht prej kërkesës së mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë më konkretisht sipas kërkesës së ZKA-së e gjithashtu me autorizim kanë kryer punët dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor të Komunës.

Zyra Komunale për Integritet Evropian, Janar-Dhjetor 2023

Zyra Komunale për Integritet Evropian gjatë kësaj periudhe të raportimit Janar- Dhjetor 2023 prioritet kryesor ka qene raportimi në kuadër të Matricës lidhur më obligimet e Komunës nga Agjenda Evropiane, për të cilën kemi raportuar me kohë dhe kemi nxjerrë sfidat që ka komuna dhe kemi njoftuar kryetarin e Komunës zyrat dhe njësit në përmbushjen e tyre, për të cilat kemi raportuar më kohë në MAPL.

ZKIE-Harton dhe miraton plane, projekte dhe ofron shërbime përkatëse në fushën e integritetve evropiane, ofron përkrahje, këshilla dhe ekspertizë profesionale drejtuesve në fushën e integritetit evropian duke marrë parasysh obligimet që dalin nga të gjitha dokumentet strategjike kombëtare rreth integritetit evropian dhe marrëdhëniet në Kosovë, siguron që ndihma e jashtme është e ndërlidhur dhe kontribuon në zbatimin e prioriteteve dhe planeve të institucionit, koordinon dhe konsultohet me institucionet përgjegjëse dhe institucionet e tjera të jashtme përkatëse për fushën e integritetve evropiane me qëllim të harmonizimit të prioriteteve dhe politikave, merr pjesë në përcaktimin dhe planifikimin e aktiviteteve të ministrisë në përputhje me dokumentet strategjike kombëtare për integritet evropian, koordinon dhe bashkëpunon me zyrën e personelit për ngritje të kapaciteteve të stafit për çështjet e ndërlidhura me integritetin evropian, ofron udhëzime për stafin e nivelit më të ultë të njësisë organizative në bërjen e hulumtimeve, përgatitjen e raporteve dhe ofrimin e këshillave rreth çështjeve të integritetve evropiane, duke kontribuar në punën e tyre sipas nevojës monitoron produktet.

ZKIE gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 ka kryer punët dhe detyrat e punës në bazë të planit të punës përshkrimi të detyrave të punës dhe Rregullores Qeverisë 08/2011. Programi Kombëtar për Zbatim të MSA-së që është dokumentet ligjërish i detyrueshëm për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës dhe komuna, ku në nivelin lokal kemi Planin e veprimit të obligimeve të Komunave nga Agjenda Evropiane, Në vazhden e rritjes së efektivitetit dhe efikasitetit të punës së Drejtorive dhe Zyrave në implementimin e obligimeve të komunale, që burojnë nga Agjenda Evropiane gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023. Duke pasur parasysh se Programi Kombëtar i Zbatimit të MSA është dokument ligjërish i detyrueshëm për të gjitha

Institucionet e Kosovës, Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal është e përkushtuar në përmbushjen e obligimeve të komunave që dalin nga Agjenda Evropiane.

Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve, ZKIE ka zhvilluar disa mënyra të adresimit të çështjeve në nivel lokal për të shtyrë para agjendën evropiane, duke veçuar: koordinimin monitorimin dhe raportimin e procesit të planifikimit, e që ka si vijon një nder prioritete të Komunës së Drenasit për vitin 2023.

1. Përmbushja e obligimeve komunale nga Agjenda Evropiane në zbatimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA përfshira e aktiviteteve në koordinimin në hartimin e planit gjithë përfshirës të komunës duke filluar me aktivitetet kryesore të cilat kanë të bëjnë me kriteret politike, kriteret ekonomike dhe standardeve evropiane që kanë të bëjnë edhe më nivelin lokal.

Kriterin I. Të Reforma e Administratës publike Neni 120 i MSA. Forcimi i kapaciteteve të administratës komunale.

2. Adresimi të stafi udhëheqës dhe Zyrës së personelit për identifikimin e nevojave të stafit për ngritje të kapaciteteve (trajnimeve) në fushat përkatëse të Drejtorive dhe përcjellja e tyre të Zyra e Personelit cila ka pasur obligim në, hartimin e programit vjetor të trajnimeve për vitin 2023, të cilin e ka bërë dhe përcjellë në ministrin përkatëse si dhe adresimi edhe kriterëve tjera që janë të ndara në planin gjithëpërfshirës të përmbushjes së obligimeve komunale nga Agjenda Evropiane për vitin 2023

Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi marrë pjesë në konferencën vjetore të organizuar nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale - KLGJ me titull “NJË DEKADË E GJYSMË NGA DECENTRALIZIMI - momentet kyçe dhe perspektiva” me datë: 13 mars 2023, në KLAN Arena Prishtinë Në prezencën e përfaqësuesve nga vendi dhe rajoni i institucioneve qendrore, komunave, donatorëve, partnerëve zhvillimorë, shoqërisë civile, ku paraqiten arritjet, sfidat dhe perspektiva e qeverisjes lokale, në tri dimensione kyçe të qeverisjes lokale:

- Zhvillimet, Trendët dhe Perspektiva e Qeverisjes Lokale - sfidat, arritjet dhe perspektiva e qeverisjes lokale në Kosovë, si dhe vendoset fokusi për të krijuar sinergji të akterëve për të ndjekur trendët bashkëkohorë dhe avancuar perspektivën evropiane në Komuna.
- Përkrahja e Qendrës për Zhvillimet Komunale - do të trajtohet niveli i përkrahjes së qendrës për zhvillim të komunave, si dhe roli i komunave në përmbushjen e agjendës shtetërore dhe integrimin evropian;
- Partnerët zhvillimorë dhe Agjenda e përbashkët për komunat - do të reflektohet nevoja për konsolidimin e mekanizmit për koordinimin dhe konsultimin me partnerët zhvillimorë në agjendën e përbashkët për komunat.

Kjo datë konsiston edhe me 15-vjetorin e themelimit të Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale, me këtë rast, u prezantua edhe perspektiva e KLGJ për qeverisjen lokale. Në një moment ceremonial, ku u certifikua gjenerata e nëntë (IX) e programit të avancuar trajnues “Akademia për Qeverisje Lokale” si dhe do vazhdoj të mirëpres gjeneratën e dhjetë (X) të këtij programi. Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ) u është përkushtuar analizave dhe studimeve që i kontribuojnë praktikave efektive të qeverisjes lokale në Kosovë. KLGJ nëpërmjet programeve punon në ngritjen e kapaciteteve të komunave të vendit.

Po ashtu kemi marrë pjesë edhe në punëtorin e përbashkët që u mbajt në Prishtinë më dt. 29.05.2023 me MAPL-në, OSBE-në dhe ZKIE, me qëllimin e prezantimit të raportit të përmbushjes së obligimeve nga agjenda evropiane Janar- Dhjetor 2022 si dhe rishikimit të planit gjithëpërfshirës të komunave me obligimet e Agjendës Evropiane për vitin 2023.

Kemi marrë pjesë edhe në trajnimin për mbrojtjen e të dhënave personale që u mbajt më dt.14 dhe 15 mars 2023, kemi marrë pjesë edhe në Komisionin për Ri integrim të personave të Riatdhesuar si pas vendimit të kryetarit dhe kemi kryer edhe punët tjera në DSHPE.

Më dt.10.06.2023 kemi pranuar kërkesën nga MAPL-ja për raportimin e përmbushjes së obligimeve komunale nga Agjenda Evropiane për periudhën Janar-Qershor 2023 e që kemi raportuar më kohë dt.30.06.2023. Nder aktivitetet tjera që vlen te potencohet se komuna e Drenasit ka dhënë pëlqimin më dt. 23 tetor 2023 të kërkuar nga Zyra e Kryeministrit-IE në, për mbajtjen e fushatës për vetëdijesimin e qytetarëve për liberalizimin e vizave i cili do filloi nga 1 janari i vitit 2024 të cilën fushat e ka mbajtur në një ka sheshet e komunës së Drenasit.

Në bazë të ftesës së odes ekonomike Gjermano-Kosovare në Prishtinë të dt.06.12.2023 u mbajt konferenca mbi ndikimin e liberalizimit të vizave: sfidat dhe mundësit për bizneset nga Kosova ku morën pjesë përfaqësues nga Oda ekonomike Gjermane, Zyra e BE-së, IOM, Riinvest të Institucioneve Qendrore, e lokale, përfaqësues të bizneseve e Shoqëria Civile dhe pati prezantime dhe diskutime lidhur më këtë proces.

Kemi marrë pjesë edhe në punëtorin e organizuar nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ) në bashkëpunim me MAPL ku trajtuan të gjeturat nga Raporti i Komisionit Evropian për vendin Kosovën dhe qeverisjen lokale që u mbajt në Prishtinë më 08.12.2023.

Po ashtu kemi marrë pjesë në punëtorin dhe vizitën Studimore(20-22 Dhjetor 2023) që u mbajta në Republikën e Shqipërisë. Kjo punëtori u organizua nga Asociacioni i Komunave të Kosovës ku morëm pjesë ZKIE të Komunave të Kosovës, disa Drejtor të Zhvillimit Ekonomik, përfaqësuesi i AAK-së në, kuadër të koordinimit të objektivave dhe aktiviteteve, në punëtorinë/vizitë studimore në shkëmbimin e përvojave dhe mësimave të nxjerra nga Bashkitë Durrës dhe Lezhë në përmbushjen e detyrimeve të procesit të integritimit në BE. Shqyrtimi i praktikave të mira dhe mundësive të financimit nga programe dhe instrumente të ndryshme të BE-së, mësimet e nxjerra në përgatitjen e suksesshme të projekteve duke përfshirë fonde të tjera në dispozicion.

Po ashtu kemi marr pjesë në punëtorin një ditore lidhur me “Zbatimi në Praktikë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” që u mbajt më dt.17.11.2023 në Prishtinë.

Kjo punëtori u organizua nga Agjencia për Informim dhe Privatësi në kuadër të mandatit të saj ligjor për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në përkrahje të misionit të OSBE-së në Kosovë me temë “Zbatimi në Praktikë i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” me fokus përpunimi i të dhënave personale të fëmijëve i cili u mbajt në regjionin e Prishtinës, ku morëm pjesë edhe Komuna e Drenasit, ZMDHP, Dy zyrtar nga DKA, dy përfaqësues të kopshteve publike dhe private. Moduli i punëtorisë është përshtatur për detyrat dhe obligimet e pozitës që mbajnë zyrtarët, me qëllim që secili nga pjesëmarrësit të këtë informacione, sqarime dhe njohuri të reja lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale.

Më dt.18.12.2023 kemi pranuar kërkesën mënr.02.985 nga MAPL për dorëzimin e raportit vjetor lidhur me përmbushjen e obligimeve komunale nga agjenda Evropiane për periudhën Janar-Dhjetor 2023, bazuara në Programin Kombëtar të MSA-së, të cilin pas një koordinimi të mirë të punëve me stafin udhëheqës të komunës së Drenasit kemi arritur që të raportojmë me kohë në MAPL e cila është kompetente për vlerësimin e tij.

Prandaj duke pasur parasysh se procesi integrimi evropiane janë një nder prioritete kryesore të Qeverisë dhe të komunave, ndërsa përmbushja e tyre janë obligimet e tona të përbashkëta e të gjitha institucioneve, ku për vlerësimin e tyre e bënë Komisioni Evropian që del më raportin për të arriturat ngecjet dhe sfidat që dalin në përmbushjen e tyre.

Njësia për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Drejtat e Njeriut Barazi Gjinore

Njësia për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Drejta të Njeriut paraqet raportin e punës për periudhën janar – Dhjetor 2023, ku pasqyrohet komplimentimi i ligjeve që janë në funksion të të drejtave të njeriut si dhe aktiviteteve të Njesisë për të Drejta të Njeriut dhe Zyrtares për Barazi Gjinore.

Në raport janë prezantuar aktivitetet, të dhënat dhe shënimet që pasqyrojnë dhe reflektojnë angazhimin dhe rezultatet e shënuara për vitin 2023, në kontekst të të drejtave të njeriut, Barazisë Gjinore nga sektorë të ndryshëm të institucioneve komunale. Raporti pasqyron implementimin e ligjeve vendore që janë në funksion të të drejtave të njeriut, por edhe konventave ndërkombëtare që zbatohen drejtpërdrejtë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Nga ky raport, ndërtojmë rekomandimet e reja për përfshirjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në të gjitha sferat shoqërore, respektimin e plotë publik mbi të drejtat e qytetarëve si dhe ngritjen e nivelit të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, duke përfshirë fëmijët dhe të rinjtë në mënyrë që të gjithë qytetarët e komunës së Drenasit të kenë qasje të barabartë në shërbimet cilësore publike.

Koordinatorja e Njesisë Komonale për Mbrojtje nga Diskriminimi të Drejtat e Njeriut dhe Zyrtare për Barazi Gjinore

Koordinon, udhëheqë dhe mbikëqyrë politikat në komunë në fushën e të drejtave të njeriut duke përfshirë respektimin e politikave mbi barazinë gjinore, të drejtave të komuniteteve, përdorimi i gjuhëve, mundësitë e barabarta, zbatimin e politikave për personat me aftësi të kufizuara, të drejtave të fëmijëve, kundër – diskriminimin dhe antitrafikimin.

KNJKDNJ është përgjegjës për implementimin e politikave anti – diskriminuese në komunë, ashtu siç është e paraparë me Ligjin Kundër Diskriminimin, ligjet tjera vendore dhe ato ndërkombëtare, të cilat promovojnë respektimin e të drejtave të njeriut.

Udhëheqë programin e komunës për barazi gjinore, duke siguruar se funksionet ekzekutive të komunës dhe zyret tjera relevante, mbështesin politikat dhe strategjitë për implementimin e Ligjit për Barazi Gjinore, procedurat e Mundësive të Barabarta dhe Personat me aftësi të kufizuara, sipas legjislacionit vendor dhe atij ndërkombëtar, për të drejtat e njeriut, si dhe monitoron zbatimin e ligjeve që sanksionojnë trafikimin me qenie njerëzore.

Zyrtar për komunitete, komuna jonë nuk e ka. Këtë zyrtar në kuadër të njësitit por ekziston zyrtari si zyrë e veçantë për komunitete, ku trajtohen vetëm rastet e riatdhesimit emigrant të kthyer nga diaspora, të gjithë shqiptar dhe s’ka komunitete tjera. 10-dhjetë persona të riintegruar, ku gjatë vitit 2023, janë kthyer 15 -pesëmbëdhjetë persona, 11 M dhe 4 F, gjatë vitit 2023, përfitues të plan bizneseve janë 6 persona meshkuj, ndërsa 1-një është përfitues i asistencës sociale, asnjë përfitues i pensionit invalidor, dhe 1 një familje renovim.

Barazia Gjinore

Koncepti i diskriminimit në bazë të gjinisë përfshinë dallimin në trajtimin, përjashtimin apo kufizimin në bazë të gjinisë, që me atë rast e rrezikon apo parandalon gëzimin ose ushtrimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në politikë, shoqëri, kulturë apo fusha tjera. Çfarë do dallimi në trajtim është diskriminues vetëm atëherë kur nuk ka ndonjë arsytim objektiv apo të arsyeshëm. Barazinë gjinore e garanton edhe dokumenti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton barazi gjinore, dhe e ndëshkon diskriminimin gjinor. Përveç kësaj, në Kushtetutën e Republikës së Kosovës zbatohet drejtpërdrejtë edhe Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW).

Të gjitha institucionet në Kosovë janë të obliguara që të zbatojnë instrumentet ndërkombëtare që zbatohen në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Njësia për MD dhe Drejtat të Njeriut, gjatë e vitit 2023, ka qenë e përqendruar në rastet e diskriminimit në bazë të gjinisë, dhe ka qenë mjaft e angazhuar për të ndikuar në politikat dhe proceset që e promovojnë analizimin, parandalimin dhe mbikëqyrjen e shkeljeve të të drejtave të njeriut në bazë të gjinisë.

Çështja kryesore në lidhje me implementimin e Ligjit për Barazi Gjinore, po ashtu dhe rregulloren për Barazi Gjinore, është fakti se shumë faktorë që rrjedhin nga ligjet dhe traditat e lashta, si dhe problemet me të cilat përballet shoqëria, krijojnë shumë pengesa për zbatimin e drejtë dhe të duhur të këtij Ligji dhe parimeve që i përmban Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas.

Mirëpo, megjithatë gjendja e barazisë gjinore nuk është e njëjtë nëpër të gjitha lokalitetet e komunës në lidhje me përkatësinë gjinore dhe për një shpërputhje të fuqishme gjinore në vendimmarrje, në të gjitha nivelet e hartimit, menaxhimit dhe administrimit të politikave, ku pozicioni i grave (që në numër) dhe si rrjedhojë trajtimi i nevojave specifike të tyre dhe përpjekjet për plotësimin e interesave strategjike të tyre, është i dobët.

-Meshkujt më tepër dominojnë në pozitat vendimmarrëse, ku ne këtë ne bazë të statistikave si vijon:

Sektori	Femra	Mes hkuj	Nr. i tërësishëm
Administrata	70	116	186, me staf politik, zjarrfikës
Zjarrfikës		17	17, gjithsej me shefin
shef		1	
Shefa në administrata-----	10	19	29
Drejtor Komunë-----	5	6	11

Staf politik në zyrën e Kryetarit janë.(Nënkryetari 1, shef kabinet 1)	2	5	7 (2 asistente, 2 këshilltar politik, 1 shofer)
Arsimi të punësuar në 33 shkolla Drejtorë/e shkolle, Drejtor Çerdheje---- Zëvendës drejtor	415 10	529 23 2	944(arsimtar, drejtor dhe stafi mbështetës) 33, shkolla dhe çerdhe 2
Shëndetësia Drejtor QKMF----- Shefa në QKMF QPS----- Drejtor QPS----- Shefa-----	130 10 6 0 1	50 1 10 8 1 0	180 (me drejtorin e QKMF) 20 14-total me drejtor
Gjithsej	621	703	1324, gjithsej të punësuar

- Gjithsejtë te punësuar staf civil janë 1324, prej tyre 621 F, 703 M.

-Shefa gjithsejtë 21 F, dhe 31 M, gjithsejtë 52.

- Prej tyre poste vendimmarrëse; 33-drejtor të shkollave, 2-zavendesdrejtor, 1- drejtor QKMF, 1-drejtor QPS, 11-drejtor Komunal, gjithsejtë 48, prej tyre 15, F drejtoresha, 33 M.

-Numri i pronareve femra me llojin e së drejtës Posedim i Përbashkët /Pronësi e Përbashkët kanë fituar gjatë vitit 2023, gjithsej 137, Femra, ndërsa tani aktive janë vetëm 137, që i bie se 13 e kanë humbur të drejtën gjatë këtij viti.

-Një fenomen që diskriminon femrën në shoqëri, është edhe dhuna në familje. Dhunë në familje gjatë vitit 2023, janë 61, prej tyre 54, raste kanë qenë dhunë fizike, ndërsa 7 raste kanë qenë dhunë psikike emocionale ekonomike, dhunë seksuale - nuk ka pasur nga QPS.

Anti Trafikimi me qenie njerëzore

Sa i përket kësaj fushe, Anti Trafikimi me qenie njerëzore, gjatë vitit 2023, kanë qenë 3 raste të gjithë të mitur.

Të Drejtat e Fëmijëve

Të drejtat civile, ekonomike, sociale, kulturore dhe politike të fëmijëve duhet të mbrohen me përparësi nga çdo individ, familje dhe institucion, sepse kemi të bëjmë jo vetëm me qenie njerëzore përgjithësisht të pambrojtura, por edhe se niveli i sotëm i zhvillimit të tyre fizik e mendor, do të përcaktojë gjithsesi të nesërmen e vendit tonë.

Nisur nga ky vlerësim, Komuna e Drenasit ka marrë disa nga masat e nevojshme në përputhje me dispozitat e Konventës, por edhe për shndërrimin e dokumenteve vendore dhe atyre ndërkombëtare në aksion komunal dhe detyruet për të gjitha institucionet komunale.

Ndër të arriturat gjatë periudhës të cilën raportojmë, në fushën e të drejtave të fëmijëve do të veçonim: sensibilizimin dhe vetëdijesimin, informimin, edukimin dhe arsimimin.

Sipas sistemit SMIA -MASHTI në Komunën e Drenasit, numri i nxënësve për vitin shkollor 2022/2023 është 10899, në SHFMU numri i nxënësve gjithsej është 8668, prej tyre femra janë 4510 dhe meshkuj janë 4158.

Në nivelin arsimor 3 (arsimin e mesëm të lartë klasën e dymbëdhjetë (12) e kanë përfunduar 712, (385 F dhe 327 M).

Si e arritur gjatë këtyre muajve është se nuk ka pasur asnjë përlëshje tek nxënësit lidhur me dhunën e fëmijëve në shkolla.

Mundësitë e Barabarta dhe Kundër diskriminimi

KNJKDNJ, ZBGJ dhe MB, prej muajit nëntor 2023, është pjesë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashki në bazë të UA.nr.27/2012 MPB 03/2012 MAPL.

Sa i përket shërbimeve për qytetarë nga institucionet komunale, NJKDNJ, shpeshherë ka vëzhguar sektorë të ndryshëm dhe nga ky vëzhgim konstatohet se të gjithë qytetarët kanë qasje të barabarta, pasi që në periudhën të cilën raportohet vërehet dukshëm përmirësimi i kushteve për shërbimet ndaj qytetarëve, duke u nisur nga Sektori I Gjendjes Civile, si dhe efikasitetit më të madh të punës nga shërbyesit civil.

Sa i përket sferës së punësimit në sektorin privat, nga intervistat e drejtpërdrejta me disa punëtorë pothuaj se në shumicën e subjekteve afariste punëtorëve u shkelen të drejtat në punë. Ata nuk pajisen me kontrata të punës, nuk kanë orar të punës sipas ligjeve në fuqi, me përjashtim të një numri të vogël të bizneseve.

Nuk u lejohet që të shfrytëzojnë pushimet vjetore dhe të tjera sipas ligjeve në fuqi, mirëpo vetëm ashtu si vendosin menaxherët e tyre.

Vërehet se në komunën e Drenasit ashtu si edhe në tërë vendin është më se prezente papunësia.

Të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Krijimi i një mjedisi shoqëror i cili do të sigurote për respekt të gjitha të drejtat njerëzore të personave me aftësi të kufizuar dhe zbatimin e standardeve të OKB-së në mundësi të barabarta për të gjithë personat me aftësi të kufizuar, përmes mbështetjes psiko-sociale të të gjithë personave me forma të ndryshme dhe anëtarët e familjeve të tyre, janë kushte për krijimin dhe zhvillimin e një shoqërie demokratike dhe njerëzore.

Një shoqëri e tillë është e detyruar të sigurojë për personat me aftësi të kufizuar një mundësi për integrim të plotë dhe të drejta të barabarta si të gjithë qytetarët tjerë.

Të dhënat dhe njohuritë statistikore për pozitën e personave me aftësi të kufizuara janë të pakta. Aktualisht ato reduktohen në numrin e personave me aftësi të kufizuara, ndarjen e grupmoshave në baza gjinore .

Sa i përket analizës së pjesshme të PAK-ve, nga tregues statistikorë janë gjithsej të evidentuar 1250 persona me aftësi të kufizuara fizike, 40% F, 60% M, ndërsa janë 30 % Fëmijë. Sa i përket personave me aftësi të kufizuar mendore, në komunën e Drenasit nuk kemi evidencë, gjithashtu edhe i personave të verbër dhe shurdhmemec. Nga takimet që kemi pasur me komunitetin e personave me aftësi të kufizuara, vërehej se ata vuajnë nga përjashtimi dhe diskriminimi në shoqëri.

Në komunën e Drenasit ka të evidentuar më se 83- fëmijë me aftësi të kufizuara të cilët ndjekin mësimin e rregullt, prej tyre 38-M, dhe 45 F, prej tyre 6-fëmijë janë në Çerdhen Ardhmëria në Drenas dhe 3-fëmijë Komoran, gjithsej 9-Fëmijë. Disa nga prindërit e fëmijëve deklarojnë se jetojnë në një gjendje tejte të vështirë ekonomike dhe është e pamundur për ta sigurojnë shkollimin e fëmijës.

PAK-të, përballen me probleme të shumta, për shumicën e njerëzve me Aftësi të Kufizuar mjedisi i ndërtuar është i papërshtatshëm për lëvizje dhe në këtë mënyrë u pamundësohet pjesëmarrja në jetën ekonomike, sociale dhe në kryerjen e shërbimeve të përditshme.

Komuniteti i personave me aftësi të kufizuara është pjesë e natyrshme e shoqërisë, ndërsa obligim i institucioneve komunale, në veçanti ata që janë kompetent në hartimin dhe implementimin e politikave dhe projekteve, një kujdes të konsiderueshëm t'u kushtojnë njerëzve me aftësi të kufizuara, për t'u krijuar mundësi të barabartë dhe qasje pa pengesa në të gjitha objektet e infrastrukturës publike dhe private.

Përmbledhje e Aktiviteteve të Njesisë për MD dhe të Drejtat e Njeriut për

periudhën Janar – Dhjetor 2023

-Njësia komunale për MD dhe të Drejtat e Njeriut, për periudhën Janar – Dhjetor 2023, në version të shkurtër paraqet disa nga aktivitetet: Ku ne bazë te plan-programit me arsyetim te projekteve qe i kemi bërë sipas kushteve dhe mundësive te buxhetit që ka komuna jonë.

Me datën 20.01.2023, kam përpiluar raportin vjetor të punës për vitin 2022, me nr. Pr.02-052/01-4313, prej gjashtëmbëdhjetë faqeve.

- Me rastin e “8 Marsit-Ditës Ndërkombëtare të Gruas-Femrës”, Zyrtarja për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Grupin e Grave Asambleiste, vizituan Qendrën për Promovimin e të Drejtave të Grave,(QPDG), ku u pritëm nga Drejtoresha e kësaj qendre, Kadire Tahiraj. Gjatë kësaj vizite u njoftuam rreth punës së grave anëtare të kësaj qendre, u diskutua për sfidat në të cilat kanë hasur gratë gjatë rrugëtimit të tyre, të arriturat dhe kontributi i grave në shoqëri. Gjatë vizitës në këtë qendër grave ju premtuam se do ta kenë në vazhdimësi përkrahjen nga Komuna se do ta kenë në realizimin e projekteve të grave. Gjithashtu vizituam (QEAP) Çerdhen Ardhmëria ku u pritëm nga ushtruesja e detyrës së drejtoreshës, Shpresa Osmani me të gjithë stafin ju uruam festen me nga një trëndafil, u njoftuam me kushtet e qëndrimit të fëmijëve, aktivitetet që zhvillohen me fëmijë, të arriturat e tyre dhe sfidat. Vizitat i vazhduam dhe QKMF- Qendrën e Mjekësisë Familjare ku u pritëm nga motra Kryesore Afërdita Krasniqi me një grup të motrave ku u njoftuam rreth shërbimeve që ju bëhen qytetarëve konkretisht grave. U njoftuam me mungesën e medikamenteve dhe sfidat e ndryshme. Gjithashtu ZBGj,ka kontaktuar me të gjitha zyrtarët në Administratën Komunale. Për të gjitha grat shpërndam nga një lule, ua uruam festën. Gjatë këtyre takimeve u diskutua për pengesat në të cilat kanë hasur gratë gjatë rrugëtimit të tyre, të arriturat dhe kontributi i grave në shoqëri.

Foto e takimit në Qendrën për Promovimin e të Drejtave të Grave më 8.3.2023.

-Me datën 9.3.2023, kemi përpiluar raportin për aktivitetin e “8 Marsit-Ditës Ndërkombëtare të Gruas-Femrës”, me nr.pr. 02-053/01-12263.

-Me datën 13. 4.2023, Kryetari i Komunës ka nxjerrë Vendimin për të themeluar dhe Funksionimin e Ekipin për të Drejta të Fëmijëve, në nivel Komunal, me protokollin Nr. 01-030/01-17622.

Me datën 5.5.2023, kemi mbajtur mbledhjen konstituive të Ekipit për të Drejta të Fëmijëve. Jemi në përpilim të Planit të punës së Ekipit për të Drejta të Fëmijëve.

- Me datën 18.5.2023, Raport për mbajtjen e trajnimit për Parandalimin dhe trajtimin e rasteve të ngacmimit seksual në vendin e punës” të mbajtur në Komunën e Drenasit, në Sallën e Kuvendit. Koordinatorja e NJKDNJ, Zyrtarja për Barazi Gjinore, në bashkëpunim me Agjensionin për Barazi Gjinore/ ZKM dhe Institutin I Kosovës për Administratë Publike (IKAP), dhe me mbështetje të asistencës teknike UN Women ka organizuar trajnimin një ditor “Parandalimin dhe trajtimin e rasteve të ngacmimit seksual në vendin e Punës”, për Drejtor të drejtorive Komunale për zyrtar komunal dhe drejtor e psikolog të SHFMU të Komunës së Drenasit. Temat të cilat u trajtuan në trajnim për “Parandalimin dhe trajtimin e rasteve të ngacmimit seksual në vendin e punës” ishin: Definimi i ngacmimeve seksuale dhe sfidat e ballafaqimit me ato, Rastet e studimit, Zinxhiri i menaxhimit të rasteve të ngacmimit seksual, Adresimi i rasteve të studimit. U prezantuan format e ngacmimit seksual, politikat kundër ngacmimit seksual në organet e Administratës Publike, krijimi i një kulture të respektit brenda Vendit të Punës, zinxhiri i menaxhimit të rasteve të ngacmimit seksual, etj. Trajnimi ishte mirë i organizuar sipas vlerësimit nga trajneri dhe pjesëmarrësit, lirshëm pyesnin dhe shprehnin mendimet e tyre. Gjatë trajnimit, pati debate nga pjesëmarrësit dhe shembuj të ndryshëm si trajtohen rastet e ngacmimit seksual në vendin e punës, në shkolla jashtë orarit.

Trajnere ishte Brikena Avdyli, nga ABGJ, Ishte Leonora Selmani dhe Shpresa Zariqi.

Pjesëmarrës në Trajnim ishin 26- njëzetë e gjashtë veta prej tyre 8 M dhe 18 F, sipas nënshkrimeve të pjesëmarrësve dhe 2F nga ABGJ, trajnerja dhe KNJDNJ, ZBGJ dhe MB.

-Raport për mbajtjen e trajnimit për Parandalimin dhe trajtimin e rasteve të ngacmimit seksual Nr.01-052/03-23942, dt. 19.5.2023.

- Më 9.6.2023, kemi përpiluar procesverbalin e mbledhjes konstituive të Ekipit për të Drejta të Fëmijëve me nr. protokollin 01-060/04-27689.

Me datën 17.07.2023, kam dorëzuar të përfunduar në MAPL dhe ABGJ, raportin gjashtëmujor të punës me protokollin 01.-052-34350.

Me datën 28.7.2023, kemi mbajtur mbledhjen e dytë të Ekipit për të Drejta të Fëmijëve. Jemi në përpilim të Planit të punës së Ekipit për të Drejta të Fëmijëve.

- Me 23.08.2023, kemi përpiluar procesverbalin e mbledhjes konstituive të Ekipit për të Drejta të Fëmijëve me nr. protokolli 01-060/04-41932.

Me 28.09.2023, kemi bërë njoftimin me shkrim për organizimin e Fushatës në kuadër të Ditës Ndërkombëtare Kundër Kancerit të Gjirit për muajin Tetor me nr.pr.01-070/03-48506.

Me datën 02.10.2023, kemi bere hapjen e fushatës kundër kancerit të gjirit për muajin Tetor, i cili njihet ndryshe edhe muaji rozë kundër kancerit të gjirit. KNJKDNJ,ZBGJ- në bashkëpunim me drejtorinë e shëndetësisë, drejtoresha Lumnije Krapë, GGA-kryetarja Valentina Gashi Leku, nënkryetari i Komunës Arben Shala, maturantët e mjekësisë të SHMP “Fehmi Lladrovci”, dhe zyrtar tjerë, bëmë hapjen e fushatës kundër kancerit të gjirit. Vizituam QKMF-në, QPS-në, Shoqatën e grave QPDG. Gjatë vizitave kemi bërë shpërndarjen e fletëpalosjeve, pastërve dhe ngjitjen e kordeles rozë. Vet organizimi i fushatës gjat muajt Tetor le të shërbejë si shtytje e të gjitha grave për një kontroll dhe diagnostifikim sa më të hershëm, në mënyrë që të kenë efektin pozitiv për shërimin e kësaj sëmundje. Foto para objektit të Komunës Drenas me grupin. 02.10.2023.

Në vizitë tekë QKMF “Dr. Hafir Shala”, na prit drejtori i QKMF-së Ismet Bogiqi, ku fjalën për hapje së fushatës e mori Nënkryetari Arben Shala dhe disa nga sqarimet drejtoresha Lumnije Krapë. Drejtori i QKMF-së shprehi gatishmëri për përkrahjen informimin, sensibilizimin e muajit Tetor kundër sëmundjes së Kancerit të Gjirit. Gjithashtu sqarime rreth sëmundjes dhe vizitave të pacienteve foli dhe radiologu Dr. Shkëlzen Gashi. Në vizitë tek QPS na prit drejtori i Qendrës Elmi Dobra, ku fjalën për hapje së fushatës e mori Nënkryetari Arben Shala dhe disa nga sqarimet drejtoresha Lumnije Krapë. Drejtori i QPS shprehi gatishmëri për përkrahjen kundër sëmundjes së Kancerit të Gjirit. Gjatë vizitës në QPDG, drejtoresha e kësaj qendre Kadire Tahiraj kërkoi masë afirmative për të gjitha gratë që të lirohen nga taksa një euro gjatë muajt Tetor për ekzaminimin e sëmundjes së kancerit të gjirit.

Me datën 03.10.2023, kemi punuar raportin e hapjes së fushatës kundër kancerit të gjirit për muajin Tetor, i cili njihet ndryshe edhe muaji rozë kundër kancerit të gjirit nr.pr.01-052/01-49210.

Me datën 04.10.2023, kemi punuar njoftimin për agjendën për muajin Tetor 2023, nr.pr.01-070/03-49518.

Me datën 6.10.2023, kemi mbajtur takim me personelin shëndetësor në sallën e QKMF-së, në Drenas, kundër kancerit të gjirit për muajin Tetor, i cili njihet ndryshe edhe muaji rozë kundër kancerit të gjirit. Nga radiologu Dr. Shkëlzen Gashi për personelin shëndetësor u mbajt ligjëratë me temë “Kanceri i Gjirit dhe parandalimi i tij”. Vet organizimi i fushatës gjatë muajt Tetor, le të shërbejë si shtytje e të gjitha grave për një kontroll dhe diagnostifikim sa më të hershëm, në mënyrë që të kenë efektin pozitiv për shërimin e kësaj sëmundje. Aktivitetet gjatë këtij muaji do të arrijmë që ta përcjellim mesazhin gjithë qytetarëve të komunës së Drenasit, për rrezikun nga kanceri i gjirit dhe domosdoshmërinë që kjo sëmundje të zbulohet sa më herët. Gjithashtu doktori dha sqarime rreth sëmundjes dhe vizitave të pacienteve se si duhet të këshillohen për

kontroll të ekzaminimeve të sëmundjeve nga kanceri në përgjithësi. Foto e takimit me personelin shëndetësor në QKMF në Drenas, më 6.10.2023.

Pjesëmarrës ishin gjithsejtë 35-tridhjetepesë veta, me doktorin si ligjërues, i cili nuk është i nënshkruar në listë, prej tyre 26 F dhe 9 M.

Me datën 9.10.2023, kemi punuar raportin e takimit me personelin shëndetësor në sallën e QKMF-së, në Drenas, kundër kancerit të gjirit për muajin Tetor, nr.pr.01-052/03-50204.

Me datën 11.10.2023, kemi bërë kërkesën për pagës të pastër dhe fletëpalosje zyrës së Kryetarit, DAP, DKRS, zyrës së Kuvendit nr.pr.01-400/01-50597.

- Me datën 16.10.2023, kemi bërë njoftimin hapjen e fushatës kundër kancerit të gjirit për muajin Tetor, i cili njihet ndryshe edhe muaji rozë kundër kancerit të gjirit, nr.pr.01-070/01-51392

- Me datën 17.10.2023, kemi bërë ftesën Kampanjën-fushatës kundër kancerit të gjirit 24. Tetor 2023, në nivel Komunal në Drenas, nr.pr.01-060/03-51599.

- Me datën 17.10.2023, kemi bërë raportin për Avokatin e popullit me statistika në bazë gjinore.

-Me datën 18.10.2023, kemi bërë hapjen e Fushatës kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore e cila ka filluar nga 18 Tetori dhe vazhdon deri më 17 Nëntor, 2023, dhe vazhdon me aktivitete përkatëse pas fushatës.

Me rastin e muajit tetor, i cili konsiderohet si Muaji Ndërkombëtar në Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut (NJKDNJ) pranë Zyrës së Kryetarit, në bashkëpunim me drejtorinë e Arsimit dhe Qendrën për Punë Sociale, Policinë e Kosovës, Njësia në Drenas ka përgatitur aktivitete nga më të ndryshmet sa i përket Parandalimit të Trafikimit me Qenie Njerëzore me moton:“ TRAFIKIMI PREKË TË GJITHË! TA MBROJMË VETËN DHE FËMIJËT TANË! MOS HESHT! PARANDALO TRAFIKIMIN ME NJERËZ"

Me rastin e kësaj fushate Koordinatorja e NJKDNJ-së, ZBGJ, në bashkëpunim me drejtorinë e Arsimit dhe Qendrën për Punë Sociale, ka shpërnda poster dhe fletëpalosje nëpër institucione të shtetit në Objektin e Komunës, në Entin e Punësimit, në njësinë e Policisë në Drenas, në Kopshtin Ardhmëria, në SHFMU “Rasim Kiqina”, në SHFMU “Ali Gashi”, në Çikatovë e Re dhe SHFMU “Halil Bajraktari”, Drenas II, në SHMP “Fehmi Lladrovci”, në SHML “GJ. K. Skënderbeu”, SHFMU “Gani Sylaj”, në Poklek të Ri. Foto në SHM “GJ. K. Skenderbeu” Poklek i ri. 18.10.2023

Në shpërndarje të materialeve e kemi bërë me zyrtaren nga Qendra për Punë Sociale, psikologen - Arjana Isufi dhe zyrtaren nga administrata- Leonora Shala.

Shpërndarjen e posterëve dhe fletushkave në shkolla fillore tjera e bëjmë edhe përmes drejtoreshave të shkollave dhe përmes drejtorisë së Arsimit dhe disa i shpërndajmë gjatë mbajtjes së Ligjëratave.

-Me datën 19.10.2023, kemi mbajtur takim në SHFMU “Halil Bajraktari”, me rastin e muajit tetor, i cili konsiderohet si Muaji Ndërkombëtar në Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, prej 18 Tetor-17 Nëntor 2023. Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut (NJKDNJ) ka organizuar një Ligjëratë në bashkëpunim me Drejtorin Komunal të Arsimit dhe Qendrën për Punë Sociale me nxënës të kl. VIII- IX, SHFMU “Halil Bajraktari”, në Drenas II. Ligjëratat me temë “Parandalimi i Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe ngritja e vetëdijes së popullatës së gjerë”. Ligjërues të kësaj teme ka qenë nga Qendra për Punë Sociale, Psikologe Prof. Arjana Isufi. Foto e takimit me nxënës të KL. VII -IX në SHFMU “Halil Bajraktari”, Drenas II.19.10.2023.

Kjo ligjëratë ka për qëllim vetëdijësimin e shoqërisë për Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe ngritja e vetëdijes së popullatës së gjerë, si dhe nxitjen e institucioneve përgjegjëse për krijimin e kushteve të sigurisë dhe përmirësimin e kushteve të trajtimit të këtyre rasteve në Kosovë. Në fund të ligjëratës nxënësve ju shpërndan fletëpalosje lidhur me temën e mbajtur. Pjesëmarrës ishin gjithsej 46 nxënës, 27 - njëzeteshtatë femra dhe 19 M, nëntëmbëdhjetë meshkuj. Falënderojmë drejtorin dhe pedagogun me stafin e tij të SHFMU “Halil Bajraktari”, për pritjen dhe organizimin e nxënësve. Me datën 19.10.2023, kam përpiluar raportin për Avokatin e popullit, prej pesë faqeve dhe e kam dorëzuar përmes emalit.

Me datën 24.10.2023, kemi mbajtur Kampanjën-fushatës kundër kancerit të gjirit 24. Tetor 2023, në nivel Komunal në Drenas. Ky takim është organizuar nga KNJKDNJ në bashkëpunim me Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale dhe Grupin e Grave asambleiste, Mbajtjen e Ligjëratës me temë “Kanceri i Gjirit dhe Parandalimi i tij”, të cilën në aspektin profesional e ka mbajtur Dr. PhD. kan. Fatbardhë Tahiraj, nga QKMF Drenas. Rrëfim i storjes së kalimit të Sëmundjes së kancerit para pjesëmarrësve pati dhe nga nëna Fahrije Hykollli nga Drenasi. Foto e hapjes së takimit nga KNJKDNJ, ZBGJ në Sallën e Kuvendit 24.10.2023 Pas Ligjëratës vazhduam Kampanjën – fushatën në ecjen “Një hap kundër kancerit të gjirit” me gratë e Komunes së Drenasit.

Ky aktivitet u financua nga Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies Sociale të Komunes së Drenasit. Në këtë aktivitet morën pjesë 80 veta por kanë arritur të shënohen vetëm 63 veta, prej tyre 2 meshkuj dhe 61 femra.

-Me datën 27.10.2023, kemi mbajtur takim në SHFMU “Gani Sylja”, me rastin e muajit Tetor, i cili konsiderohet si Muaji Ndërkombëtar në Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, prej 18 Tetor-17 Nëntor 2023. Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut (NJKDNJ) pranë zyrës së Kryetarit, KNJKDNJ-ZBGJ ka organizuar një Ligjëratë në bashkëpunim me DKA dhe Policinë e Kosovës, me nxënës të kl. VIII- IX, SHFMU “Gani Sylja”, në Poklek, me temë Parandalimi i Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe ngritja e vetëdijes së popullatës së gjerë. Ligjëruese të kësaj teme kanë qenë nga Policia e Stacioni Policor Drenas dhe nga DKA psikologu klinik.

Pjesëmarrës ishin gjithsejtë 45 nxënës, 27 - njëzeteshtatë femra dhe 18 - tetëmbëdhjetë meshkuj.

-Me datën 27.10.2023, kemi përpiluar Raportin e Fushatës për Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, në SHFMU “Gani Syla” nr. Pr.01-052/01-53473.

-Me datën 30.10.2023, kemi përpiluar Raportin e Fushatës për Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, i cili u mbajt me 19.10.2023, në SHFMU “Halil Bajraktari” nr. Pr.01-052/01-53747.

-Me datën 30.10.2023, kemi përpiluar Raportin e Kampanjës-fushatës kundër kancerit të gjirit 24. Tetor 2023, në nivel Komunal në Drenas., i cili u mbajt me 24.10.2023, në Sallën e Kuvendit nr. Pr.01-052/01-53632.

- Me datën 31.10.2023 mbajtëm takim përmblyllës i fushatës kundër kancerit të gjirit . Ky takim është organizuar nga KNJKDNJ në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenës Sociale dhe Drejtoreshën e SHFMU “Shaban Polluzha” - Drita Curri në fshatin Korroticë e Epërme.

Në takim pjesëmarrësve ju shpërnda fletëpalosje, ngjitja e kordeles rozë. Në këtë aktivitet morën pjesë 25 veta femra.

-Me datën 31.10.2023, kemi përpiluar Raportin e përmblyllës-fushatës kundër kancerit të gjirit, i cili u mbajt me 31.10.2023, në SHFMU “Shaban Polluzha” në fshatin Korroticë e Epërme me nr. Pr.01-052/01-53632.

-Me datën 1.11.2023, kemi përpiluar Raportin e hapjes së Fushatës për Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, e cila u bë me datën me 18.10.2023, për ngjitjen e posterëve dhe shpërndarjen e fletëpalosjeve si dhe vizitat nëpër institucione dhe shkolla të Komunës së Drenasit me nr. Pr.01-052/01-54186.

-Me datën 7.11. 2023, kemi mbajtur takim në SHFMU “Shaban Polluzha”, me rastin e muajit tetor, i cili konsiderohet si Muaji Ndërkombëtar në Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, prej 18 Tetor deri me 17 Nëntor 2023. Njësia Komonale për të Drejtat e Njeriut (NJKDNJ) pranë zyrës së Kryetarit, KNJKDNJ, ZBGJ ka organizuar një Ligjëratë në bashkëpunim me QPS, ZKK dhe Njësitin Policor i Kosovës në Drenas, me nxënësit e kl- VIII- IX, SHFMU “Shaban Polluzha” Korroticë e Epërme, me temë Parandalimi i Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe ngritja e vetëdijes së popullatës së gjerë.

Pjesëmarrës ishin gjithsej 67-gjashtëdhjeteshtatë nxënës, 34- tridhjetekatër femra dhe 33-tridhjetetë meshkuj.

-Me datën 7.11. 2023, kemi punuar Raportin për mbajtjen e takimit në SHFMU “Shaban Polluzha”, me rastin e muajit tetor, i cili konsiderohet si Muaji Ndërkombëtar në Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, me nr.pr. 01-052/03-54996.

-Me datën 8.11. 2023, kemi bërë Rekomandim për ndryshim përfshirje në Vendimin e KKSBS-së, nr. 12-030-65513, dt. 23.12.2023,shkresa me protokoll 01-030/01-55186

-Me datën 8.11. 2023, kemi bërë Kërkesë për sistemim në ish zyrën e NJDNIJ-ut nr. 01-030/01-55204.

-Me datën 9.11. 2023, kemi bërë Kërkesë për kompensim të Fushatës së Kancerit të Gjirit nr. 01-400/03- 55388.

-Me datë 10.11. 2023, kemi mbajtur takim të Fushatës për promovimin e të drejtave të Fëmijëve në SHFMU “Fazli Grajqevci” Poklek Vasilevë, me rastin e muajit tetor, i cili konsiderohet si Muaji Ndërkombëtar në Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, prej 18 Tetor deri me 17 Nëntor 2023.

Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut (NJKDNIJ,ZBGJ) ka organizuar një Ligjëratë në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, Qendrën për Punë Sociale dhe Policinë e Kosovës, me nxënësit e kl- VIII- IX, SHFMU “Fazli Grajqevci” Poklek - Vasilevë me temë “Parandalimi i Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe ngritja e vetëdijes së popullatës së gjerë”. Pjesëmarrës ishin gjithsej 59 pesëdhjetenëntë nxënës, 26 njëzetegjashtë femra dhe 33 tridhjetetë meshkuj.

-Me datën 10.11. 2023, kemi punuar Raportin për mbajtjen e takimit në SHFMU “Fazli Grajqevci”, me rastin e muajit tetor, i cili konsiderohet si Muaji Ndërkombëtar në Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, me nr.pr. 01-052/01-55554.

-Me datë me 15.11. 2023, kemi mbajtur takim të Fushatës për promovimin e të drejtave të Fëmijëve në SHFMU “Arif Shala” Korroticë e Poshtme, me rastin e muajit tetor, i cili konsiderohet si Muaji Ndërkombëtar në Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, prej 18 Tetor deri me 17 Nëntor 2023. Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut (NJKDNIJ,ZBGJ) pranë zyrës së Kryetarit, KNJKDNIJ,ZBGJ ka organizuar një Ligjëratë në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, Qendrën për Punë Sociale dhe Policinë e Kosovës, me nxënësit e kl- VIII- IX, SHFMU “Arif Shala”, Korroticë e Poshtme me temë Parandalimi i Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe ngritja e vetëdijes së popullatës së gjerë. Mesazhi i Fushatës “Trafikimi Prek të Gjithë! Ta mbrojmë Vetën dhe Fëmijët tanë! Slogani i Fushatës është: “Mos Hesht”. Poshtme, 15.11.2023. në objektin e Shkollës.

Pjesëmarrës ishin gjithsej 57 pesëdhjeteshtatë nxënës, 31 tridhjetenjë femra dhe 26 njëzetegjashtë meshkuj.

-Me datë me 16.11. 2023,kemi Raportin e takimit të Fushatës për promovimin e të drejtave të Fëmijëve në SHFMU “Arif Shala” Korroticë e Poshtme, me rastin e muajit tetor, i cili konsiderohet si Muaji Ndërkombëtar në Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, prej 18 Tetor deri me 17 Nëntor 2023,nr. Pro. 01-052/01-56218.

Me datën 1.12.2023, kemi bërë kërkesën për pano të pastër dhe fletëpalosje, pano për Fushatën Kundër dhunës në Bazë Gjinore, nr.pr.01-400/01-50597.

Me datën 1.12.2023, kemi bërë Ftesë për takim në SHFMU “Bajram Curri” Nekoc, për Ditën Ndërkombëtare të Fushatën Kundër dhunës në Bazë Gjinore dhe “ 16 Ditët e Aktivizmit” (25 Nëntor deri me 10 Dhjetor) nr.pr.01-060/03-58488.

Me datën 05.12.2023, protokoli nr.01-052/01-58563, kam bërë Raportin Listimi i Aktiviteteve për gjatë muajit 18. Tetor 17 Nëntor të „Fushatës Vetëdijesuese Kundër Trafikimit me Njerëz 2023” Komuna e Drenasit, i përbërë prej katër faqeve.

Me datën 6.12.2023, kemi mbajtur takim për fushatën 16 ditët e aktivizimit, 25.11. 2023 - 10.12. 2023, për “25 Nëntor Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës në Bazë Gjinore

Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut (NJKDNJ) – ZBGJ, ka organizuar një Ligjëratë në bashkëpunim me DKA, QPS dhe Policinë e Kosovës, me nxënësit e kl- VIII- IX, në SHFMU “Bajram Curri”, në fshatin Nekoc dhe me gratë, e cila u mbajt në shkollë, me temë Parandalimi i Dhunës në Bazë Gjinore dhe ngritja e vetëdijes së Qytetarëve. Mesazhi i Fushatës “As edhe Një më Shumë”, “Sot dhe Çdo ditë Tjetër”, “Raporto Mos Duro”, Dhuna është Krim”, “Mos Dhuno”, "Raporto: 192"! Slogani i Fushatës është: “Mos Hesht”. Foto në ligjëratën e mbajtur në SHFMU “Bajram Curri” Nekoc me 6.12.2023.

Kjo ligjëratë kishte për qëllim vetëdijesimin e shoqërisë për Parandalimin e Dhunës në bazë gjinore, dhe ngritja e vetëdijes së popullatës së gjerë, si dhe nxitjen e institucioneve përgjegjëse për krijimin e kushteve të sigurisë dhe përmasimin e kushteve të trajtimit të këtyre rasteve në Kosovë.

Nxënës pjesëmarrës në ligjëratë ishin 50 nxënës, prej tyre 29 F dhe 21 M.

Gjithashtu, pjesëmarrës në ligjëratën me gratë ishin 12 veta 11 F dhe 1 M.

Pjesëmarrësve ju shpërndan fletëpalosje dhe posterët të ngjitur në shkollë.

Me datën 7.12.2023, kemi bërë Raport për takim në SHFMU “Bajram Curri “Nekoc ,për Ditën Ndërkombëtare të Fushatën Kundër dhunës në Bazë Gjinore” dhe “16 Ditët e Aktivizmit” (25 Nëntor deri me 10 Dhjetor) nr.pr.01-060/03-59142.

Me 08. 12. 2023, kam bërë Planin e Punës për vitin 2024, të Njësitit për të Drejta të Njeriut dhe Barazi Gjinore, nr. Prot. 01-030/01-59308.

Me datën 12.12.2023, kemi bërë Ftesë për Tryezë, për Ditën Ndërkombëtare të Fushatën Kundër dhunës në Bazë Gjinore dhe “ 16 Ditët e Aktivizmit” (25 Nëntor deri me 10 Dhjetor) nr.pr.01-060/03-58488.

Me datën 11.12.2023, kemi bërë takim për fushatën 16 ditët e aktivizimit, 25.11. 2023 - 10.12. 2023, për “25 Nëntor Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës në Bazë Gjinore.

Datë me 11.12.2023, Fushata për 16 Ditë Aktivizmi (25 Nëntor deri me 10 Dhjetor). Me rastin e Fushatës 25 Nëntori Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës në Baza Gjinore, KNJKDNJ-ZBGJ ka organizuar një Ligjëratë në bashkëpunim me DKA, QPS dhe Policinë e Kosovës, me nxënësit e kl- VIII- IX, në SHFMU “Shotë Galica”, në fshatin Abri e Epërme e cila u mbajt në shkollë, me temë “Parandalimi i Dhunës në Bazë Gjinore dhe ngritja e vetëdijes së Qytetarëve, me mesazhe të njëjta si në fushatat e mëhershme.

Foto në ligjëratën e mbajtur në SHFMU “Shotë Galica” Abri e Epërme më 11.12.2023.

Kjo ligjëratë ka për qëllim vetëdijesimin e shoqërisë për Parandalimin e Dhunës në bazë gjinore, dhe ngritja e vetëdijes së popullatës së gjerë, si dhe nxitjen e institucioneve përgjegjëse për krijimin e kushteve të sigurisë dhe përmasimin e kushteve të trajtimit të këtyre rasteve në Kosovë.

Nxënës pjesëmarrës në ligjëratë ishin 30 nxënës, prej tyre 16 F dhe 14 M.

Pjesëmarrësve ju shpërndan fletëpalosje dhe posterët të ngjitur në shkollë.

Me datën 11.12.2023, kemi bërë Raport për ligjëratën e mbajtur në SHFMU “Shotë Galica” Abri e Epërme për Ditën Ndërkombëtare të Fushatën Kundër dhunës në Bazë Gjinore dhe “16 Ditët e Aktivizmit” (25 Nëntor deri me 10 Dhjetor) nr.pr. 01-052/01-59552.

-Me 13.12.2023, si kryetare e Komisionit për rekrutim të kandidatëve të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuar, kam bërë njoftimin për intervistë me nr.prot.02-030/01-60002.

Me datën 18.12.2023 kemi mbajtur Tryezën e Fushatës 16 Ditëve të Aktivizmit, Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës në Bazë Gjinore u organizuar nga Njësia për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore pranë zyrës së Kryetarit ku mori pjesë edhe zyrtarë lokal dhe nga niveli qendror, MAPL.

Në debat diskutuan të gjithë pjesëmarrësit lidhur me shkaqet e dhunës në familje, në Shkollë si dhe u debatua shumë rreth shkaqeve të dhunës fizike. Pjesëmarrës në tryezë ishin këto institucione Komunale; DKA, drejtorët e dy SHFMU, QPS-ja, Grupi i Grave Asambleiste, Policia Drenas-Njësiti për dhunën në familje, MAPL –ja, OJQ- Humans Vita, Strehimorja në Prishtinë, Kfori Slloven. Në Tryezë kanë marrë pjesë 22 veta prej tyre 14 Femra dhe 8-Meshkuj.

Gjatë ditëve të fushatës KNJKDNJ vizitoi dy SHFMU, dhe QPS, lidhur me rastet e dhunës. Ka mbajtur dy ligjërata me temë Parandalimi i dhunës në Bazë Gjinore dhe vetëdijesimi i qytetarëve, në SHFMU me nxënësit e klasave të VII, VIII, IX në “Bajram Curri” Nekoc, dhe në SHFMU në “Shotë Galica” Abri e Epërme. Gjithashtu kemi mbajtur dhe një ligjëratë me

Gratë e fshatit Nekoc. Komuna e Drenasit ka një bashkëpunim të mirë me OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare gjithashtu edhe me institucionet fetare.

Me hapjen e fushatës me 25. 11.2023, u bë ngjitja e posterëve dhe shpërndarja e fletëpalosjeve si dhe kordeles së bardhë nëpër të gjitha institucionet e Komunës së Drenasit, për vetëdijesimin e popullatës për rëndësinë e parandalimit, luftimit dhe eliminimit të dhunës në Bazë Gjinore.

-Me datën 19.12.2023, kemi bërë Raportin e Tryezës fushatës 16 Ditët e Aktivizmi 25 Nëntor deri më 10 Dhjetor, për Ditën Ndërkombëtare kundër Dhunës në Bazë Gjinore, me nr. 01-052-60819.

-Me 20.12.2023, si kryetare e Komisionit për shqyrtim të Konkursit për Komitetin për Persona me Aftësi të Kufizuar, kam bërë Njoftimin me nr. prot. 02-020-57196.

-Me 20.12.2023, si kryetare e Komisionit për shqyrtim të Konkursit për Komitetin për Persona me Aftësi të Kufizuar, kam bërë Raportin e rekrutimit të Konkursit të shpallur për KKPAAK, me nr. prot. 02-020-57196.

Gjatë vitit 2023, KNJKDNJ,ZBGJ dhe MB, detyrat e punës do të realizon në bazë të Ligjit për Barazi Gjinore, Ligjit kundër Diskriminim, Rregullores nr.03/2017,si Njësi Kundër diskriminimit, do të vazhdon t'i realizoj programet dhe synimet e veta duke mbajtur kontakte të përhershme dhe duke kërkuar ndihmë si nga Drejtorit, zyra e Kryetarit po ashtu MAPL ,ZQM edhe nga Agjencinë për Barazi Gjinore në kuadër të Qeverisë.

Vështirësitë dhe pengesat

Krahas sukseseve të arritura në këtë vit ne kemi pasur edhe pengesat të ndryshme të cilat kanë ulur shkallën e suksesit të përgjithshëm të punës së NJDNJ-ZBGJ; disa nga vështirësitë po veçojmë: Pengesat për buxhet të pa mjaftueshëm sipas plan-programit të punës së NJKDNJ – ut dhe ZBGJ për realizimin e projekteve; Ngarkesa e punës me punët e zyrës së Kuvendit në gjashtëmuor 2023, dhe, në caktim të monitoronit të komisioneve të ankesave të qytetarëve, në grupet e ndryshme punuese ndër-komunale, dhe gjithashtu në hartimin e legjislacionit dhe politikave komunale. Mos përkrahja e pjesëmarrjes me ftesa zyrtare në vizita studimore dhe seminareve në kuadër të punës me ftesa zyrtare nga niveli qendror.

-Deri me datën 19.5.2023, jam liruar nga përgjegjësia që kam pasur, Shefe e zyrës së Kuvendit me të gjitha përgjithësitë, dhe deri me datën 8.6.2023, sipas procesverbalit nr. prot. 02-060/04-27466, të dorëzim pranimit të gjitha lëndëve të zyrës së Kuvendit. Ku nga data e njoftimit të 19.5.2023, kam punuar dhe dorëzuar 13-trembëdhjetë raporte të punës së Kuvendit dhe si vijon:

-Në sistem të intranetit janë miratuar gjithsejtë 103 lëndët për periudhën Janar-19Maj 2023,të bashkangjitura me shkresa përcjellëse, Vendimet kanë të bashkangjitura Shkresat e dërgimit të akteve në MPL të nënshkruara nga Kryetari dhe Kryesuesi, Shkresa e dërgimit në MAPL me e mail nga shefja e zyrës së Kuvendit, Raportet e kthyer nga MPL për vendimet, Ligjshmëritë

e kthyer nga MAPL-ja për vendimet, Faturat e shpenzimeve, vërtetimet e lëshuara sipas kërkesave, dhe vendimet në gjuhën serbe, Ftesa dhe materiali i mbledhjes.

Zyra e Kuvendit ka raportuar me raporte MPL-së, tremujore gjashtëmujore, me 19 Maj 2023. Kryesisht kam përpiluar 13- trembëdhjetë raporte të ndryshme si shefe e zyrës së Kuvendit siç janë:

1. Raportin e procesverbaleve të punuara janar 19 Maj pr. 02-052/01- 25575,dt.30.05.2023;
2. Raporti i mbledhjeve të mbajtura të KPF,KK, KPK nr. 02-052/01- 25575, dt. 30.05.2023;
- 3.Raporti i Vendimeve të Komisioneve Janar- 19Maj nr. 02- 052- 25582,dt. 30.05.2023;
4. Raport i Faturave të paguara gjatë Janar-19 Maj 2023,nr. 02-052/01-25847,dt. 06.06.2023;
5. Raporti i të gjitha akteve të miratuara në KK dhe të dërguara në MPL, Janar-19 Maj nr. 02-052/01-25586,dt. 30.30.2023;
6. Raportin i Vërtetimeve të lëshuara sipas kërkesave të pranuar Janar-19 Maj 2023,nr. 02-052/01- 25405, i dt. 30.05.2023;
7. Raportin e lëndëve të dorëzuara në arkivin e Komunës, Janar-19 Maj nr. 02-052/01-25648,dt. 31.05.2023;
8. Raportin e akteve të kthyer nga MPL për rishqyrtim dhe shfuqizim, Janar-19 Maj nr. 02-052/01- 25527,dt. 30.05. 2023;
9. Raportin e funksionimit të Kuvendit dhe Komunës me përgjigjeje nga pyetjet e MPL, janar Mars 2023, nr.02-052/03- 16355, dt. 30.04.2023;
10. Raport i Kërkesave të regjistruara për emërim dhe riemërim të rrugëve Janar-19 Maj 2023,nr. 02-052/01- 25895,dt. 01. 06.2023.
11. Raport i kthimit dhe moskthimit të Ligjshmërive nga MPL të Vendimeve të dërguara në MPL Janar-19 Maj 2023,sipas protokolleve të MPL. 02-052/01- 25406,dt. 30. 05.2023.
12. Raportin e Përgjithshëm të Punës së zyrës së Kuvendit me pika të rendit të ditës me nr.prot. 02-052/01-25927. të datës 01.06.2023.

13. Raport i procesverbalit të dorëzimit-pranimit të punës së zyrës së Kuvendit nga 01.03.2019, deri me 19. 05.2023, me numër të protokollit 02-060/04-27466, të datës 08.06.2023.

Strategjitë e tejkalimit të vështirësive dhe pengesave

Prezantimi në mbledhjet e organizuara nga komuna për shkak të monitorimit të shkeljeve të drejtave rreth diskriminimit të dy gjinive. Përkrahja e projekteve të Aktiviteteve të parapara në bazë të Plan programit të Punës.

Ndarja e buxhetit për zyre sipas plan-programit për realizimin e projekteve për vitin 2023/2024, Rregullores nr.03/2017 si dhe Ligjit për Barazi Gjinore.

Të jetë i plotësuar NJDNJ-ZBGJ edhe me zyrtarë tjerë për tri detyra në kuadër të njësisë.

Kontaktet me institucionet tjera rreth bashkëpunimit në punë.

Zyra për Komunitete dhe Kthim, Raporti i punës për vitin 2023

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim është organi kryesor komunal për ri-integrimin e personave të riatdhesuar në nivelin lokal. ZKKK në procesin e riintegrit të personave të riatdhesuar ka përgjegjësi dhe i zbaton ato në bazë të Rregullores Nr.22/2020 për Riintegrimin e personave të riatdhesuar. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim këshillon autoritetet komunale në lidhje me nevojat e komuniteteve pakicë që jetojnë në Komunën tonë, të siguroj mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të tyre, qasje të barabartë të gjitha komuniteteve në shërbimet publike dhe të krijoj kushte për një kthim të qëndrueshëm të refugjatëve, personave të zhvendosur dhe atyre të riatdhesuar që u përkasin të gjitha komuniteteve.

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim gjatë vitit 2023, ka pasur për fokus personat e riatdhesuar – riintegrimin e tyre. Po ashtu duke i përfshirë edhe projektet të cilat kanë të bëjnë me këtë kategori.

Gjatë këtij viti kemi 15 persona të riatdhesuar, kemi 11 meshkuj dhe 4 femra, nga këto raste i kemi 3 raste të cënueshme.

Ndërsa të riintegruar kemi 20 persona.

Në bazë të Rregullores Nr.22/2020, personat e riatdhesuar kanë mundësi aplikimi në: Vetëpunësim, Subvencionimi në punësim dhe Trajnim në punë.

Tek kategoria e Vetëpunësimit kemi 6 (gjashtë) persona të riatdhesuar të cilët janë integruar dhe kanë përfituar mjete pune për fillim të biznesit në lëmin ku ata kanë aplikuar për të krijuar të ardhura për familjet e tyre.

Gjatë vitit 2023 kemi pasur 20 kërkesa nga personat e riatdhesuar për pajisje me vërtetim, pastaj për kompletim të dokumentacionit, ku të gjithë janë pajisur në bazë të dokumenteve të kthimit që i kanë poseduar. Të gjithë këta persona i kemi këshilluar dhe udhëzuar për të përfituar nga fondi i riintegrit.

Nga pakoja e Akomodimit kemi 1 (një) familje përfituese të pakos së akomodimit dhe 1 (një) individ, ndërsa 3 (tre) familje përfituese nga pakoja e gjëra ushqimore – higjienike.

Përmes sistemit Intranet kemi pranuar 40 lëndë të cilat i kemi shqyrtuar dhe i kemi dhënë përgjigje në afat ligjor.

Kemi mbajtur 4 (katër) takime me Komisionin Komunal për Riintegrim. Në këto takime kemi shqyrtuar kërkesat të cilat kanë ardhur në ZKKK për Akomodim të këtyre personave. Në fillim lënda kompletohet dhe verifikohen personat e riatdhesuar në teren nga ZKKK, Koordinatorin nga MPB, Qendra për Punë Sociale dhe varësisht nga rastet kemi të përfshirë edhe akterët e tjerë Komunal. Gjatë këtij viti kemi shqyrtuar dhe kemi marrë vendime për 2 (dy) kërkesa të personave të riatdhesuar, nga këto kemi 1 (një) pranim të akomodimit (vazhdim edhe për 6 muaj të tjerë) dhe 1 (një) refuzim. Gjithashtu së bashku me Komisionin Komunal për Riintegrim kemi diskutuar dhe punuar në Planin Komunal për Riintegrim 2023-2025.

Nga personat e riatdhesuar/riintegruar kemi verifikuar në teren 15 rastet. Verifikimi është bërë së bashku me koordinatoren rajonal nga MPB, gjithashtu kemi pasur 2 raste ku verifikimi është bërë së bashku me zyrtar nga Qendra për Punë Sociale.

Në QPS - sektori i asistencës sociale kemi 1 (një) familje përfitues asistencës sociale po ashtu edhe 1 (një) person që është përfitues i pensionit invalidor.

Gjatë këtij viti ka filluar edhe zbatimi i vendimeve për renovimin e shtëpisë së një personi të riatdhesuar dhe ndërtimin e shtëpisë së një personi tjetër të riatdhesuar, vendime të cilat janë marrë në fund të vitit 2022. Ndërtimi dhe Renovimi janë përfunduar gjatë këtij viti.

Zyra për Komunitete dhe Kthim gjatë vitit 2023 ka mbajtur 6 takime të Komitetit për Komunitete, ku temë diskutimi ka qenë gjithmonë si pike e parë raporti i punës nga Zyra për Komunitete dhe Kthim, pastaj temat të cilat kanë të bëjnë me mirëqenien e qytetarëve të Komunës sonë.

Gjithashtu kemi qenë pjesë e KKSB-së, ku në çdo mbledhje kemi dhënë kontributin tonë.

ZKKK-ka qenë pjesë e grupit punues për hartimin e Planit Komunal për Riintegrim të Qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe Integrimin e të huajve 2023-2025, i cili plan është miratuar në Kuvendin Komunal në mbledhjen e datës 20.04.2023.

Zyra për Komunitete dhe Kthim në cilësinë e koordinatorës të Projektit INTEGRA “Nxitja e riintegrimin të qëndrueshëm lokal të grave dhe të rinjve të kthyer dhe njerëzve të cenueshëm lokal në Kosovë”- bashkëpunim i nënshkruar në mes të Kryetarit të Komunës z. Ramiz Lladrovci – Komuna Partnere dhe Organizatës- PREDA Plus Kosovë dhe Entrepreneur, e nënshkruar me datë 11.01.2023.

Ne si Shefe e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim në cilësinë e koordinatorës së këtij projekti kemi filluar me zbatim të projektit së bashku me përfaqësuesit e INTEGRA nga data 19.01.2023, ku kemi diskutuar për detajet e projektit. Përzgjedhja e individëve si përfitues potencial është bërë me thirrje të hapur për aplikim e cila është mbajtur me datë 26.01.2023.

Nga ky projekt personat e zgjedhur kanë përfituar mjete pune në vlerë 2, 100.00 euro për fillim të biznesit dhe si participim Komuna e Drenasit, gjegjësit Kryetari i Komunës, ju ka dalë në ndihmë kësaj kategorie me 200.00 euro participim, ndërsa një pjesë në vlerë të 200.00 euro kanë participuar personat përfitues të projektit, vlera totale e të cilit ka arritur 2,500.00 euro (për çdo përfitues).

Nga Komuna e Drenasit kemi 6 (gjashtë) përfitues nga ky projekt, të gjitha janë gra të riatdhesuara të cilat janë pajisur me mjetet e kërkuara dhe tashmë kanë hapur bizneset e tyre.

Si vazhdimësi e projektit ne si Koordinatorë e Projektit se bashku me përfaqësuesit e Projektit INTEGRA e kemi për obligim që ti monitorojmë këto biznese deri më 31.8.2025.

Në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2023 ne kemi filluar monitorimin e parë, ku këto biznese janë aktive dhe personat përfitues janë të kënaqur me fillimin e tyre.

Gjatë këtij viti kemi mbajtur tre punëtori në kuadër të projektit “Riintegrimi ekonomik nëpërmjet mbështetjes psiko-sociale, të financuar nga GIZ , projekti DIMAK-Programi i migracionit për zhvillim(PME), të implementuar nga Business Development Group.Trajnim mbi Udhëzuesin për qasjen e të huajve, aftësim profesional dhe punësim të financuar nga Caritas Zvicëran në kuadër të projektit MARDI(Veprimi i Komunave për Riintegrim dhe Diasporë).Në kuadër të këtij projekti kemi bashkëpunimin me Qendrën Rinore –Obiliq. Ky projekt ofron Kursin e Dizajnit Grafik për fëmijët e personave të riatdhesuar dhe përfitues nga ky projekt kemi 6 fëmijë të riatdhesuar.

Gjatë muajit nëntor, me rastin e Muajit Ndërkombëtar në Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore 18 Tetor deri 17 Nëntor, ne si Shefe e Zyrës për Komunitete dhe Kthim kemi marrur pjesë në Fushatën Vetëdijesuese –ligjëratën me temë “Parandalimi i Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe ngritja e vetëdijes së popullatës më gjerë. Ne kemi qenë të ftuar nga: Njësia Komonale për të Drejtat e Njeriut (NJKDNJ) , KNJKDNJ, ZBGJ Zahrie Podrimqaku Subashi, në bashkëpunim me DKA, QPS dhe Policinë e Kosovës.

Ligjëratata është mbajtur me nxënësit e kl- VIII- IX, SHFMU "Shaban Polluzha" Korroticë e Epërme. Pjesëmarrës ishin gjithsejtë 67 nxënës, 34 F dhe 33 M. Po ashtu, prezent ishte edhe Drejtoresha e shkollës Drita Curri me stafin e saj të SHFMU “Shaban Polluzha”.

Gjatë këtij viti është mbajtur Forumi i parë Nacional për Riintegrimin dhe Integrimin në Kosovë, ku ZKKK ka qenë pjesëmarrëse në forum. Ky Forum ka qenë ngjarja më e rëndësishme për shpalljen e politikave të Riintegrimit të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve. Po ashtu kemi qenë pjesëmarrës edhe ne Forumin e Partneritetit Shumëpalësh për Migracion, në punëtori dhe trajnime të organizuara nga MPB për Riintegrim të personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve.

Gjatë vitit 2023 kemi mbajtur takime me Zyrën e Kryeministrit për projektet të cilat mund të përfitojnë të gjitha komunitetet.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore - Raporti Vjetor 2023

Gjatë vitit 2023, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka azhurnuar listat e pagave sipas ndryshimeve, konform zhvillimeve në stafin e punëtorëve.

Paraqitja në formë tabelare e realizimit sipas azhurnimit në listë të pagave ;

Muaji-viti	Punëtor i ri	Ndryshime	Punëtorë të larguar	Pagesa retroaktiv	etj.
Janar 2023	0	1	2	7	Lista për anët.të kuvendit dhe anët. të KK.
Shkurt 2023	1(një) pozitë punëtor të ri	0	3 Përfundim të marrëdhënies se punës	4	Lista për anët.të kuvendit dhe anët. të KK.
Mars 2023	4(katër) pozita punëtor të ri	7	1 Përfundim të marrëdhënies se punës	2	Lista për anët.të kuvendit dhe anët. të KK.
Prill 2023	6 (gjashtë) pozita punëtor të ri	6	2(largim-përfund. Mandati dhe shk.përs.	1	Lista për anët.të kuvendit dhe anët. të KK.
Maj 2023	1(një) pozitë punëtor të ri	32	1 Përfundim të marrëdhënies se punës	7	Lista për anët.të kuvendit dhe anët. të KK.
Qershor 2023	0	10	0	29	Lista për anët.të kuvendit dhe anët. të KK.
Korrik 2023	0	3	0	0	Lista për anët.të kuvendit dhe anët. të KK.
Gusht 2023	1(një) pozitë punëtor të ri	5	1 Përfundim të marrëdhënies se punës	4	Lista për anët.të kuvendit dhe anët. të KK.
Shtator 2023	1(një) pozitë punëtor të ri	4	0	4	Lista për anët.të kuvendit dhe anët. të KK.

Tetor 2023	0	10	0	8	Lista për anët.të kuvendit dhe anët. të KK.
Nëntor 2023	0	12	0	13	Lista për anët.të kuvendit dhe anët. të KK.
Dhjetoe 2023	2	16	2	46	Lista për anët.të kuvendit dhe anët. të KK.

Nga muaji Shkurt 2023, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me kërkesë të DMZP, IKAP, USAID, ATK ka përgatitur planin për trajnimin e stafit (shërbyesve civil). Është përgatitur lista e të dhënave të të punësuarve në shërbimin civil, për staf në Arsim, në Shëndetësi, staf Politik, staf mbështetës dhe i është dërguar përmes formularit (Moduli i Statistikave) në SIMBNJ (Sistemi Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore). Hartimi i planit individual i personelit për pozitat e lira nga të gjitha format e kërkesave për vitin 2023 është përfunduar në fund të muajit Tetor 2023, përmes sistemit të SIMBNJ dhe plotësim-ndryshim PPI, i cili është aprovuar prej DMZP -së.

Pra për kërkesat e njësive kërkuese për plotësim të pozitave të lira të punës nga muaji Janar 2023 është filluar me konkurse të mbyllura (brendshme) Lëvizje paralele brenda kategorisë, si dhe gjatë vitit 2023 janë realizuar dy (2) pozita Lëvizje paralele brenda kategorisë dhe 3 ngritje në detyrë (avancim), është vazhduar me procedura të njëjta deri me datë 25/09/2023 pra deri me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, më të cilin Ligj ndryshon procedura e rekrutimit.

Pas këtij hapi si dhe interesimi i njësive kërkuese që sa më parë të zhvillohen procedurat rekrutuese për pozitat e lira të punës, kërkesat për plotësimin e pozitave me rastin e pensionimit, me ndërprerje të marrëdhënies së punës për arsye të ndryshme, si dhe pozitat e lira të punës të planifikuara me PPI për vitin 2023 pas Plotësim-ndryshimeve ligjore dhe akteve nënligjore në nivel vendi, është filluar për vitin 2023 me shpallje të konkurseve – pranim (konkurse të hapura-publike për vitin 2023 janë shpallur nëntë (9) grup pozitash: pas përfundimit me sukses të procedurave rekrutuese më përzgjedhje janë plotësuar 10 (dhjetë) pozita me nëpunës civil .

Në muajin Prill dhe Tetor 2023 Auditorët e jashtëm

Nga auditorët janë kërkuar; dosjet personale për disa shërbyes civil, Akt Emërime, Lista e pagave për muaj të caktuar, Kualifikimi (diplomë ose certifikatë), lista e shërbyesve civil në pushim të lehonisë për 2023, punë shtesë të shërbyesve civil, procedurën e pensionimit me arritjen e moshës, raporti periodik i evidencës së hyrjeve dhe daljeve të punëtorëve për periudhë të ndryshme mujore, procedura rekrutuese të konkurseve të mbyllura (të brendshme) Lëvizje paralele brenda kategorisë dhe procedura rekrutuese të konkurseve – pranim (konkurse publike), planifikimin e personelit për procedurat rekrutuese për vitin 2023 si dhe lidhur me

punët dhe detyrat e tjera që dalin nga kompetencat e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore është përgjegjur dhe ka plotësuar dokumentacionin në bazë të detyrës zyrtare edhe sipas kërkesës së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me rastet ankimore, që kanë të bëjnë me procedurat e rekrutimit, ankesave për ngritje të koeficientit etj. Po ashtu, Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe njësia e personelit sipas detyrës Zyrtare dhe sipas Rreg.nr.11/2020 ka rolin e sekretarisë për përgatitjen e seancave sipas ankesave, për Komisionin Disiplinor.

Raport i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi funksionon duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi. Roli i KKS-së është i rëndësishëm duke marr parasysh se adreson të gjitha shqetësimet e qytetareve nëpërmjet përfaqësuesve/anëtarëve të KKS-së lidhur me sigurinë qoftë rrugore, shëndetësore, të ambientit, sigurinë institucionale etj.

Duke u bazuar në këtë udhëzim administrativ, në fillim të vitit 2023 me qëllim të realizimit të detyrave operative lidhur me çështjet e Sigurisë në Bashkësi, në mbështetje të nenit 7 të Ligjit nr.04/01-076, për Policinë, nenit 11, pika 2 e udhëzimit administrative nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL, për KKS-në, është caktuar orari i punës, ku janë paraparë gjashtë (6) takime të rregullta të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Duke u bazuar në nenin 11, pika 2, ku thuhet “KKS-ja mban më së paku gjashtë (6) mbledhje në vit, tri (3) prej se cilave duhet të mbahen në gjashtë mujorin e parë të vitit kalendarik dhe tri në gjashtëmujorin e dytë, Komuna e Drenasit i është përmbajtur duke mbajtur gjashtë mbledhje të rregullta gjatë vitit 2023.

Ftesat janë bërë 7 ditë para mbajtjes së takimit dhe janë publikuar në ueb faqen e komunës së Drenasit.

Në mbledhje janë ftuar anëtarët e KKS-së dhe monitorues, të cilët janë evidentuar në Listën e Pjesëmarrjes. Në tabelën e mëposhtme të përmbledhur gjeni takimet, temat dhe adresimi i tyre. Në këto takime janë diskutuar çështje të cilat lidhen me sigurinë në bashkësi në Komunën e Drenasit, si siguria e ambientit, siguria shëndetësore, siguria rrugore dhe propozime të tjera që kanë dal nga anëtarët e KKS-së.

Data e Mbledhjes	Temat e diskutuara	Adresimi/Përgjegjësit
01.02.2023	1. Procesverbal i mbledhjes së rregullt të KKS-së të mbajtur me datë 19.12.2023:	https://kk.rks-gov.net/glllogoc/ep-content/uploads/sites/10/2023/01/Proce

<p>Linku: https://kk.rks-gov.net/glllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/01/Ft-esa-për-kksb.pdf</p>	<p>sverbali-i-kksb-dhe-ftesa-e-dates-19-dhjetor.pdf;</p> <ol style="list-style-type: none"> 2. Plani i Punës së KKSB-së për vitin 2023; 3. Orari i mbajtjes së mbledhjeve të KKSB-së gjatë vitit 2023; 4. Raport lidhur me punën e KKSB-së gjatë vitit 2022; 5. Raport lidhur me gjendjen në komunën e Drenasit pas vërshimeve; 6. Projekti “Integra” apo “Nxitja e riintegritimit të qëndrueshëm lokal të grave dhe të rinjve të kthyer dhe njerëzve të cenusshëm lokalë në Kosovë”; 7. Të ndryshme 	<p>Mbledhje të ekzekutivit/Koordinatori i KKSB-së/Drejtorët</p>
--	--	---

23.03.2023

<p>Linku: https://kk.rks-gov.net/glllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/03/Ft-esa-për-mbledhjen-e-dyte-te-KKSB-se-2023.pdf</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 01.02.2023: https://kk.rks-gov.net/glllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/02/Procesverbal-i-KKSB-se.pdf 2. Siguria në shkolla; 3. Të ndryshme 	<p>Mbledhje të ekzekutivit/Koordinatori i KKSB-së/Drejtorët</p>
--	--	---

18.05.2023

<p>Linku: https://kk.rks-gov.net/glllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/05/kksb.pdf</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 23.03.2023: https://kk.rks-gov.net/glllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/04/Procesverbal-i-takimit-te-kksb-se.pdf 2. Raport për adresimin e kërkesave të komunës në Departamentin e Infrastrukturës Rrugore në Prishtinë 	<p>Mbledhje të ekzekutivit/Koordinatori i KKSB-së/Drejtorët</p>
--	--	---

lidhur me sanimin e gropave nëpër rrugë regionale.

3. Dukuritë negative të adoleshentët dhe veprimet në parandalimin e tyre.
4. Të ndryshme

03.08.2023

Linku:
<https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/10/Ftesa-dhe-procesverbali-i-KKSB-03.08.2023.pdf>

2. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 18.05.2023
<https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/06/KKSB-Procesverbali.pdf>
3. Raport lidhur me zjarret fushore dhe malore nga NJPZSH-ja;
4. Masat e sigurisë për Muajin e Mërgatës;
5. Aksidentet në trafik, raport nga Stacioni Policor në Drenas
6. Të ndryshme

Mbledhje të ekzekutivit/Koordinatori i KKSB-së/Drejtorët

26.10.2023

Linku:
<https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/10/Ftesa-për-mbledhjen-KKSB-se-2023.pdf>

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 03.08.2023
<https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/10/Ftesa-dhe-procesverbali-i-KKSB-03.08.2023.pdf>;
2. Gjendja me zjarre fushore-malore në Komunën e Drenasit;
3. Tetori- Muaji i ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit;
4. Fushata Vetëdijesuese në Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore
5. Të ndryshme;

Mbledhje të ekzekutivit/Koordinatori i KKSB-së/Drejtorët

07.12.2023

Linku:
<https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/11/Procesverbali-i-mbledhjes-se-mbajtur-me-date-26.10.2023-3.pdf>

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 26.10.2023
<https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/11/Procesverbali-i-mbledhjes-se-mbajtur-me-date-26.10.2023-3.pdf>

Mbledhje të ekzekutivit/Koordinatori i KKSB-së/Drejtorët

tes/10/2023/11/F
TESA-për-
mbledhjen-e-
gjashte-te-KKSB-
se.pdf

2. Aktivitetet nga Zyra për Barazi Gjinore-Komuna Drenas nëpër shkolla lidhur me “Trafikimin me qenie njerëzore” dhe përgatitjet për fushatën ”16 Ditë të Aktivizimit Kundër Dhunës në Bazë Gjinore”
3. Vaksinimi i qenve shtëpiak dhe qenve endacak;
4. Të ndryshme

- ✓ Përveç KKSB-së janë mbajtur Këshillat Lokal për Sigurinë Publike ashtu siç parashihet me udhëzim administrativ gjithsej 6 takime të kryesura nga kryesuesi i KLSP-së. Në këto takime janë diskutuar tema që lidhen me sigurinë, me praninë edhe zyrtarëve policor.
- ✓ Në gjashtëmujorin e dytë kemi raportuar në Divizionin për Siguri Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme për veprimet, masat dhe iniciativat e ndërmarra nga komuna në realizimin/adresimin e sfidave të paraqitura gjatë mbledhjeve për periudhën Janar-Nëntor 2023. Kemi raportuar dy herë në Asamblenë Komunale për aktivitetet e KKSB-së, përkatësisht në gjashtëmujorin e parë dhe në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023.
- ✓ Kemi hartuar Planin e Punës dhe Orarin e mbledhjeve për vitin 2024, i cili do të përcillet për miratim në asamblenë komunale pas miratimit në KKSB.

Drejtorja për Administratë të Përgjithshme, Raport pune për vitin 2023

Raporti i punëve të kryera gjatë vitit 2023 në Drejtorinë për Administratë të Përgjithshme bazohet në Planin e Punës i cili është zbatuar në përpikëri nga menaxhmenti duke ofruar shërbime cilësore, të shpejta dhe të avancuara për qytetarët e komunës së Drenasit. Raporti paraqet në vija të trasha punët kryesore të Drejtorisë të cilat janë të ndarë në sektorë si: Qendra për Shërbim me Qytetarë (QSHQ), Sektori i Gjendjes Civile (ZGJC), Zyra e Prokurimit, Zyra e Kuvendit Komunal, Arkivi Komunal, Sektori i Shërbimeve të Përbashkëta.

Qendra për Shërbim me qytetarë

Gjatë vitit 2023, Qendra për Shërbim të Qytetarëve përmes sistemit elektronik ka ofruar të gjitha shërbimet për qytetarët pa dallim. Ka pranuar dhe regjistruar të gjitha lëndët që u janë drejtuar organeve komunale. Në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve gjatë periudhës 01/01/2023-31/12/2023 janë regjistruar 22,398 lëndë të ndryshme.

Janar - 1,825 lëndë

Shkurt - 1,565 lëndë


Mars - 1,774 lëndë

Prill - 1,615 lëndë

Maj - 1,981 lëndë

Qershor - 2,309 lëndë

Korrik - 1,615 lëndë
 Gusht - 2,048 lëndë
 Shtator - 1,985 lëndë
 Tetor - 2,222 lëndë
 Nëntor - 1,751 lëndë
 Dhjetor - 1,708 lëndë



Nga ky diagram, mund të vëreni që në muajin Qershor ka pasur më së shumti lëndë, përkatësisht 2,309 lëndë të cilat janë shpërndarë nëpër drejtori/zyre komunale. Ndërsa, muaji me më pak lëndë është Shkurti, përkatësisht 1,565 lëndë. Vlen të theksohet se edhe në vitin e kaluar, muaji më se shumti lëndë ka qenë Qershori.

Gjendja civile

Nga sistemi i Gjendjes Civile gjatë vitit 2023 janë lëshuar gjithsej 60,380 dokumente. Përveç këtyre, Drejtoria për Administratë ofron edhe shërbime elektronike përmes dy E-kioskave 24 orë të cilat janë të vendosura në Drenas dhe në Komoran. Numri i dokumenteve që janë nxjerrë nga kioskat është 1041.

Lloji i dokumentit	Numri
Ekstrate të lindjes	25 032
Certifikata të lindjes	15 338
Certifikata të martesës	7 558
Certifikata të vdekjes	1934
Certifikata të vendbanimit	1938
Certifikata të shtetësisë	171
Certifikata e statusit martesor	1620

Certifikata të bashkësisë familjare	6171
Vërtetima nga arkiva	622
TOTALI:	60,384 copë

Statistika e regjistrimit të ZGJC-Gllogoc- Lindje të rregullta dhe me vonesë brenda dhe jashtë vendit 75 lindje, Verifikimi në sistem gjithsej 67, rishkrim lindje 46, regjistrimi i qytetarit 5, martesë të rregullta brenda dhe jashtë vendit gjithsej 187, rishkrim martesë 144, shkurorëzime 14, anulime teknike 0, martesë me element të huaj gjithsej 38, vdekje të rregullta dhe me vonesë gjithsej 80, regjistrim i qytetarit të vdekur 35.

Statistika e regjistrimit të ZGJC-Komoran: Lindje të rregullta dhe me vonesë brenda dhe jashtë vendit 63, verifikim në sistem 63, rishkrim lindje 21, regjistrim i qytetarit 4, martesë të rregullta dhe jashtë vendit 133, rishkrim martesë në sistem 94, shkurorëzime 13, me element të huaj 24, vdekje të rregullta dhe me vonesë gjithsej 57, regjistrim i qytetarit të vdekur 58.

Statistikat e regjistrimit të ZGJC-Dobroshec: Lindje të rregullta dhe me vonesë brenda dhe jashtë vendit 17, verifikime në sistem 34, rishkrim lindje 11, regjistrim i qytetarit 0, martesë të rregullta dhe jashtë vendit 58, rishkrim martesë 46, shkurorëzime 9, martesat me shtetas të huaj 11, anulime teknike 0, vdekje të rregullta dhe me vonesë 32, regjistrimi i qytetarit të vdekur 21.

Statistika e regjistrimit të ZGJC-Tërstenik: Lindje të rregullta dhe me vonesë brenda dhe jashtë vendit 34, verifikime në sistem 29, rishkrim lindje 10, martesë të rregullta brenda dhe jashtë vendit 81, rishkrim martesë 26, shkurorëzime 3, anulime teknike 0, me element të huaj 16, vdekje të rregullta dhe me vonesë 28, regjistrim i qytetarit të vdekur 17.

Statistika e regjistrimit të ZGJC-Arllat: Lindje të rregulla dhe me vonesë brenda dhe jashtë vendit gjithsej 49, verifikime në sistem 26, rishkrim lindje 8, martesë të rregullta brenda dhe jashtë vendit 97, rishkrim martesë 60, shkurorëzime 15, martesë me shtetas të huaj 13, vdekje të rregulla dhe me vonesë 34, regjistrim i qytetarit të vdekur 16.

Statistika e regjistrimit të ZGJC-Abri e Epërme, lindje të rregullta dhe me vonesë brenda dhe jashtë vendit 7, verifikime në sistem 8, rishkrim lindje 7, regjistrim i qytetarit sipas nenit 31 dhe 32 2, martesë të rregullta brenda dhe jashtë vendit 52, rishkrim martesë 15, shkurorëzime 4, me element të huaj 9, vdekje të rregullta dhe me vonesë 13, regjistrim i qytetarit të vdekur 15.

Sektori i Shërbimeve të Përbashkëta

Zyrtarja për pranim-Freebalanc: Është bërë pranimi dhe evidentimin e të gjitha pagesave nga drejtoritë komunale. Raporte të pranimit nga Freebalanc- GRNS janë nxjerrë gjithsej 945 gjatë vitit 2023.

Zyrtarja për E-depo: Është bërë shkarkimi dhe ngarkimin me inventarit jashtë përdorimit sipas kërkesave të zyrtareve. Është bërë shkarkimi i 69 zyrtareve me 471 asete. Ngarkimi i 295 zyrtareve 527 asete, janë regjistruar 124 fatura.

Udhëzimi i palëve: Gjatë janar - dhjetor 2023 janë regjistruar në evidencë rreth 2000 qytetarë që kanë shërbime në drejtoratet/ zyret të cilët janë regjistruar në evidencë.

Mirëmbajtja e Automjeteve: Gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 mirëmbajtësi i veturave ka furnizuar 258 herë vetura zyrtare me karburant me gjithsej 12445.97 litra, 1 (një) furnizime me benzinë për kosa bar 20 litra, 3 (tre), furnizime karburant, si dhe naftë për nxemje për Sallën e Kulturës 500 litra, për gjenerator 65 litra naftë. Totali i shpenzimeve naftë dhe benzinë është 13030.97 litra për një vit. Gjatë këtij viti janë pajisur drejtoritë/zyrtaret me vetura zyrtare sipas kërkesave të tyre për kryerjen e punëve zyrtare. Janë servisuar 24 herë veturat gjatë vitit 2023, ju është vazhduar regjistrimin 12 veturave.

Postieri: Ka bërë shpërndarë postën për të gjitha Drejtoritë/Zyrat komunale, gjithsej 2644 shkresa të ndryshme (vendime, aktvendime, ftesa, kërkesa, ankesa etj) nëpër të gjitha fshatrat e komunës së Drenasit dhe në institucionet e ndryshme në Prishtinë.

Fokistët/sigurimi i brendshëm/mirëmbajtës: Kanë bërë mirëmbajtjen e klimës për objektin komunal, kanë bërë mirëmbajtjen e parkut, ka përcjellë punën e nxehjes për objektin e komunës si dhe punë e detyra tjera brenda dhe jashtë objektit të komunës sipas kërkesave dhe nevojave.

Spektori i Teknologjisë Informative: Duke e bazuar në zhvillimin dhe avancimin e shërbimeve digjitale dhe modernizimi i shërbimeve komunale, ne i kemi dhënë prioritet në ngritjen e këtyre shërbimeve. Implementimin e proceseve të e-shërbimeve dhe aplikacioneve në komune si: (Intraneti, Ueb-faqja, SMAED-i, SIMBNJ-a, SVMP-ja, e-Arkiva, e-Pasuria, GJC, Arka, etj.) ka lehtësuar punën për zyrtarë dhe qytetarë duke ju ofruar me të lehta dhe me të shpejta.

Është menaxhuar me rrjetin shtetërorë në institucionet komunale, sistemin e TI-ve, dhe proceseve të qeverisjes elektronike në administratën komunale. Kemi siguruar të gjitha të dhënat që ruhen në serverët e komunës dhe DATA Qendër. Kemi menaxhuar, mirëmbajtur dhe krijuar llogaritë zyrtare për zyrtarë dhe këshilltarë komunal, pajisjet zyrtare janë domain.

Me implementimin e aplikacioneve të E-Qeverisjes, komuna jonë monitorohet online nga MPL, si mbledhjet e kuvendit, performancën, aplikacioni i Intranetit dhe modulën e lejeve të ndërtimit. Qytetarët mund të marrin shërbimet e Gjendjes Civile në 7ditë/24 orë duke përdorur e-Kioskën në Drenas dhe Komoran.

Është mirëmbajtur sistemi i telefonisë VoIP, si dhe numri i telefonit për thirrje pa pagesë për qytetarët. Kemi marr pjesë në grupet punuese në ndërtimin dhe avancimin e aplikacioneve si: Intranet, ueb faqe, Implementimi i Strategjisë së E-Qeverisja 2023-2027. Tani kur proceset për shërbime elektronike po ecin me shpejtësi, ne si zyre bashkërisht me ASHI-në, duke shkëmbyer të dhëna për shërbimet komunale dhe duke ofruar mbështetje profesionale në platformën shtetërore E-Kosova, kemi ngritur disa shërbime të komunës që tani mund të shkarkohen nga qytetarët pa pasur nevojë për ti frekuentuar sportelet komunale.

Zyra e Prokurimit

Zyra e prokurimit gjatë periudhës Janar-Dhjetor ka zhvilluar 115 Procedura për projekte sipas Planit të Prokurimit për vitin 2023.

Prej tyre janë nënshkruar 114 kontrata si:

Vlera minimale 15

Kuotime të çmimeve 25

Procedura të hapura dhe të mesme 68

Procedurë me Negociata dhe Puna Shtesë 6

Të gjitha këto kontrata janë dërguar me kohë në Zyrën e Informimit për publikim dhe të njëjtat janë publike në ueb faqen e Komunës së Drenasit.

Zyra e Kuvendit

Kuvendi i Komunës së Drenasit gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2023 ka organizuar dhe mbajtur mbledhjet për Komitetin për Politikë e Financa dhe mbledhjet e Kuvendit Komunal.

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2023, Kuvendi Komunal ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje të rregullta, dhe katër mbledhje Solemne.

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor janë miratuar nga Kuvendi Komunal Drenas gjithsej 101 vendime prej tyre 91 janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe 3 vendime janë shfuqizuar ndërsa 7 janë rishqyrtuar, ndërsa 5 prej tyre ende nuk u kthye konfirmimi i ligjshmërisë për arsye se ende jemi brenda afatit ligjor.

Komiteti Konsultativë për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport (KKAKRS) gjatë periudhës Janar-Dhjetor ka mbajtur 2 mbledhje.

Komitetin Konsultativ Komunal për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (KKZHEMASHMS), gjatë periudhës Janar-Dhjetor ka mbajtur 3 mbledhje

Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara (KKPAK), gjatë periudhës Janar-Dhjetor ka mbajtur 3 mbledhje.

Komiteti Konsultativ për Barazi Gjinore (KKBGJ), gjatë periudhës Janar –Qershor ka mbajtur 4 mbledhje.

Këshilli Komunal për Siguri gjatë periudhës Janar-Dhjetor ka mbajtur 6 mbledhje.

Spektori i Arkivit

Në mënyrë tabelare më poshtë është paraqitur numri i lëndëve që janë kthyer për arkivim në mënyrë fizike sipas Programeve dhe Drejtorive.

1.	Zyra e Kryetarit të Komunës	468	Lëndë
2.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme dhe Zyra e Kuvendit	1.195	Lëndë
3.	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	0.00	Lëndë
4.	Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	0.00	Lëndë
5.	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	609	Lëndë
6.	Drejtoria për Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	419	Lëndë
7.	Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë	0.00	Lëndë
8.	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	13	Lëndë
9.	Drejtoria për Arsim	0.00	Lëndë
10.	Drejtoria për Kulture, Rini dhe Sport	0.00	Lëndë

11.	Drejtoria i Inspektimit Komunal	449	Lëndë
12.	Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë	49	Lëndë
13.	Zyra për Komunitete dhe Kthim	0.00	Lëndë
14.	Drejtoria për Infrastrukturë Lokale	0.00	Lëndë
	Gjithsej	2.783	Lëndë

Numri i lëndëve të arkivuar në mënyrë fizike për të gjitha programet për vitin 2023 është 2.783, krahasuar me vitin 2022 kemi 1450 lëndë me pak. Ndërsa, numri i lëndëve të arkivuara në mënyrë elektronike për të gjitha programet për vitin 2023 është 29484, i përafërt me vitet e kaluara.

Spektori i arkivit kryen edhe punë tjera në shërbime për qytetarë si:

Deklaratë për ushqim për vitin kalendarik [mbajtës i familjes] për bashkatdhetarë për të gjitha shtetet- 498 lëndë.

Certifikatë për shtesa të fëmijëve për punëtorët që kanë punuar në shtetet e huaja- 5 lëndë

Vërtetim mbi jetën për të gjithë bashkatdhetarët- 140 lëndë

Deklaratë e udhëtimit për shtetas të huaj- 5 lëndë

Legalizimin e të gjitha dokumenteve nga origjinali- 56 lëndë

Aktivitetet tjera me rëndësi:

Përfituese e Programit “Alumni Engagement Innovaton Fund 2023” me projektin “Youth Engagement, a Voice to Make an Impact” financuar nga Departamenti i Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, mbështetur nga Ambasada Amerikane dhe që administrohet nga Kusa-Shuma 24.956.05 dollarë;

Raportuese për Përformancë Komunal;

Koordinatorë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;

Koordinatorë e projektit “Komuna për të rinjtë” që financohet nga Qeveria Japoneze përmes Bankës Botërore

Drejtoria për Arsim

Të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e këtij Drejtorati, janë realizuar gjatë kësaj periudhe më përkushtim dhe më përgjegjësi të plotë.

Me prezantimin e këtij raporti do të jeni më afër të njohur dhe të informuar sidomos në aspektin zyrtar për punën, organizimin dhe zhvillimin transparent të politikave arsimore në Drenas.

Procesi arsimor gjatë këtij viti ka qenë vazhdimisht i përcjell me kujdes nga Departamenti jonë, ku të gjitha institucionet arsimore janë vizituar disa herë, si nga ana e Drejtorit, ashtu edhe nga zyrtarët e arsimit.

Në fund të çdo muaji kemi realizuar mbledhje të rregullta me drejtorë të institucioneve shkollore. Janë mbajtur takime të rregullta edhe më MASHTI-in, ku çdo detyrë e dhënë nga ana e tyre është realizuar me sukses nga ana jonë.

Struktura organizative - Këtë sektor e përbejnë 10 punëtorë:

Drejtori,

1 Udhëheqës sektori administrativ,

1 Udhëheqës sektori për buxhet dhe financa,

1 Udhëheqëse e sektori për arsim,

1 zyrtar për listën e pagave,

1 zyrtar për menaxhimin e projekteve,

1 zyrtare e prokurimit,

1 depoiste-zyrtare për pranimin e mallit,

1 zyrtare për buxhet dhe financave,

1 zyrtare për çështje pedagogjike,

1 zyrtar për çështje psikologjike.

Drenasi ka 1 Institucion parashkollor (me 2 paralele fizike), 30 shkolla fillore dhe të mesme të ultë, (2 paralele të ndara fizike), 2 shkolla të mesme të larta, gjithsejtë 37 objekte shkollore.

Ku punojnë gjithsejtë 968 punëtor dhe ndjekin mësimin e rregullt 10641 nxënës. 52 punëtor administrativ, 759 mësimdhënës, 130 punëtor teknik.

27 punëtor në nivelin arsimor 0 (Institucioni Parashkollor),

591 punëtor në nivelin arsimor 1 dhe 2,

168 punëtor në nivelin arsimor 3.

Janar – Qershor 2023

- Përgatitja për fillimin e gjysmë vjetorit të dytë/periodes së dytë për vitin shkollor 2022-2023;
- Analiza e suksesit për gjysmë vjetorin e parë/periodën e parë për vitin shkollor 2022-2023;
- Bartja dhe zbatimi i politikave arsimore, strategjive arsimore, Udhëzimeve Administrative nga MASHTI-DKA-Institucione Arsimore,
- Monitorimi kontinual i procesit edukativ në shkolla përmes zyrtarëve të arsimit, drejtorit të DKA-së dhe ekipit profesional të formuar me vendimin e Kryetarit të Komunës ,
- Sigurimi i cilësisë në arsim përmes koordinatorëve të cilësisë në nivel shkolle dhe komune;

- Organizimi i Shërbimit Pedagogjik —Psikologjik nëpër shkolla sipas kërkesave dhe nevojave të shkolla (-Parandalimi i braktisjes nga shkolla “Rilindja”, ShFMU “Halil Bajraktari”, ShFMU “Ali Gashi”),

Objektivat, strategjitë dhe aktivitetet për avancimin e procesit arsimor

- Zhvillimi, avancimi dhe ngritja e kapaciteteve në procesin mësimor në të gjitha nivelet shkollore: (parashkollor, arsimin fillor, arsimin e mesëm të ulët, arsimin e mesëm të lartë); Projekti i BE “ Përkrahje për arsimin fillor dhe të mesëm të lartë" nga zyra e BE-së për Arsim në Kosovë, implementuar nga organizata DAI dhe KosEd.
- Roli kryesor i këtij projekti është mbledhja e dëshmimeve që mbështesin dokumentin e vetëvlerësimit dhe çojnë në rekomandime konstruktive që do të përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësim nxënies në shkollë.
- Projekti i QAPA -AVANSIMI I PËRSHPEJTUAR I CILESISE SE ARSIMIT - STRATEGJIA 5 VJEQARE E ZHVILLIMIT TE ARSIMIT NE KOMUNEN E DRENASIT-Realizim I fazës së dytë, (Është mbajtur trajnim me temën “ Hartimin e Planit Zhvillimor të Shkollës “, me drejtor, mësimdhënës, nxënës dhe prindër).
- MASHTI në bashkëpunim me DKA-të dhe gjimnazet do të organizojnë “Java e informimit në gjimnaze për orientim në karrierë”(Orientimi në karrierë i referohet një sërë aktivitetesh të cilat janë përcaktuar për të ndihmuar nxënësit e kl. XII-ta të zgjedhin drejtimet e tyre në arsimin e lartë.
- Projekti I Giz-it “Orientimi në karrierë (prej 20 shkollave kampione të përzgjedhura nga GIZ-i, në kuadër të aktivitetit “Panairi i Karrierës” është zgjedhur ShFMU “Naim Frashri”, Gllobar,
- -Në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës organizimi i projektit » Java e Vajzave të TIK ». Qëllimi i përbashkët është rritja e qasjes së vajzave në fushat e TIK, STEM për rrugëtimin në karrierë e akademi. Përfshirja e nxënësve nga klasa e shtatë, tetë nëntë dhe të shkollave të mesme.
- MASHTI ka organizuar projektin »Shkolla Dimërore«, »Drejt Malit« në nivel të programit Qeverisë së Republikës së Kosovës Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Federata e Sportit Shkollor i Sportit., ky projekt mbështet zhvillimin e sportit shkollor fillor, mesëm të ulët ,
- Realizimi i programit të MASHTI-it “ Drejt Malit”, faza e dytë do të realizohet në Hiking, projekti mbështet zhvillimin e sportit shkollor në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta, promovimin e përfitimit të aktivitetit fizik përmes edukimit-jo-formal. Datat e realizuara nga 01-25/06/2023(26 ditë ecje).Në komunën e Drenasit janë të përfshira 500 nxënës, dhe 20 mësimdhënës, 1 koordinator komunal,
- Planifikimi dhe organizimi për trajnimin e mësimdhënësve, drejtorëve të Institucioneve Arsimore, si dhe stafit mbështetës pedagogjik-psikologjik sipas KKK-së;
- Vlerësimi i portofolieve të mësimdhënësve të cilët kanë ndjekur seminarin për praktikimin e KKK-së,

Vizita në institucione arsimore publike

- QEAP » Ardhmëria », Drenas, Qëllimi: Mbarëvajtja e procesit edukativ-mësimor, Mos vijueshmëria e mësimit të rregullt nga ana e nxënësve në SHFMU “Ali Gashi”, Çikatovë e Re, SHFMU “Rilindja“, Dobroshec
- Vlerësimi i performancës së gjashtë (6) drejtorëve të institucioneve arsimore publike parauniversitare, në përfundimin e mandateve,
- SHFMU “24 Korriku”, në Fushticë e Poshtëm, Qëllimi: Monitorimi i praktikumit të KKK nga ana e mësimdhënësve.
- SHFMU “Gani Elshani”, në Kroikovë, Qëllimi: Këshilla pedagogjike me nxënës të klasës së shtatë (7)

Marrëveshjet (realizimi i marrëveshjeve)

- DKA marrëveshje me GIZ / GAC për realizimin e projektit » GREEN EDUCATIONAL PROGRAM-GREEN CLUBS«, Qëllimi i projektit: Zhvillimi i aktiviteteve mjedisore me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të nxënësve për mbrojtjen e mjedisit. Pesë shkolla janë të përfshira në këtë projekt: SH.F.M.U “GANI ELSHANI”, Krojkovë, SH.F “BAJRAM CURRI”, Nekoc, SH.F. “RILINDJA”, Dobroshec, SH.F “GANI SYLAJ”, Poklek
- Organizim dhe festimi i festave të Marsit: 5, 6, 7 Mars »Epopeja e UÇK-së«, » 7 Marsi –Dita e Mësuesit«
- Akademia Tempulli së bashku me Asociacionin Kosovar të Motorizimit dhe MASHTI , Drejtor komunale, policia e Kosovës dhe Byroja Kosovare e sigurimit ka mbajtur - Ligjëratë online për njohjen e rregullave dhe shenjave të trafikut me nxënësit e shkollave të mesme,

Organizimi i garave të ndryshme për nxënësit në nivel shkolle

- Organizimi i Garave të Fizikës në nivel komunal, e mbajtur më datën 11/02/2023

Në nivelin arsimor 2 (klasa e nëntë/IX):

Vendi i Parë: Kodi: 13108, 60 Pikë, nxënësja Ornela Elshani, SHFMU “Naim Frashëri”, Gllobar,

Niveli arsimor 3 (klasa e dhjetë/X):

Vendi i Parë: Kodi :45406715, 65 Pikë, nxënësi Amrush Istogu, Gjinnazi " Gjergj Kastrioti Skënderbeu",

- Organizimi i Garave të matematikës në nivel komunal dhe pjesëmarrja e nxënësve në nivel nacional, ndërkombëtarë,
- Raportet e punës së drejtorëve për çdo muaj;
- Pajisja e shkollave me mjete të konkretizimit;
- Planifikimi dhe regjistrimi i fëmijëve në institucionin parashkollor, në klasën përgatitore-niveli arsimor 0, si dhe nxënësve në klasën e pare- niveli arsimor 1(arsimi

fillor) , për vitin shkollor 2023/2024, në bazë të infrastrukturës shkollore dhe ligjit dhe akteve nënligjore.

- Organizimi dhe mbajtja e testit të maturës- Provimi i maturës është mbajtur në dy institucione të arsimit publik parauniversitar, përkatësisht 6 qendra, 3 qendra në gjimnazin “ Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, Drenas II dhe 3 qendra në IAAP “Fehmi Lladrovci”, në Drenas II..
- Numri nxënësve të rregullt pjesëmarrës sipas planifikimit ishin 682, ndërsa pjesëmarrja në total e nxënësve ishte 788 duke u përfshirë nxënësit përsëritës.
- Kalueshmëria e provimit të maturës në IAAP “Fehmi Lladrovci”, në Drenas II është 64.5%, ndërsa
- ndërsa në gjimnazin “ Gjergj Kastrioti –Skënderbeu “, (62.94%)

Statistikat e vitit shkollor 2022/2023

Niveli arsimor 1-

- 210 paralele nga klasa e pare deri në klasën e pestë (1-5) janë 4078 nxënës, prej tyre 4045 nxënës me nota pozitive apo 99.19%, 21 nxënës me nota të pamjaftueshme 12 nxënës të panotuar (arsyeja: transfere emigrim, migrim).Mungesa: të arsyeshme 53 430, të paarsyeshme 9643, gjithsej 63 073.

Niveli arsimor 2-

- 175 paralele nga klasa e gjashtë deri në nëntë (1-9), janë 3446 nxënës, prej tyre 3251 nxënës me nota pozitive apo 94.34 %, 195 nxënës apo 5.66% me nota të pamjaftueshme, 8 të pa notuar (arsyeja: transfere emigrim, migrim). Mungesa: 76 941, të paarsyeshme 29 024, gjithsej mungesa 105 965.
- Numri I nxënësve në nivelin arsimor 1 dhe 2 janë 7296 nxënës.
- Gjithsej nxënës në nivelin arsimor 1 dhe 2 – 7296 nxënës.

Niveli 3 arsimor-

- Gjimnazi “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” - 848 nxënës nga klasa e 10-12, me nota pozitive 597 nxënës apo 70.54%, me nota jo pozitive 194 nxënës apo 22.73%, nxënës të panotuar 57 nxënës apo 6.73% (arsyeja: transfere emigrim, migrim). Nota mesatare 3.42.
- IAAP” Fehmi Lladrovci”-66 paralele nga klasa e 10-12 1286 nxënës, me nota pozitive 1210 nxënës, me nota të pamjaftueshme 72 nxënës, 4 të panotuar (arsyeja: transfere emigrim, migrim). Mungesa: të arsyeshme 24 190, të paarsyeshme 10 370, gjithsecilit 34 560, nota mesatare 3.02.
- Gjithsej nxënës në nivelin arsimor 3 – 2134, nota mesatare: 3.22
- Përqindja e testit të arritshmërisë në nivel komunal: 48.08%
- Kalueshmëria e provimit të maturës në IAAP “Fehmi Lladrovci”, në Drenas II është 64.5%, ndërsa në gjimnazin “ Gjergj Kastrioti –Skënderbeu”, është 62.94%.

Kalueshmëria në nivel komunal është: 63.73%

Takime të ndryshme

- MASHTI

- Pjesëmarrja në grupe punuese në kuadër të asociacionit të komunave, në nivel të kolegjiut të drejtorëve të DKA-së, për zbatueshmëri të politikave arsimore dhe politikave të reja...
- Operativen policore
- KFOR
- OJQ,
- Takim me KFOR-(Slloven) Tema: Siguria në Shkolla
- Takime të rregullta me drejtorët e shkollave;
- Procesimi i lëndëve në intranet
- Punë me pale

Vlerësim i jashtëm i testit TIMSS dhe ICILS, janë të përfshira 4 SHFMU

«Rasim Kiçina», Drenas,
 »Naim Frashëri«, Gllobar,
 »Gani Elshani«, Krojkovë,
 »Hasan Prishtina«, Llapushnik

Periudha Korrik - Dhjetor 2023

- Bartja e politikave arsimore nga MASHTI –DKA- Institucione arsimore si dhe zbatimi i tyre,
- Mbajtja e testit të arritshmërisë (është realizuar në 6 qendra 3 qendra në SHMP “Fehmi Lladrovci”, 2 qendra në gjimnazin “ Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, 1 qendër në ShFMU “Rasim Kiçina”, numri total i nxënësve 867, 67 administrues, 18 komisionerë.
- Shpallja e konkursit për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) në nivelin arsimor 3 (arsimi i mesëm të lart), Shpallja e listave të nxënësve të regjistruar në klasën e dhjetë (10) në nivelin arsimor 3,
- Kryesuese e shqyrtimit të konkurseve nga sektori i arsimit,
- Vlerësimi sistematik i Nxënësve me Nevoja të Veçanta nga Ekipi për Vlerësimin Pedagogjik të

Nxënësve me Nevoja të Veçanta (Zyrtari komunal i arsimit gjithëpërfshirës, Psikologu, Punëtori social dhe Mësimdhënësi mbështetës);

- Hartimi i planit PIA për nxënësit me nevoja të veçanta;
- Sigurimi i cilësisë në arsim përmes koordinatoreve të cilësisë në nivel shkolle dhe komune;
- Ndarja e mirënjohjeve dhe shpërblimeve për nxënës, arsimtarë, shkolla dhe drejtorë;
- Analiza e përfundimit të periudhës së dytë dhe tretë sipas KKK-së për vitin shkollor 2022/2023;
- Kremtimi i Ditëve të shkollave;
- Organizimi i garave të ndryshme për nxënësit në nivel shkolle dhe komune,
- Pajisja e shkollave me mjete të konkretizimit;

- Regjistrimi i fëmijëve në institucionin parashkollor, në klasën përgatitore-niveli arsimor 0, si dhe nxënësve në klasën e pare- niveli arsimor 1(arsimi fillor) dhe klasën e dhjetë(10) –niveli arsimor 3(arsimi i mesëm i lartë) për vitin shkollor 2023/2024, në bazë të infrastrukturës shkollore dhe ligjeve në fuqi;
- Merren shënimet në zyrat për regjistrim dhe në shkolla;
- Përfshirja e të gjithë fëmijëve, nxënësve në institucione edukative arsimore sipas kapaciteteve infrastrukturore në institucione edukative arsimore, rregulloreve, udhëzimeve administrative, ligjit në fuqi;
- Monitorimi kontinual i procesit mësimor në shkolla përmes zyrtarëve të arsimit, drejtorit të DKA-së dhe ekipit profesional të formuar me vendimin e Kryetarit të Komunës;
- Përgatitjet për përfundimin e procesit mësimor për klasat përfundimtare (IX dhe XII), mbajtja e mësimit shtesë (përgatitor) për maturantë;
- Përgatitjet dhe monitorimi i Testit Shtetëror të Maturës (afati dytë/gusht),
- Analiza mbi shkaqet e mos vijimit, të procesit mësimor nga nxënësit;
- Analizë e suksesit të vlerësimit për vitin shkollor 2022/2023;
- Objektivat, strategjitë për avancimin, si dhe ngritjen e kapaciteteve për procesin edukativ arsimor;
- Mbikëqyrja e ndarjeve të orëve të mësimit me zgjedhje, sipas udhëzimit administrativ në fuqi nga komisioni i formuar në kuadër të DKA-së;
- Pajisja e fëmijëve, nxënësve me tekste shkollore për vitin shkollor 2023/2024;
- Furnizimi i shkollave me dokumentacion pedagogjik dhe material shpenzues;
- Koordinim, bashkëpunim me menaxherët tjerë në institucion për avancim dhe promovimin e vlerave në fushën e arsimit;

Trajnime, fushata vetëdijesuese - janar-dhjetor 2023

- Trajnim për mësimdhënës/e “Praktikimi i Kornizës Kurrikulare të Kosovë“ (257 mësimdhënës/e pjesëmarrës/e) Një (1) trajnim “SOFTWER”, në IAAP “Fehmi Lladrovci”, Drenas
- Trajnime vetëdijesuese të mbajtura DKA dhe Policia e Drenasit: “ Bullizimi dhe masat parandaluese”, ” Pasojat e përdorimit të narkotikëve” “ Dhuna Familje”, “ Parandalimi i ngacmimeve seksuale, “ Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm”, “ Siguria e qarkullimit të këmbësorëve” Ruajtja e ambientit e trashëgimisë kulturore”, “Trafikimi”
- Sensibilizim “31 Maj” Dita ndërkombëtare e pirjes së duhanit, e organizuar nga nxënësit e gjimnazit “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, Drenas e përkrahur nga DKA.
- Mbajtja e aktivitetit të ligjëratës/prezantimit inspirues për qasjen e vajzave në fushat e TIK, STEM për rrugëtim në karrierë e akademi.
- Konferencë vetëdijesuese “Kundër Duhanit”, e organizuar nga nxënësit e Gjimnazit “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu”, Drenas,

Në bashkëpunim DKRS shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve “1 Qershori”,

Duke e marrë parasysh kryerjen e punëve në sektorin për administratë dhe personel në kuadër të Drejtorisë për Arsim, punët që janë kryer prej datës 01.01.2023 deri më 31.12.2023, janë hartuar shkresa, vendime, njoftime, pëlqime, konkurse, etj. si vijon:

Konkurse	32
Rishpallje të konkursit	18
Shpallje të rezultateve të konkurseve	32
Vendime të komisioneve intervistuese	35
Vendime për transferim	7
Vendime të lehonisë	45
Aktvendime për pensionim	23
Aktvendime për ndërprerje të marrëdhënies së punës	18
Aktvendime të pushimeve pa pagesë	13
Vendim të ndryshme	103
Aktvendime tjera të ndryshme	457
Njoftime të ndryshme	299
Hartimin e pëlqimeve të ndryshme	75
Hartimin e kërkesave të ndryshme	11

Janë kryer edhe punë tjera administrative, teknike, në bashkëpunim me Drejtorin e Drejtoratit, Drejtoret e Institucioneve edukativo –arsimore, me stafin e DKA-së për nevojat e Drejtoratit të Arsimit, përmes shkresave, i meilave zyrtare dhe komunikimeve telefonike.

Shefi i sektorit për administratë dhe personel ka kryer edhe shumë punë tjera jashtë detyrave të tij të punës për Administratën Komunale të Komunës, si: nxjerrjen për çdo muaj të listave të pagave dhe dërgimin me imell tek personat kompetent zyrtar, pastaj punën në Komisionin disiplinor të Komunës së Drenasit si kryesues i këtij komisioni, si anëtar i komitetit të auditimit të brendshëm, pastaj si kryesues i komisionit për ndarjen e bursave komunale, si dhe anëtar në disa komisione të rekrutimit të brendshëm, etj.

Përmbledhje e projekteve kryesore për vitin 2023 në drejtorinë e Arsimit:

- Hartimi i “Strategjisë 5 vjeçare të Zhvillimit të Arsimit në Komunën e Drenasit”, pjesë e projektit “Avancimi i Përshpejtuar i Cilësisë së Arsimit në Komunën e Drenasit”, i implementuar nga ekspertët e arsimit (QAPA) të financuar nga Komuna e Drenasit.

Për here të parë një dokument shumë i rëndësishëm i hartuar nga ekspert të arsimit i cili do të jetë udhërrëfyes për avancimin e cilësisë së arsimit në Komunën e Drenasit.

- Trajnimi i drejtoreshave të shkollave, mësuesve, nxënësve prindërve, këshillave drejtuese të shkollave për hartimin dhe zbatimin e planeve zhvillimore të shkollave (PZHSH).
- Zhvillimi, avancimi dhe ngritja e kapaciteteve në procesin mësimor në të gjitha nivelet shkollore: (parashkollor, arsimin fillor, arsimin e mesëm të ulët, arsimin e mesëm të lartë); shtrirja e projekti të BE-së “Përkrahje për arsimin fillor dhe të mesëm të lartë”, për Arsim në Kosovë, implementuar nga organizata DAI dhe KosEd. Nga zyra e BE-së kemi marrë vlerësim maksimal dhe jemi model për komunat tjera në implementimin e këtij projekti.

Roli kryesor i këtij projekti është mbledhja e dëshmive që mbështesin dokumentin e vetëvlerësimit dhe çojnë në rekomandime konstruktive që do të përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në shkollë.

- Organizimin e garave të matematikës në nivel regional dhe nacional me rezultate mjaftë të mira, duke kontribuar me përfaqësim të nxënësve në ekipin Shtetëror i cili do ta përfaqësojë Kosovën në garat e Matematikës që do mbahen në Tokio të Japonisë.
- Trajnim për mësuesdhënës/e “Praktikimi i Kornizës Kurrikulare të Kosovë “(257 mësuesdhënës/e pjesëmarrës/e).

Pajisja me Laptop/Pc, përveç kabineteve të TIK-ut të cilat kanë qenë të kompletuara, tani secila klasë në secilën shkollë të Komunës së Drenasit është e pajisur me laptop. Vlera e projektit: 94, 000.00 euro.

- Pajisja e secilës shkollë me tabela të mençura, vlera e projektit: 60, 000.00 Euro.
- Furnizimi I të gjitha shkollave me material didaktik.
- Renovimi nga Ambasada Amerikane i ShFMU “Zenel Hajdini” – Tërstenik, në vlerë rreth 500, 000 euro.
- Investimi në masa eficiente në 4 shkolla në vlerë: 561, 031.31 Euro.
 - ShFMU “Shotë Galica”, Abri - 194, 914.66 Euro
 - ShFMU “Migjeni”, Baicë - 192, 555.90 Euro
 - ShFMU “Shaban Polluzha”, Polluzhë -92, 505.65 Euro
 - ShFMU “24 Korriku”, Fushticë e Ulët – 81, 055.10 Euro
- Ndertimi i rrethojave të fushave sportive në 4 Shkolla, në vlerë: 40, 000.00 Euro.
- Renovimi i Objekteve shkollore në vlerë: 196, 000.00 Euro
- Ndertimi i këndeve të lojrave dhe rekreacion në vlerë: 40, 000.00 Euro.
- Kabineti në SHFMU Dëshmorët e Drenicës, SHMP “Fehmi .Lladrovci”, “Dëshmoret e.Fortesës”, “Shaban Polluzha”, “Mehdi dhe Sylejman Bytyqi”, në vlerë 50, 000 euro.
- Pajisja e të gjitha shkollave me kabinate të matematikës.
- Ndertimi i parkingjeve dhe platove në: “Shotë Galica”, “Gani.Syla”, “7.Marsi”, “Xhevë Lladrovci”, “Hasan Prishtina” dhe “Shaban.Polluzha”, në vlerë 30,000 euro
- Vazhdimi i punimeve në palestrën sportive në gjimnaz.

Projektet e realizuara në shkollën profesionale:

- Drejtimi i Bujqësisë: 3.496 euro (pajisje dhe material shpenzues për praktikën profesionale)

- Drejtimi i Ekonomisë: 2.950 euro (softwer i kontabilitetit për praktikën profesionale)
 - Drejtimi i Makinerisë: 9.900 euro (pajisje dhe material shpenzues për praktikën profesionale)
 - Drejtimi i Dizajnit: 9.900 euro (pajisje dhe material shpenzues për praktikën profesionale)
- Pasurimi i bibliotekave të shkollave me libra.
- Sigurimi i transportit për 659 nxënës.

Raport i Shpenzimeve të Buxhetit për periudhën Janar - Dhjetor 2023

Grantet qeveritare: ADMINISTRATA E ARSIMIT

NËNPROGRAMET	Kodi i Nën programit	PLANIFIKIMI	ALOKIMET	SHPENZIMET	% e realizimit sipas buxhetit të aprovuar	% e realizimit sipas buxhetit të alokuar
Administrata e Arsimit	92005	2023	2023	2023	2023	2023
Pagat	92005	77, 139.00	85, 940.48	85, 940.48	111.41	100.00
Mallra dhe shërbime GQ	92005	230, 000.00	230, 000.00	219, 988.33	95.65	95.65
Gjithsej:	92005	307, 139.00	315, 940.48	305, 928.81	99.61	96.83

Grantet qeveritare: QEAP"ARDHMËRIA"

NËNPROGRAMET	Kodi i Nën programit	PLANIFIKIMI	ALOKIMET	SHPENZIMET	% e realizimit sipas buxhetit të aprovuar	% e realizimit sipas buxhetit të alokuar
Arsimi parafillor	92210	2023	2023	2023	2023	2023
Pagat	92210	178, 656.00	181, 527.90	181, 527.90	101.61	100.00
Mallra dhe shërbime	92210	21, 482.00	21, 482.00	19, 542.41	90.97	90.97
Shpenzimet komunale	92210	6, 549.00	6, 549.00	4, 972.54	75.93	75.93
Gjithsej:	92210	206, 687.00	209, 558.90	206, 042.85	99.69	98.32

Arsimi Fillor

NËNPROGRAMET	Kodi i Nën programit	PLANIFIKIMI	ALOKIMET	SHPENZIMET	% e realizimit sipas buxhetit të aprovuar	% e realizimit sipas buxhetit të alokuar
Arsimi fillor	93000	2023	2023	2023	2023	2023
Pagat	93000	4,628,133.00	5,889,433.14	5,889,433.14	127.25	100.00
Mallra dhe shërbime	93000	424,175.60	424,175.80	396,182.69	93.40	93.40
Shpenzimet komunale	93000	65,000.48	65,000.48	59,034.88	90.82	90.82
38 REZERVAT	93000	43,000.00	43,000.00	-	-	-
Gjithsej:	93000	5,160,309.08	6,421,609.42	6,344,650.71	122.95	98.80

Arsimi i Mesëm

NËNPROGRAMET	Kodi i Nën programit	PLANIFIKIMI	ALOKIMET	SHPENZIMET	% e realizimit sipas buxhetit të aprovuar	% e realizimit sipas buxhetit të alokuar
Arsimi i mesëm	94200	2023	2023	2023	2023	2023
Pagat	94200	1,319,142.00	1,640,457.36	1,640,457.36	124.36	100.00
Mallra dhe shërbime	94200	125,472.00	125,472.00	104,782.74	83.51	83.51
Shpenzimet komunale	94200	22,000.00	21,999.52	15,310.28	69.59	69.59
Gjithsej:		1,466,614.00	1,787,928.88	1,760,550.38	120.04	98.47

Të Hyrat vetanake: Administrata e Arsimit

NËNPROGRAMET	Kodi i Nën programit	PLANIFIKIMI	ALOKIMET	SHPENZIMET	% e realizimit sipas buxhetit të aprovuar	% e realizimit sipas buxhetit të alokuar
Administrata e Arsimit	92005	2023	2023	2023	2023	2023
20 Subvencione	92005	80,000.00	80,000.00	79,749.00	99.69	99.69
Gjithsej:	92005	80,000.00	80,000.00	79,749.00	99.69	99.69

Të hyrat vetanake: Arsimi parafillor-çerdhet, QEAP “Ardhmëria”

NËNPROGRAMET	Kodi i Nën programit	PLANIFIKIMI	ALOKIMET	SHPENZIMET	% e realizimit sipas buxhetit të aprovuar	% e realizimit sipas buxhetit të alokuar
Arsimi Parafillor-çerdhet	92211	2023	2023	2023	2023	2023
Mallra dhe shërbime	92211	26,000.00	26,000.00	16,934.35	100.00	65.13
Gjithsej:	92005	26,000.00	26,000.00	16,934.35	65.13	65.13

Arsimi Fillor, të Hyrat Vetanake

NËNPROGRAMET	Kodi i Nën programit	PLANIFIKIMI	ALOKIMET	SHPENZIMET	% e realizimit sipas buxhetit të aprovuar	% e realizimit sipas buxhetit të alokuar
Arsimi fillor	93000	2023	2023	2023	2023	2023
53687 KABINETE NË SHKOLLA	93000	50,000.00	50,000.00	49,875.00	99.75	99.75
Gjithsej:	93000	50,000.00	50,000.00	49,875.00	99.75	99.75

Të Hyrat Vetanake nga viti i kaluar/2022: Administrata e Arsimit

NËNPROGRAMET	Kodi i Nën programit	PLANIFIKIMI	ALOKIMET	SHPENZIMET	% e realizimit sipas buxhetit të aprovuar	% e realizimit sipas buxhetit të alokuar
Administrata e Arsimit	92005	2023	2023	2023	2023	2023
Mallra dhe shërbime	92005	108,642.60	108,642.60	108,642.60	100.00	100.00
Subvencione	92005	2,500.00	2,500.00	2,000.00	80.00	80.00
Gjithsej:	92005	111,142.60	111,142.60	110,642.60	99.55	99.55

Të Hyrat Vetanake nga viti i kaluar/2022: Arsimi Parafillor-Çerdhet

NËNPROGRAMET	Kodi i Nën programit	PLANIFIKIMI	ALOKIMET	SHPENZIMET	% e realizimit sipas buxhetit të aprovuar	% e realizimit sipas buxhetit të alokuar
QEAP"ARDHMËRIA"	92210	2023	2023	2023	2023	2023
Mallra dhe shërbime	92210	27, 822.30	27, 822.30	14, 927.05	53.65	53.65
Gjithsej:	92005	27, 822.30	27, 822.30	14, 927.05	53.65	53.65

Arsimi Fillor, Kapitalet

NËNPROGRAMET	Kodi i Nën programit	PLANIFIKIMI	ALOKIMET	SHPENZIMET	% e realizimit sipas buxhetit të aprovuar	% e realizimit sipas buxhetit të alokuar
Arsimi fillor	93000	2023	2023	2023	2023	2023
53691 Ndërtimi i fushave të jashtme sportive dhe rrethojave	93000	10, 000.00	10, 000.00	9, 750.01	97.50	97.50
Gjithsej:	93000	10, 000.00	10, 000.00	9, 750.01	97.50	97.50

Kapitalet: Grantet Qeveritare

NËNPROGRAMET	Kodi i Nën programit	PLANIFIKIMI	ALOKIMET	SHPENZIMET	% e realizimit sipas buxhetit të aprovuar	% e realizimit sipas buxhetit të alokuar
ARSIMI FILLOR	93000	2023	2023	2023	2023	2023
53684 DIGJITALIZIMI I SHKOLLAVE(SOFTWER)	93000	60,000.00	60,000.00	50,652.00	100.00	84.42
53686 PAJISJE TË TIK-ut	93000	60,000.00	60,000.00	59,132.48	98.55	98.55
53689 NDËRTIMI I PARKINGJEVE DHE PLATOVE TË SHKOLLAVE	93000	30,000.00	30,000.00	28,464.52	94.88	94.88
53691 NDËRTIMI I FUSHAVE TË JASHTME SPORTIVE DHE RRETHOJAVE TË SHKOLLAVE	93000	30,000.00	30,000.00	30,000.00	100.00	100.00
53696 KËNDI PËR LOJRA DHE REKREACION PËR SHKOLLA	93000	40,000.00	40,000.00	40,000.00	100.00	100.00

RAPORT I PUNËS SË KRYETARIT LLADROVCI DHE DREJTORIVE PËR VITIN 2023

53700 NDËRTIMI I RRETHOJAVE TË SHKOLLAVE, NYJEVE SANITARE, NGJYROSJA	93000	78,000.00	78,000.00	74,289.84	95.24	95.24
53706 INSTALIMI I NXEMJEVE QENDRORE TË SHKOLLAVE	93000	14,000.00	14,000.00	11,777.77	84.13	84.13
Gjithsej:	93000	312,000.00	312,000.00	294,316.61	94.33	94.33

92005/ADMINISTRATA	315,940.48	305,928.81	305,928.81
	80,000.00	146,558.35	79,749.00
	111,142.60	110,642.60	110,642.60
GJITHËSEJ:	507,083.08	563,129.76	496,320.41

92210/ARSIMI PARAFILLOR QERDHET	209,558.90	206,042.85	206,042.85
	26,000.00	16,934.35	16,934.35
	27,822.30	14,927.05	14,927.05
GJITHËSEJ:	263,381.20	237,904.25	237,904.25

93000/ARSIMI FILLOR	6,421,609.42	6,344,650.71	6,344,650.71
	312,000.00	294,316.61	294,316.61
	50,000.00	49,875.00	49,875.00
	10,000.00	9,750.01	9,750.01
GJITHËSEJ:	6,793,609.42	6,698,592.33	6,698,592.33

94200/ARSIMI I MESËM	1,787,928.88	1,760,550.38	1,760,550.38
GJITHËSEJ:	1,787,928.88	1,760,550.38	1,760,550.38

920/ ARSIM DHE SHKENCË						
	92005/ADMINISTRATA	507,083.08	563,129.76	496,320.41	% e realizimit sipas buxhetit të aprovuar	% e realizimit sipas buxhetit të alokuar
	92210/ARSIMI PARAFILLOR QERDHET	263,381.20	237,904.25	237,904.25	90.33	100.00
	93000/ARSIMI FILLOR	6,793,609.42	6,698,592.33	6,698,592.33	98.60	100.00
	94200/ARSIMI I MESËM	1,787,928.88	1,760,550.38	1,760,550.38	98.47	100.00
	GJITHSEJ:	9,352,002.58	9,260,176.72	9,193,367.37	98.30	99.28

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Raporti vjetor i punës (janar – dhjetor 2023)

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në Komunën e Drenasit gjatë vitit 2023 (Janar –Dhjetor 2023) në kuadër të fushë veprimtarisë ka ofruar këto punë/shërbime zyrtare të bazuar në Statutin e Komunës, në harmoni me ligjet e Kuvendit të Kosovës, aktet tjera nënligjore, Rregulloret e miratuara nga Kuvendi Komunal i Drenasit, dokumenteve strategjike dhe planin e punës për vitin 2023.

Punës/shërbimet e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik fokus të veçantë i është kushtuar hartimi dhe realizimit të politikave zhvillimore, marrja e masave sa më të përshtatshme për të nxituar më tutje zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të komunës së Drenasit, krijimin e kushteve sa më favorshme, infrastrukturë dhe mjedisit sa më të përshtatshme për zhvillim të ndërmarrjeve të vogla, mesme për një zhvillim sa më të qëndrueshëm.

Fokus të veçantë vazhdon ti jepet promovimit të zhvillimit ekonomik, turizmit, zbutjes së papunësisë duke i mundësuar gjenerimin e vendeve të reja të punës.

Pra Drejtoria për Zhvillim Ekonomik vazhdon me intensifikimin e angazhimeve të saj drejt përmirësimit të klimës së të bërit biznes, promovimin e komunës së Drenasit si një Komunë atraktive, për investitorët strategjik për të investuar dhe për tu vizituar, gjithmonë e hapur ndaj ideve inovative dhe projekteve të reja smart, gjithmonë duke ofruar shërbime/konsulenca profesionale.

Përmbledhje:

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtori:

Regjistrimi i bizneseve fillestare (të gjitha bizneset individuale B.I shoqëritë aksionare, ortakëri e përgjithshme, ortakëri e kufizuar, shoqëria e huaj tregtare, ndërmarrjet shoqërore dhe kooperativat bujqësore;

Regjistrimi i ndryshimeve në biznes;

Pajisje me certifikata të reja me numër Unifikues;

Pajisja me informata shtesë për biznes;

Protokollimi i të gjitha lëndëve që kanë të bëjnë me biznes;

Raportet javore, mujore pranë MTI;

Vërtetime për persona fizik që nuk ushtrojnë veprimtari biznese;

Vërtetime që nuk posedojnë obligime të taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste biznese;

Shqyrtimi i lëndëve: kërkesave, ankesave dhe të ngjashme;

Ngarkesa e taksës komunale për biznese;

Inkasimi i taksës komunale për biznese (pagesat);

Konsulenca me palët/bizneset si dhe

Punë dhe angazhime tjera në komisione.


Raport vjetor për regjistrim të bizneseve për vitin 2023

Sipas zyrës për biznese, numri i bizneseve të regjistruara nga data 01.01.2023 deri me datën 31.12.2023 janë të regjistruara 216 biznese të reja, krahasuar me vitin paraprak të njëjtës periudhë që ishin regjistruar 190 biznese ose shprehur në përqindje 12% më shumë se në vitin e kaluar, të cilat biznese në bazë të deklarimeve të tyre punësojnë 215 punëtorë.

Bizneset fillestare brenda ditës pajisen me certifikatën e biznesit me Numër Unifikues të biznesit, si dhe jepen konsulenca të ndryshme të kësaj natyre për ta krijuar një ambient sa me të volitshëm për regjistrim dhe të gjitha ndryshimet e nevojshme në biznes. Shikuar në bazë të kësaj periudhe ky numër i bizneseve të regjistruara duket si vijon :

Tabela e klasifikimit të bizneseve të regjistruara në periudhën: 01.01.2023– 31.12.2023

Klasifikimi sipas madhësisë	Numri i punëtorëve	Numri i bizneseve	Përqindja në total
Të vogla	1-5	83	38.4%
Të mesme	5 – 60 (Sh.p.k.)	133	61.6%
Të mëdha	60 - e më tepër	0	0 %
Gjithsejtë:		216	100.00%



I. Tabela e klasifikimeve të bizneseve sipas Sektorëve

Nr.	SEKTORËT E BIZNESEVE	Bizneset sipas sektorëve	Përqindja
-----	----------------------	--------------------------	-----------


1	Sektori A- BUJQËSIA, PYLLTARIA DHE PESHKIMI	2	0.92%
2	Sektori C- INDUSTRIA PËRPUNUESE	28	13%
3	Sektori D- FURNIZIMI ME RRYMË, GAZ, AVULL DHE AJËR TË KONDICIONUAR	0	0%
4	Sektori E- FURNIZIMI ME UJË; KANALIZIMI, VEPRIMTARITË E MENAXHIMIT DHE TË TRAJTIMIT TË MBETURINAVE	2	0.92%
5	Sektori F-NDERTIMTARIA	59	27.3%
6	Sektori G-TREGTIA ME SHUMICË DHE PAKICË; RIPARIMI I MJETEVE MOTORIKE DHE MOTOÇIKLETAVE	51	23.61%
7	Sektori H- TRANSPORTI DHE MAGAZINIMI	3	1.38%
8	Sektori I-AKOMODIMI DHE SHËRBIMI USHQIMOR	17	7.9%
9	Sektori J- INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI	3	1.38%
10	Sektori K- VEPRIMTARITË FINANCIARE DHE TË SIGURIMT	0	0%
11	Sektori M- VEPRIMTARITË PROFESINALE, SHKENCORE DHE TEKNIKE	18	8.33%
12	Sektori N- SHËRBIMET ADMINISTRATIVE DHE MBËSHTETËSE	14	6.5%
13	Sektori P- ARSIMI	2	0.92%
14	Sektori Q- VEPRIMTARITË E SHËNDETITI TË NJERIUT DHE TË PUNËS SOCIALE	4	1.84%
15	Sektori S- VEPRIMTARITË E TJERA SHËRBYESE	13	6%



Gjithsejt....


216

100%



II. Bizneset e regjistruara në Komunën e Drenasit sipas tipit të biznesit në periudhën 01.01.2021 – 31.12.2023


Nr.	Lloji i pronësisë	Numri i bizneseve	Përqindja
1	Biznes individual (B.I)	83	38.4%
2	Ortakëri e përgjithshme	/	
3	Ortakëri e kufizuar	/	
4	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar(SH.P.K.)	133	61.6%
5	Shoqëri Aksionare	/	
6	Ndërmarrje në pronësi të huaj	/	
7	Ndërmarrje publike	/	
8	Kooperativë bujqësore	/	
	TOTALI:	216	100.00%



Të dhënat nga regjistrimi i biznesit të paraqitura në tabelën e mësipërme ofrojnë informata në lidhje me strukturën pronësore të bizneseve të regjistruara me 01.01.2023 – 31.12.2023 në Komunën e Drenasit, Bizneset SHPK gjatë kësaj periudhe ekskluzivisht dominojnë strukturën pronësore bizneset SHPK me 61.6% dhe 38.4% BI të, regjistrimi i tipit të biznesit SHPK. Edhe këtë periudhë ka treguar një rritje të konsiderueshme krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.


III. *Ndryshime në biznes sipas periudhës: 01.01.2023 – 30.06.2023;*

Nr.	Muajt e vitit	I	II	III	IV	V	VI	VI	VII	VIII	X	XI	XII
1.	Ndryshimet në biznese	5	14	17	9	5	20	13	13	12	17	12	12
2	Shuarjet	2	3	5	7	4	2	0	1	0	4	7	6
3	Ripërtrirjet	4	1	2	0	0	1	0	0	0	2	2	0



IV. Punë/ shërbime tjera, gjatë periudhës: 01.01.2023 – 31.12.2023;


Nr.	Shërbimet/Lëndët	Totali:
1	Certifikata të reja për biznese fillestare	216
2	Ndryshimet në biznese	149
3	Shuarje të bizneseve	41
4	Certifikata të ripërtërira	12
5	Certifikatë duplikat	18
6	Informata shtesë	208
7	Vërtetime për persona fizik që nuk ushtrojnë veprimtari biznesore.	28
8	Vërtetime për persona fizik që ushtrojnë veprimtari biznesore	2



VI. Tabela e pagesave të taksës komunale gjatë periudhës: 01.01.2023 – 31.12.2023;

Nr.	Pagesat e bizneseve gjate vitit 2023	Shuma	Përqindja
1	Pagesa e bizneseve për muajin Janar	5, 960.00	1.84%
2	Pagesa e bizneseve për muajin Shkurt	16, 660.00	5.14%
3	Pagesa e bizneseve për muajin Mars	25, 450.00	7.84%
4	Pagesa e bizneseve për muajin Prill	26, 890.16	8.3%

5	Pagesa e bizneseve për muajin Maj	13, 609.54	4.2%
6	Pagesa e bizneseve për muajin Qershor	68, 886.10	21.3%
7	Pagesa e bizneseve për muajin Korrik	3, 300.00	1.01%
8	Pagesa e bizneseve për muajin Gusht	14, 955.50	4.6%
9	Pagesa e bizneseve për muajin Shtator	16, 371.30	5.05%
10	Pagesa e bizneseve për muajin Tetor	22, 660.00	6.99%
11	Pagesa e bizneseve për muajin Nëntor	68, 518.05	21.13%
12	Pagesa e bizneseve për muajin Dhjetor	40, 862.25	12.60%
Totali i pagesave për vitin 2023		324, 122.90	100%



VII., Tabela e deklarimeve me zero të taksës komunale gjatë periudhës:
01.01.2023 – 31.12.2023;

Nr.	Deklarimet e bizneseve gjatë vitit 2023	Shuma	Përqindja
1.	Deklarimet e bizneseve për muajin Janar	9, 680.00	8.8%
2.	Deklarimet e bizneseve për muajin Shkurt	12, 290.00	11.25%
3.	Deklarimet e bizneseve për muajin Mars	30, 580.00	28.17%
4.	Deklarimet e bizneseve për muajin Prill	5, 000.00	4.5%
5.	Deklarimet e bizneseve për muajin Maj	7, 050.00	9.28%
6.	Deklarimet e bizneseve për muajin Qershor	11, 450.00	6.45%
7.	Deklarimet e bizneseve për muajin Korrik	450.00	0.49%
8.	Deklarimet e bizneseve për muajin Gusht	10, 850.00	9.97%
9.	Deklarimet e bizneseve për muajin Shtator	16, 740.00	16.33%
10.	Deklarimet e bizneseve për muajin Tetor	1, 860.00	1.70%
11.	Deklarimet e bizneseve për muajin Nëntor	3, 100.00	2.86%
12.	Deklarimet e bizneseve për muajin Dhjetor	200.00	0.20%
Totali i pagesave për vitin 2023		109, 150.00	100



Hartimi i aktvendimeve të taksen komunale të ushtrimit të veprimtarisë biznese në territorin e komunës së Drenasit sipas kartelave dhe faturave të bazuar në rregulloren komunale për taksa , tarifa, ngarkesa dhe gjoba.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve që ofron kjo drejtori kanë marrë pjesë stafi sipas kërkesës në;

- Pjesëmarrja në ceremoninë e lansimit të fazës së dytë të projektit “I SEE” - Mundësitë e përmirësuara të vetë-punësimit dhe punësimit – “Women 4 Women”
- Pjesëmarrja në trajnimin “Konsultimi Publik Lokal” i cili zhvillohet në fushën Çështje Komunale nga IKAP.
- Pjesëmarrja në trajnimin e organizuar nga Instituti për Politika Zhvillimore në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, të mbështetur nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ) nëpërmjet GIZ, dhe IKAP, tema ‘Harmonizimi i Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal me agjendat për zhvillim të qëndrueshëm’
- Pjesëmarrja në konferencën vjetore me titull “NJË DEKADË E GJYSMË NGA DECENTRALIZIMI“ organizuar Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale.
- Pjesëmarrja në trajnimin e organizuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) “Integriteti dhe Etika në Administratën Publike” në fushën Çështje Komunale.
- Pjesëmarrja në punëtorin e organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) dhe Swisscontact-PPSE, rreth fuqizimit të kapaciteteve institucionale të komunave të Kosovës në funksion të zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm në vend.
- Pjesëmarrja në tryezën e diskutimeve ‘Lokalizimi i OZhQ-ve në institucionet e nivelit lokal’ e organizuar nga INDEP që po zbaton projektin “SDG Bridge – Ura lidhëse mes institucioneve të nivelit lokal dhe qendror për zhvillim të qëndrueshëm në Kosovë” i mbështetur nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ) nëpërmjet Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ).
- Pjesëmarrja në punëtorinë e organizuar nga Departamenti i Investimeve në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për investimet kapitale në komunat e Kosovës.
- Pjesëmarrja në punëtorin e organizuar nga Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ) me temën “Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030”.
- Pjesëmarrja në punëtorin e organizuar nga Agjencia për Barazi Gjinore/ZKM në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike dhe në koordinim me Zyrtaren për Barazi Gjinore në Komunën e Drenasit ju ftojnë të merrni pjesë në trajnimin me temë “Parandalimi dhe trajtimi i rasteve të ngacmimit seksual në vendin e punës”.
- Pjesëmarrja në tryezën e organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) dhe Swisscontact-PPSE, ku u diskutua rreth fuqizimit të kapaciteteve institucionale të komunave të Kosovës në funksion të zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm në vend.

- Pjesëmarrja ne takimin e organizuar nga Instituti për Politika Zhvillimore i mbështetur nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ) nëpërmjet Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), për projektit 'SDG Bridge - Ura e koordinimit në mes të nivelit lokal dhe qendror për zhvillim të qëndrueshëm në Kosovë'
- Pjesëmarrja në punëtorinë e organizuar nga Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ) me temën “Bashkëpunimi Ndërkomunal”
- Pjesëmarrja në sesion informimi për thirrjen për propozim Town-Twinning e shpallur nga programi i BE: Citizens, Equality, Rights and Value (CERV) në Projektin e Asistencës Teknike “Mbështetje Kosovës me programet Evropiane”,
- Pjesëmarrja në takimin Weglobal dhe Prishtina Rea për projektin ICT for Kosova Growth, si partnere me Bashkimin Evropian –Zyra në Kosovë në partneritet me Ministrinë e Ekonomisë
- Pjesëmarrja në punëtorinë një ditore me temën: “Rëndësia e Parandalimit të Konfliktit të Interesit, Roli i Autoriteteve Përgjegjëse sipas Legjislacionit, Praktikrat më të mira rajonale dhe ndërkombëtare”.
- Pjesëmarrja në trajnimin “Hartimi dhe përditësimi i Strategjive Komunale të Turizmit organizuar nga Qendra e Trajnimit të Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) dhe Swisscontact-PPSE.
- Pjesëmarrja në punëtorinë “Planifikim strategjik për krijimin e një ambienti më të favorshëm për zhvillimin e ndërmarrësisë” organizuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal në bashkëpunim me Cactus.
- Pjesëmarrja në punëtorinë dy ditore për Raportimin e Planit te Integritetit si dhe hartimin e Listës së Rreziqeve
- Mbajtja e dy sesioneve- tryezë se rrumbullakët "AVANCIMI I NJOHURIVE FINANCIARE" organizuar nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik në bashkëpunim me Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK), në, trajnimi ishte me fokus të veçant në përgatitjen e bizneseve:
- Pjesëmarrja në punëtorinë - Prezantimi dhe validimi i draft-analizës së investimeve kapitale të realizuara sipas rajoneve zhvillimore të Kosovës për vitin 2022, organizuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe në partneritet me UN-Habitat Kosovë.
- Pjesëmarrja ne takimin e organizuar nga MINT/Departamenti i Turizmit me qëllim të informimit dhe koordinimit rreth aktiviteteve në fushën e turizmit.
- Pjesëmarrja ne takim përmbyllës për Projektin “Fuqizimi Social dhe Ekonomik për Gratë e Margjinalizuara në Kosovë organizuar nga Women 4 Women.

- U realizuan takime me përfaqësuesit institucioneve të nivelit qendror, organizatave vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të arritjen se marrëveshjes/bashkëpunimit për të gjetur mundësin e përkrahjes/financimit e projekteve zhvillimore, të cilat do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik të komunës së Drenasit dhe sektorit privat/ bizneseve të cilat operojnë në territorin e komunës së Drenasit;
- Takim me përfaqësuesit e WOMEN 4 WOMEN, mundësia e bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve të tyre me Komunën e Drenasit për përkrahjen e grave në bujqësi dhe hortikulturë.
- Takim pune me Komandantin e ri të Ekipit Monitorues-Ndërlidhës LMT K9 te Kfor-it slloven z. Natasa Petlikar dhe koleget e tij ku u diskutua për gjendjen aktuale të zhvillimit ekonomik.
- Takim me përfaqësuesit e Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK) në lidhje me organizimin e trajnimeve falas për gratë sipërmarrëse.
- Arritja e marrëveshjeve/bashkëpunimeve të cilat do të ndikojnë në përmirësimin dhe ngritjen e kapaciteteve të NMV
 - ✓ Marrëveshje bashkëpunimi me AZHER-Qendër
 - ✓ Bashkëpunimi me MINT dhe dërgimi i dokumenteve sipas kërkesës për Zonën Ekonomike II kopja e planit dhe koordinatat në formë elektronike dhe fizike.
- Projektet e realizuara dha ata në implementim :
- Hartimi i profilit Ekonomik.
- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në kuadër te marrëveshjes se bashkëpunimit me “Women 4 Women”, në projektin “Mundësitë e përmirësuara të vetë-punësimit dhe punësimit” I SEE që financohet nga Agjencinë Austriak për Zhvillim (ADA) me fondet e Korporatës Austriake për Zhvillim (ADC).
- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ne kuadër te marrëveshjes se bashkëpunimit me Agjencinë për Zhvillim Rajonal Qendër (AZHRQ) ka lansuar skema e garantëve “Përkrahja dhe fuqizimi i grave në agrikulturë”,
- Bashkëpunimi me MZHR rreth Analizës së investimeve kapitale si dhe Raportin e Ndarjeve Buxhetore dhe Shpenzimeve të Investimeve Kapitale Komunale për vitin 2022.
- Plotësimi/dërgimi i formularit në MAPL për Raportin e Planit të Veprimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2023 për Komunën e Drenasit për vitin 2022.

- Informimi me kohë në platformën online dhe informim në zyre të drejtorisë lidhur me gjetjen dhe mundësin e aplikimit në grande, projekte dhe subvencione adresuar: sektor privatë/bizneseve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit si;
 - Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, ka njoftua të gjitha subjektet banesore (barnatoret), se DZHE ka hartuar orarin për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës për ditët e punës, të dielave dhe festave zyrtare, për subjektet afariste që janë furnizues të përditshëm për qytetarët me barëra.
 - Thirrja për grante Kosova WOMEN FOR WOMEN
 - Thirrja publike për sesionin informues lidhur me skemën e grantëve – Programi për Zhvillim Rajonal i Balancuar – 2023, Startup dhe Biznese ekzistuese (LOTO 1 DHE LOTO 2
 - Thirrja publike për subvencionim të NMWM-we për blerjen e makinave prodhuese-përpunuese
 - Thirrja publike për përkrahjen financiare të ndërmarrjeve për certifikim të produkteve (MINT KIESA).
 - Thirrje publike për ndarjen e subvencioneve nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik (DZHE) në kuadër të programit "Participimi tek Ndërmarrjet mikro (0-9 punëtor) dhe Start Up, prioritet më shumë zeje tradicionale , bizneseve inovative dhe start up, ideve në fushën e turizmit, ideve që ofrojnë me shumë punësim.

Zhvillimi dhe promovimi i turizmit;

- Me qëllim të mundësisë për promovim dhe zhvillim të turizmit të komunës së Drenasit është duke u bërë identifikimi i monumenteve historike në bashkëpunim me Drejtorin e Kulturës.
- Përzgjedhja e atraksioneve turistike ne bashkëpunim me DRKS - atraksion turistik është një vend për të cilin interesohen turistët, zakonisht për vlerën natyrore ose kulturore, rëndësinë historike, bukurinë natyrore ose të ndërtuar, duke ofruar kohë të lirë dhe zbavitje.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Raport i punës, Janar – Dhjetor 2023

Drejtoria për Buxhet dhe Financa, gjatë periodës janar- Dhjetor /2023, punët dhe detyrat e punës i ka kryer duke u bazuar në Plan-programin e punës, të mbështetur në Ligjin për Menaxhimin e Financave publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L-048, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal nr. 03 / L-049, Ligjin për vetëqeverisjen Lokale nr. 03 / L-040, rregulloret, vendimet, udhëzimet e MEF-it dhe Kuvendit të Komunës, si dhe në bazë të detyrave dhe obligimeve të përcaktuara me Statutin e Komunës së Drenasit.

- Komuna e Drenasit ka filluar vitin 2023 me buxhet të aprovuar në shumë prej: 18, 156, 892.00 € ndërsa vitin e kemi përfunduar me buxhet prej: 24, 001, 709.77 € ku rritje

kemi pas në kategorinë e Pagave shumë prej: 1, 871, 686.14 €, ndërsa rritja më e madhe ka qenë në Investime Kapitale dhe atë për shumë prej: 3, 512, 555.03 €.

Nr.	Deklarimet e bizneseve gjatë vitit 2023	Shuma	Përqindja
1.	Deklarimet e bizneseve për muajin Janar	9,680.00	8.8%
2.	Deklarimet e bizneseve për muajin Shkurt	12,290.00	11.25%
3.	Deklarimet e bizneseve për muajin Mars	30,580.00	28.17%
4.	Deklarimet e bizneseve për muajin Prill	5,000.00	4.5%
5.	Deklarimet e bizneseve për muajin Maj	7,050.00	9.28%
6.	Deklarimet e bizneseve për muajin Qershor	11,450.00	6.45%
7.	Deklarimet e bizneseve për muajin Korrik	450.00	0.49%
8.	Deklarimet e bizneseve për muajin Gusht	10,850.00	9.97%
9.	Deklarimet e bizneseve për muajin Shtator	16,740.00	16.33%
10.	Deklarimet e bizneseve për muajin Tetor	1,860.00	1.70%
11.	Deklarimet e bizneseve për muajin Nëntor	3,100.00	2.86%
12.	Deklarimet e bizneseve për muajin Dhjetor	200.00	0.20%
	Totali i pagesave për vitin 2023	109,150	100

Ky Drejtorat, punën e vetë kryesisht e ka orientuar në këto lëmi:

- raporti i punës dhe financiar për vitin 2023,
- Pasqyrat Vjetore Financiare 2023,
- Procesi buxhetor-Strategjia Fiskale 2024-2026, sipas kërkesave fillestare,
- Aprovimi i shpenzimeve dhe certifikimi për buxhetin komunal sipas programeve,
- Kryerja e pagesave lidhur me shpenzimet operative dhe kapitale, si dhe barazimi me raportet e SIMFK ,
- Punët lidhur me arkën e parave të gatshme (arkëtimi dhe pagesat),
- Regjistrimi në sistemin kompjuterik i të gjitha të hyrave të arkëtuara nga burimet vetanake dhe barazimi ditor, javor, mujor dhe periodik me SIMFK,
- Autorizimi i shpenzimeve për D.B.F
- Përcjellja e të hyrave publike të akorduara nga B.K.K,
- Përgatitja e transfereve të parave të depozituara në llogaritë e thesarit të MEF-it,
- Caktimi i tatimit në pronë- shpërndarja e faturave për vitin 2024,
- Evidentimi i objekteve të reja si pasuri e palujtshme dhe rimatja e objekteve ,
- Përgatitja e analizave mujore lidhur me zhvillimin e buxhetit komunal,
- Raporti i punës dhe financiar sipas periodave të vitit /2023,
- Propozim Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026,
- Shlyerja e pagesave për tatimin në pronë,

- Plotësimi i formularëve për buxhetin 2024-2026, sipas kërkesave fillestare,
- Trajnimin e punëtorëve të D.B.F,
- Punë dhe detyra tjera të punës për pushtetin lokal dhe qendror,
- Punët me palë në lëmin e buxhetit dhe financave.

Struktura e përgjithshme organizative për funksionet e Drejtoratit për Buxhet dhe Financa, është e bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin për Vetëqeverisjen lokale, Statutin e Komunës, sipas Sektorit të Buxhetit, Thesarit dhe Financave.

Sektori i Buxhetit

Për periodën janar- dhjetor/2023, ka kryer këto punë dhe detyra pune:

- Zhvillimi i aktivitetit lidhur me planifikimin e buxhetit komunal 2024-2026, sipas kërkesave fillestare,
 - Përgatitja e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024-2026
 - Vërtetime për qytetarët lidhur me rregullimin e dokumentacionit,
 - Numri i kërkesave të regjistruara dhe koduara për shpenzime nga shfrytëzuesit e buxhetit komunal 4, 379 ,
 - Lëshuarja e faturave 11, 172,
 - Ruajtja e databazës për të dhënat e regjistruara,
 - Objektet e reja të matura – rimatura 2, 240 ,
 - Fatura të shpërndara përmes poste 10, 690 ,
 - Numri i ankesave të pranuar 55 ,
 - Pranimi i kërkesave për regjistrimin e objekteve të reja 86,
- 1. Sektori i Thesarit.-** Në këtë sektor, punët dhe detyrat e punës për periodën janar-dhjetor /2023, janë kryer si vijon:
- Është bërë arkëtimin e parave të imta për shërbime në ofiqari, arkiv, Gjeodezi, Urbanizëm, shërbimet e pagesës se tatimit në pronë, dhe për shpallje të tenderëve - shërbime për arkëtim të parave të imta. Përveç arkëtimit, është bërë përgatitja dhe depozitimi ditor i parave në llogarinë bankare të Komunës.
 - Regjistrimi i të hyrave vetanake të arkëtuara është bërë për çdo ditë në databaze dhe në sistemin e Free- balancit,
 - Transferi i të hyrave vetanake nga llogaria bankare komunale në llogari të thesarit MEF për çdo fund muaji ,
 - Barazimi i raporteve të arkës me raportet e bankës dhe kontrollimi i tyre për çdo ditë,
 - Hartimi i raporteve mujore për të hyrat vetanake për nevoja të ekzekutivit dhe MEF-së,
 - Zotimi i parave publike për qëllime të pagimit të shpenzimeve operative dhe kapitale, sipas modulit të blerjes, dhe sipas modulit të aprovimit,
 - Kryerja e pagesave nga buxheti i Sektorit të Përgjithshëm (drejtoratet dhe zyrat komunale) për të gjitha lëndët që kanë qenë të kompletuara. Vlen të cekët se 100% e lëndëve të pranuar në zyrën e pagesave janë procesuar për pagesë,
 - Certifikimi UOP për të gjitha kategoritë: 4,379,
 - Certifikimi i UOP për Komunal 1,521,
 - Aprovimi i avanseve për para të imta 4,

- Certifikimi i UOP për mallra dhe shërbime 2,245,
- Certifikimi i UOP për Subvencione 202,
- Certifikimi i UOP për Investime Kapitale 243,
- Certifikimi i UOP për Shpronësime 13
- Dorëzimi i UOP në arkiv 4,379,
- Certifikimi me listë elektronike 151.
- përgatitja e analizave mujore lidhur me zhvillimin e buxhetit komunal sipas sektorëve kryesor dhe programeve.

Sektori i Financave

Në periodën janar- dhjetor /2023, përmes Sektorit të Financave janë kryer këto punë dhe detyra pune:

- Përgatitja e pasqyrave financiare për vitin /2022,
- certifikimi i dokumentacionit financiar për buxhetin komunal sipas programeve – drejtorateve dhe zyrave komunale me modulën e blerjes,
- certifikimi i lëndëve për pagesë sipas modulit të aprovimit ,
- përgatitja e regjistrit të faturave të paguara për dosjet e dokumentacionit financiar, për 6 muajt e vitit.
- Është mbajtur evidencë analitike për të gjitha lëndët e certifikuara sipas shpenzimeve veç e veç, 4,379
- Raporti i punës-financiar për periodën Janar-Mars /2023
- Raporti i punës-financiar i periodës janar-qershor/ 2023,
- Raporti i punës dhe financiar Janar – Shtator /2023,
- Raporti financiar Janar – Dhjetor 2023.
- Plani i punës për vitin 2024.

Zyra e Tatimit në Pronë

- Raste të reja 473,
- Verifikime të objekteve në terreni janë 2402, (20% është arritur)
- Modifikime të dhënave të pronës janë 19258,
- Modifikime të dhënave të tatimpaguesve janë 13274,
- Raste të dërguara në përmbarrim janë 224,
- Njoftime përfundimtare të dërguara janë 320,
- Vendime për ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara janë 152
- Vendime për ankesat/kërkesat për korrigjim janë 1262
- Vendime për ankesa ndaj certifikatës se vlerës së vlerësuar janë 27
- Ndërrime të pronarëve janë 129,
- Regjistrim manual i pagesa të dështuara janë 115,
- Korrigjimet manuale të dhënave financiare janë 1991,

- Krijime të relacioneve janë 547,
- Të dhënat e relacioneve të modifikuara janë 243,
- Lëndët e miratuara në intranet ZTPR- janë 1813
- Marrëveshje për pagesë me këste janë 83,
- Lëshimi i certifikatave për jo tatimpagues janë 865,
- Certifikata të lëshuara për pagesë janë 5, 124,
- Fshirje të relacioneve janë 270.

Nga Drejtorati për Buxhet dhe Financa, për periodën raportuese (janar-dhjetor /2023), janë kryer edhe shumë punë dhe detyra tjera të punës që nuk janë evidentuar më lartë e të cilat kanë ndihmuar punën e Bordit të Drejtorëve, Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendin e Komunës.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Raport pune për vitin 2023

Arritjet/progresi/përformanca kyçe për vitin 2023

Aktivitetet kryesore për vitin 2023

Bazuar në Ligjin e Shëndetësisë së Kosovës si dhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale i cili ka inkorporuar në tërësi konceptin e Mjekësisë Familjare duke e definuar atë si “formë themelore e ofrimit të shërbimeve shëndetësore gjithëpërfshirëse në nivelin parësor të kujdesit shëndetësor, për individët dhe familjet e tyre”, KPSH në Komunën e Drenasit shërbimet shëndetësore i ofrohen në bazë të konceptit të Mjekësisë Familjare bazuar në legjislacionin në fuqi.

Infrastruktura dhe objekteve ka një trend të përmirësimit përjashtimisht objekti i QKMF ne Drenas që konsiston me një kosto të latë të mirëmbajtjes arsye të amortizimit të rrjetit të ujtë, rrjetit të rrymes, instalimit të nxemjes qendrore dhe gupave përcjellës të ujrave tës zeza si dhe problemet me ujra atmosferik amortizim I qatisë dhe gypave përcjellës. Përkunder amortizimit të objektit në realizimin e impaktit të shërbimeve ne këtë gjashtë mujor ka ndikuar edhe gravitimi I kerkuesëve të shërbimeve shëndetësore, fluksi I madh I pacientëve përkunder rrjetit institucional që ka shkuar në trend të funksionalizimit.

Duke u nisur nga ky fakt kapaciteti ofrimit të shërbimeve shëndetësore është në disproporcion me fluksin e pacientëve të orientuar ne QKMF Drenas dhe QMF Komoran e që për arsye të qasjes më të favorshme dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe pozita e saj ka ndikuar që QMF në Komoran është e gravituar në masë të konsiderueshme edhe nga pacientët e komunave tjera e veçanërisht nga banorët e Komunës së Lipjanit. Ky disproporcion ulë pritshmërinë e lartë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe kënaqëshmerinë e pacientëve

	<p>në ofrimin e këtyre shërbimeve. Ndikim në realizimin e objektivave indirekt ka ndikuar edhe mosha mesatare e personelit shëndetësor dhe mungesa e mjekëve specialist nga lëmi i Mjekësisë familjare.</p> <p>Një studim i organizuar nga Agjencioni për Bashkëpunim Zviceran dhe e implementuar nga Projekti i AQH ka treguar se ofrimi i shërbimeve me theks në Sëmundjet Kronike Masovike Jo Ngjitëse por dhe në fushat tjera ka treguar se nevojitet përmirësim dhe vetëdijësim, si nga ana e personelit shëndetësor ashtu edhe të komunitetit në mënyrë që të parandalohen dhe trajtohen këto patologji duke siguruar një efikasitet më të mirë të shërbimeve, parandalimin e sëmundshmërisë si dhe përmirësimin e kualitetit të jetës. Me qëllim të përmirësimit dhe vetëdijësimit të komunitetit për sëmundje jo ngjitëse kronike janë funksionalizuar këshillimoret në QMF Komoran dhe AMF Tërstenik. Në kontinuitet do të bëhet edhe trajnimi I personelit përmes AQH-së për këtë qëllim. Furnizimi me pajisje mjekësore dhe inventar I departamenteve dhe sektorëve pothuajse është kompletuar nga bugjeti I aprovuar nga DSHMS dhe donacioni nga MSH, UNICEF, AQH –ja, ky proces është në kontinuitet me përkrahje nga buxheti Komunal për shëndetësi e që në gjashtë nujorin e ardhshëm investimet e planifikuara do të plotësojnë standardin me pajisje për KPSH në bazë të U.A.04/2020.</p>
<p>Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në këtë viti ka punuar me dy punëtorë administrativ në dy sektorë organizativ</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sektori i Shëndetësisë 2. Sektori i Mirëqenies Sociale
<p>Pranimi dhe shqyrtimi dhe verifikimi i kërkesave</p>	<p>Gjatë vitit 2023 në adresë të DSHMS-së janë pranuar kërkesa dhe lëndë të natyrave të ndryshme:</p> <p>për miell për familje skamnore si dhe ndihmë emergjente (pako ushqimore dhe higjienike) përmes donacioneve të ndryshme</p> <p>janë shqyrtuar dhe verifikuar në teren të gjitha kërkesat për ndërtim dhe renovim të shtëpive</p> <p>Gjithashtu janë shqyrtuar kërkesat për banim dhe sipas kritereve janë poenizuar nga komisioni për çështje të banimit.</p> <p>Është përpunuar Plani për Programin 3 Vjeçar të Banimit dhe miratuara nga MAPL-ja</p> <p>Janë shqyrtuar 89 kërkesa për subvencionim shërim, rehabilitim mjekësorë, bazuar në të Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, shpallja publike për OJQ në të cilën është subvencionuar OJQ Handikos</p> <p>Po ashtu Sipas Thirrjes Publike për OJQ-të, ka përfituar OJQ Handikos Drenas</p>

	<p>është në process të implementimit të Marrëveshjes për Inicim të Projektit Emergjent për Masat e Eficiencës së Energjisë në Ndërtesat Shumë-Banesore Sociale në Pronësi të Komunave" mes Komunës së Glllogocit dhe FKKE-</p> <p>Janë verifikuar dhe mbikëqyrë institucionet shëndetësore të KPSH-së</p> <p>Janë plotësuar dokumentacionet dhe dërguar ne MSH për ndërtimin e objektit t% ri të QKMF-së</p> <p>Janë plotësuar dokumentacionet lidhur me ndërtimin e ri të objektit të ri për banim social në bashkëpunim me MMPH</p> <p>Janë vlerësuar oferta të ndryshme te shpallura nga zyra e prokurimet, projekte këto të KPSH.</p>																				
<p>Sektori i Mjekësisë Familjare</p>	<p>Organizimit dhe menaxhimit më efikas të resurseve në dispozicion përmes racionalizimit dhe distribuimit më adekuat.</p> <p>Ngritja e numrit të personelit shëndetësor me theks në ata me përgatitje superiore dhe në këtë mënyrë është arrit mbulimi më i mirë i Institucioneve shëndetësore përmes projektit të shërbimeve te blera nga OE Kosovamed realizohen vizitat dhe shërbimet e shëndetit paliativ.</p> <p>Ne këtë gjashtë mujor përmes DSHMS është realizuar rekrutimi i kuadrove dhe është arritur që të stabilizohet numri I profesionistëve shëndetësor mjekë në KPSH sipas U.A.04/2020, por mbetet sfidë plotësimi I kriterit me Mjekë specialist të mjekësisë familjare. Një trend I tillë është duke e përcjellë KPSH për arsye të mos interesimit për specializim nga kjo lami përkundër përkrahjes nga Institucioni dhe DSHMS.</p> <p>Me qellim të ofrimit të shërbimeve bazike shëndetësor në KPSH AMF janë pajisur me pajisje shëndetësore elementare nga buxheti vetanak dhe ne bazë të standardit për ofrimin e këtyre shërbimeve. Ky proces i plotësimit të standardit bazik është në trend të plotësimit me pajisje të avancuara mjekësore.</p> <p>Plotësimi i standardit me pajisje mjekësore në AMF-të sipas UA 04/2020 është në proces ku të gjitha AMF-të do të pajisen me pajisje mjekësore sikurse AMF Tërstenik AMF Arllat, AMF Gllanasellë, AMF Baicë.</p> <p>Ofrimi i kujdesit shëndetësor për pacientët me sëmundje kronike si dhe atyre me nevoja të veçanta e të cilët për shkak se nuk kanë pasur qasje</p>																				
<p>Paraqitja e lëndëve intranet për vitin 2023 DSHMS-së :</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përshkrimi</th> <th>Pra</th> <th>Në proces</th> <th>Miratar</th> <th>Refuzuar</th> <th>Hedhur Poshtë</th> <th>Pezulluar</th> <th>Anular</th> <th>Përfunduar</th> <th>Totali</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>DSHMS</td> <td>3</td> <td>30</td> <td>1103</td> <td>87</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>3</td> <td>0</td> <td>1226</td> </tr> </tbody> </table>	Përshkrimi	Pra	Në proces	Miratar	Refuzuar	Hedhur Poshtë	Pezulluar	Anular	Përfunduar	Totali	DSHMS	3	30	1103	87	0	0	3	0	1226
Përshkrimi	Pra	Në proces	Miratar	Refuzuar	Hedhur Poshtë	Pezulluar	Anular	Përfunduar	Totali												
DSHMS	3	30	1103	87	0	0	3	0	1226												




RAPORT I PUNËS SË KRYETARIT LLADROVCI DHE DREJTORIVE PËR VITIN 2023


Vizitat shend. paliativ	Vizita MF	Referime me QKUK	Vizita në Emergjencë	Shërbi me	Infuzione	injeksione	Inhali	EKG	Imazheri	Lab.Marrja e gjakut për analiza	Lab.Nr.i Parametrave të analizave	Plagë pastrim lidhje
QKMF Drenas	47768	7116	35960	129086	22189	40747	343	3295	7199	5720	90546	18046
QMF Komoran	42640	7457	19518	60911	12307	30724	864	1323	Pa apl.	4762	40372	6359
AMF Arllat	2057	285		2013	62	980	19	34	Pa apl.	28	28	741
AMF Nekoc	960	56		706	2	388	6	2	Pa apl.	8	8	244
AMF Sankoc	70			24		14	0	0	Pa apl.	0	0	3
AMF Terstenik.	2102	182		2185	86	818	6	0	Pa apl.	78	78	421
AMF Baicë	1766	114		2180	12	1273	5	0	Pa apl.	47	47	627
AMF Abri	0	0		0	0	0	0	0	Pa apl.	0	0	0
AMF Terdec	0	0		0	0	0	0	0	Pa apl.	0	0	
AMF Gllanasellë.	1600	64		1256		770	8	0	Pa apl.	35	35	627

RAPORT I PUNËS SË KRYETARIT LLADROVCI DHE DREJTORIVE PËR VITIN 2023

AMFGrad icë	4	0	0	0	0	0	0	0	Pa apl.	0	0	0
AMF Dobroshe c	542	47	278	0	132	0	0	0	Pa apl.	24	24	72
AMF Vasilevë	0	0	0	0	0	0	0	0	Pa apl.	0	0	0
SH.Paliati v	7696	0	12272	4173	5259	0	0			41	0	1478
Totali	99509	15321	55478	210911	38831	81105	1251	4654	7199	10743	131138	27991



Në diagram janë të paraqitura totali i vizitave në QKMF diagram -1, Totali I vizitave dhe shërbimeve në mjekësi familjare QKMF, QMF dhe AMF diagram -2, Vizitat dhe shërbimet në QMF diagram-3. Ne bazë të këtyre diagrameve vërehet se qasja në vizita shëndetësore, kërkuesit e vizitave shëndetësore janë të përqendur në QKMF Drenas dhe QMF Komoran. Një dispropocion I tillë është duke na përcjellë në vazhdimësi për shkak të pritshmërisë së lartë të pacientëve për shërbime shëndetësore ne këto dy qendra. Dy qendra për arsye të mungesës së personelit nuk kanë pasur qasje për pacient. Me rekrutimin e fundit të personelit shëndetësor mjekë dhe infermier këto qendra do të funksionalizohen. Si sfidë do të të na përcjell qasja e pacientëve në këto qendra deri në momentin e caktimit të listës së pacientëve për banorë në një mjek. Caktimi i listës së pacientëve për banorë do të implementohet në vitin 2024 sipas programit të MSH përmes platformës EKosova krahas regjistrimit të popullsisë në Republikën e Kosovës.



Në diagram janë të paraqitura diagnozat e sëmundjeve, ku vërehet ne rritje e patologjive dhe problemeve të sistemit osteomuskular. Në bazë të sajë duhet që të mbahen promovime dhe edukime shëndetësore në komunitet rreth aktiviteteve fizike, ushqyerjes së shëndetshme megjithëse edhe përdorimi terapisë nuk duhet të anashkalohe.

Sëmundjet e sistemit respirator kanë një baraspeshë të sëmundshmërisë ky parametër tregon për ndotje të ambientit nga agjentet e ndryshëm që qarkullojnë në ajër dhe shprehit e stilit të jetës konsumimi I duhanit te dy gjinitë

Sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut që si faktorë ka ndikuar stili I jetës dhe veset shoqërore, ushqyeshmëria dhe stresi. Prandaj paraqet një domosdoshmëri e promovimit dhe edukimit për shprehitë shoqërore, konsumimi i duhanit, alkoolit, ushqyeshmëria, aktivitetet fizike.

Vizitat në Shtëpi për gratë shtatzëna dhe fëmijë deri 3 vjeç

Numri i vizitave në shtëpi për fëmijët 0-3 vjeç	1434
Numri i vizitave në shtëpi për shtatzëna	70
Numri total i vizitave në shtëpi të kryera	1504
Nr. i fëmijëve vajza 0-3 vjeç të cilat janë vizituar për herë të parë	240
Nr. i fëmijëve djem 0-3 vjeç të cilët janë vizituar për herë të parë	228
Nr. total i fëmijëve 0-3 vjeç të cilët janë vizituar për herë të parë	468
Numri i vizitave të dyta për fëmijët 0-3 vjeç	396
Numri i vizitave të treta për fëmijët 0-3 vjeç	192
Numri i vizitave të katërta për fëmijët 0-3 vjeç	45
Numri i vizitave të pesta për fëmijët 0-3 vjeç	39
Nr. i fëmijëve të cilët kanë pranuar një vizitë shtëpiake brenda 3 ditëve të para pas lindjes	111
Numri i shtatzënave që janë vizituar për herë të parë	44
Numri i shtatzënave që kanë pranuar vizitën e dytë	25
Numri i fëmijëve 0-3 vjeç nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që janë vizituar për herë të parë	0
Numri i grave shtatzëna nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që janë vizituar për herë të parë	0
Numri i fëmijëve të referuar tek specialistët mjekësorë nga ekipi i mjekësisë familjare	66
Numri i vizitave shitesë për fëmijë dhe shtatzëna (Jashtë standardit të programit të vizitave në shtëpi)	248
Numri i baballarëve të përfshirë gjatë vizitave në shtëpi	186

Numri i rasteve sociale të identifikuara dhe të referuar	72
Numri i rasteve të dhunës të identifikuar (nga observimi gjatë vizitës në shtëpi)	0
Numri i fëmijëve të identifikuar me ngecje në zhvillim dhe të referuar (nga observimi gjatë vizitës në shtëpi)	5
Numri i infermierëve që janë angazhuar në zbatimin e vizitave në shtëpi	35

Programi I vizitave në shtëpi për gratë shtatzëna dhe fëmijët deri në moshën 3 vjeç nuk shënuar një trend të kënaqshëm ne bazë të objektivave të planifikuara. Për arritjen e performancës, pas rekrutimit të fundit të profesionistëve shëndetësor do të bëhet përpjekje që të arrihet objektivi i caktuar dhe është e nevojshme të bisedohet me stafin profesional për rëndësinë e këtij programi dhe implementimin domosdoshmërisht.

Spektori i Diagnostikës. Shërbimet Laboratorike

Gjatë kësaj periudhe shërbimet janë ofruar me personel të plotë në mënyrë që të arrihet qasja më e lehtë dhe cilësore e këtij shërbimi . Edhe pse kërkesat për analiza ka qenë të larta për arsye të qetësimin të situatës pandemisë, gjatë gjithë kohës qytetarëve u janë ofruar analizat të cilat janë në kuadër të KPSH. Pas një fluksi të shtuar të pacientëve ka rifilluar edhe caktimi i termineve e cila ka qenë variabël prej 1 deri në 2 ditë. Duhet theksuar se analizat emergjente janë kryer brenda ditës. Kryerja e analizave laboratorike është realizuar në kontinuitet gjatë gjithë kohës.

Në bashkëpunim me projektin e AQH-së është në përfundim zgjerimi I hapësirës së laboratorit në QKMF Drenas , ku me këtë investim është arritur që të krijohet një hapësirë e mjaftueshme dhe standard në kryerjen e analizave laboratorike. Ky investim përmes AQH-së dhe miratim të DSHMS do të lehtësojë punën e profesionistëve shëndetësor dhe një qasje të kënaqshme për pacient në kryerjen e shërbimeve laboratorike dhe plotësimin e standardit dhe qasjen e pacientëve .

Kërkesat jashtëzakonisht të mëdha për analiza laboratorike shpeshherë të panevojshme qoftë nga mjekët në KPSH dhe mjekët konsulent, por edhe nga klinikat dhe ordinancat private kanë qenë një nga sfidat edhe gjatë këtij gjashtë mujori. Kjo anomali është edhe si rezultat i pamundësisë së aplikimit të zonimit dhe hapjes së kartelave shëndetësore. Mirëmbajtja, kalibrimi dhe servisimi i pajisjeve nga OE I kontraktuar nga serviserët e autorizuar ka ndikuar që të realizohen shërbimet laboratorike. Është nënshkruar Kontrata kornizë në fund të tremujorit të parë për furnizim me

material shpenzues dhe reagensa laboratorik. Në fund të tre mujorit me qëllim të plotësimit të standardit bazik në kryerjen e analizave laboratorike sipas U.A. 04/2020 janë hartuar paramasat dhe specifikat për aparatura laboratorike që janë në procedurë të zyrës së prokurimit në realizimin e këtij projekti.

Kërkesat jashtëzakonisht të mëdha për analiza laboratorike shpeshherë të panevojshme qoftë nga mjekët në KPSH dhe mjeket konsulent, por edhe nga klinikat dhe ordinancat private kanë qenë një nga sfidat edhe gjatë këtij gjashtë mujori. Kjo anomali është edhe si rezultat i pamundësisë së aplikimit të zonimit dhe hapjes së kartelave shëndetësore. Mirëmbajtja, kalibrimi dhe servisimi i pajisjeve nga OE I kontraktuar nga serviserët e autorizuar ka ndikuar që të realizohen shërbimet laboratorike. Është nënshkruar Kontrata kornizë në fund të tremujorit të parë për furnizim me material shpenzues dhe reagensa laboratorik. Në fund të tre mujorit me qëllim të plotësimit të standardit bazik në kryerjen e analizave laboratorike sipas U.A. 04/2020 janë hartuar paramasat dhe specifikat për aparatura laboratorike që janë në procedurë të zyrës së prokurimit në realizimin e këtij projekti.

Shërbimet e imazherisë

Ky shërbim ka vazhduar në trendin e ofrimit të shërbimeve të imazherisë, mamografisë dhe ehosonografisë. Numri i shërbimeve të imazherisë është i kënaqshëm, por shërbimet e ehosonografisë pritja në termine është e gjatë me përjashtim të rasteve urgjente që kanë prioritet të menjëhershëm nga radiologu. Me qëllim të uljes së kohës së termineve në bashkëpunim me DSHMS dhe OMK jemi në hartim të planit në trajnimin e mjekut familjar në aplikimin e ultrasonografisë dhe pajisjen e katër qendrave të mjekësisë familjare me ultrasonografë që do të ndihmojë në fuqizimin e diagnozës nga mjeku familjar.

Jemi në procedurë të funksionalizimit të egzaminimit Rtg në QMF Komoran që shpresojmë që me miratimin e DSHMS-do të funksionalizohet në tremestrin e tretë të këtij viti. OE fitues I tenderit në këtë shërbim ka sjellë një Rentgen të teknologjisë së avancuar si donacion për QKMF-nënë Drenas. Rentgeni ekzistues analog digjital do të funksionalizohet në QMF Komoran ku është në procedure zhvendosja dhe funksionalizimi i RTG në QMF Komoran pasi që ekziston hapësira infrastrukurore për RTG.

Shërbimet Laboratorike dhe imazherisë janë në trendë të kënaqshëm dhe realizohen në bazë të U.A. 04/2020. Në diagram janë të përfshira aktivitetet në analizat laboratorike në QKMF, QMF, AMF dhe shërbimet e imazherisë

Mjekësia Familjare Shërbimet e vaksinimit sipas programit kombëtarë Vaksinimi i obliguar janar-qershor

në QKMF. Shërbimet laboratorike në bazë të U.A. realizohen edhe në AMF si analiza të domosdoshme bazike në ndihmesë të Mjekut familjar

Shërbimi i vaksinimit në kuadër të KPSH ndër vite ka treguar një përformancë shumë të mirë në përfshirjen e fëmijëve në kalendarin e rregullt të vaksinimit. Gjatë vitit 2023 janë realizuar aktivitetet e vaksinimit në bazë të programit kombëtar për vaksinim të obliguar. Ky aktivitet gjatë gjashtë muorit ne realizimin e planifikimit të vaksinimit të rregullt është I përformancës së planifikuar.

Me rekrutimin e profesionistëve shëndetësor në konkursin e fundit dhe funksionalizimit të ueb aplikacionit janë siguruar kushtet që zbatohen procedurat standard të vaksinimit të obligueshëm.

Formulari për Raportimin e Përfshirjes me Vaksinim

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dr. Hafir Shala” Drenas

Shërbimi i Vaksinimi

Qendra e Vaksinimit-QKMF-Drenas

Raporti mbi suksesin e Vaksinimit të Rregullt në Komunën e Drenasit

<i>Lloji I Vaksinave</i>	<i>Dozat e dhëna</i>	<i>z</i>	<i>Përqindja</i>
<i>BCG</i>	<i>142</i>	<i>142</i>	<i>100%</i>
<i>Hep B</i>	<i>142</i>	<i>142</i>	<i>100%</i>
<i>IPV1</i>	<i>560</i>	<i>814</i>	<i>68, 8%</i>
<i>IPV2</i>	<i>626</i>	<i>814</i>	<i>76, 90%</i>
<i>IPV3</i>	<i>658</i>	<i>814</i>	<i>80, 83%</i>

<i>DTP+Hep+Hip1</i>	560	814	68, 8%
<i>DTP+Hep+Hip2</i>	626	814	76, 8%
<i>DTP+Hep+Hip3</i>	658	814	80, 83%
<i>MMR</i>	765	807	94, 79%
<i>DTP-r1</i>	721	807	89, 34%
<i>OPV-r1</i>	721	807	89, 34%
<i>DT-pediatrik</i>	787	867	90, 77%
<i>OPV-r2</i>	787	867	90, 77%
<i>MMRr</i>	787	867	90, 77%
<i>dt-proadultis</i>	802	854	93, 91%
<i>OPV-r3</i>	802	854	93, 91%
<i>dt-proadultis kl.XII</i>	597	709	84, 20%
<i>dt-tek te lenduarit</i>	367	367	100%
<i>Serum Tetabulin 250 UI</i>	177	177	100%
<i>Hep B I</i>	190	X	
<i>Hep B II</i>	0	X	
<i>Hep B III</i>	0	X	
<i>DTap+Hib+IPV I</i>	142	X	
<i>DTap+Hib+IPV II</i>	28	X	
<i>DTap+Hib+IPV III</i>	0	X	
<i>Rotarix I</i>	142	X	
<i>Rotarix II</i>	28	X	
<i>PCV13 I</i>	144	X	
<i>PCV13 II</i>	30	X	
<i>PCV 13III</i>	0	X	
<i>Vaksiflu</i>	2024	2200	92%

<i>Hep B për te rritur</i>	61	61	100%
	<i>Totali:13, 370</i>	15.412	86, 75%
	<i>Totali I vaksinave te reja 704</i>		
	<i>Totali:13, 370+704=14, 074</i>		91, 32%

Detyrat e realizuara:

Prej datës 03.01.2023-29.12.2023 në shërbimin e vaksinimit janë kryer këto shërbime :

Janë administruar 14.081 doza të vaksinave të rregullta dhe vaksinave me indikacione, prej tyre:

- 11438 doza të vaksinave të rregullta
- 2024 doza të vaksinës kundër gripit sezonal
- 367 doza të dT vaksinës kundër helmimit me Tetanos të rastet me lëndime
- 177 doza Serum Tetabulin
- 61 doza të vaksinës kundër hepatitit B(rastet me indikacione)

Në bashkëpunim me DKA-në, kemi organizuar vaksinimin e nxënësve nëpër shkolla, duke vaksinuar gjithsej 2, 186 nxënës me vakcina të rregullta sipas kalendarit të vaksinimit.

- 787 nxënës të klasave të para
- 802 nxënës të klasave të gjashta dhe
- 597 nxënës të klasave të dymbëdhjeta

Prej fillimit të muajit Tetor deri në fund të muajit Dhjetor janë vaksinuar 2, 024 persona me vaksinën kundër gripit sezonal, vaksinimi kundër gripit sezonal është në proces dhe vazhdon deri në fund të muajit Maj.

Vaksinën kundër Covid19, gjatë vitit 2023 e kanë vetëm 7 persona, prej tyre

- 3 me dozën e I-rë
- 3 me dozën e II-të

- 0 me dozën e III-të
- 1 me dozën e IV-të

Shërbimi i Vaksinimit në KPSH të komunës së Drenasit vazhdon të kryhet në 4 qendra shëndetësore:

- QKMF-Drenas me 1 ekip të vaksinimit me 1 mjek dhe 3 infermiere
- QMF- Komoran 1 ekip me 1 mjek dhe 1 infermiere
- QMF- Arllat 1 ekip me 1 mjek dhe 1 infermiere
- QMF- Tërstenik 1 ekip me 1 mjek dhe 1 infermiere

Janë bërë përgatitje (trajnimi i infermiereve dhe sigurimi i frigoriferëve) që gjatë vitit 2024 t'i aktivizojmë edhe 3 qendra të vaksinimit në:

- QMF-Gllanasellë
- QMF-Baicë dhe
- QMF-Nekoc

Të arriturat në fushën e imunizimit gjatë vitit 2023:

Shërbimi i vaksinimit në komunën e Drenasit është pajisur me pajisje për zinxhirin e ftohtë:

7 Frigoriferë për ruajtjen e vaksinave në temperaturë +2 - +8, të teknologjisë së fundit, të cilët mund të monitorohen edhe nga distanca.

Në rast se ndodhë ndonjë ndërprerje e rrymës, sistemi i alarmit që është i montuar në frigorifer e alarmon në telefon infermierën përgjegjëse për zinxhirin e ftohtë dhe shefin e vaksinimit kudo që të ndodhën ata.

Në muajin Nëntor të vitit 2023, shërbimi i vaksinimit në Drenas, është pajisur me veturë që posedon frigorifer, e domosdoshme për t'i kryer nevojat në procesin e imunizimit:

-Bartjen e vaksinave nga IKSHPK.

-Shpërndarjen e vaksinave nëpër qendrat e vaksinimit brenda komunës së Drenasit.

- Realizimin e vaksinimit në teren.

Ndërsa njësia e SISH është ballafaquar më disa vështirësi me theks në funksionimin e sistemit, kryesisht për shkak të problemeve me operatorët e rrjetit të komunikacionit elektronik por edhe mungesës së personit për IT që

ende nuk është I paraparë në statut edhe pse janë parashtruar kërkesat MSH gjatë takimeve por ende nuk kemi ndonjë përgjigje apo aprovim. Me kontraktimin e operatorit nga MSH sistemi SISH ka filluar të funksionalizohet edhe në AMF.

Futja e të dhënave nuk është në nivel të dëshirueshëm qoftë për shkaqe objektive por edhe atyre subjektive gjë që po shkakton probleme në përgatitje e raporteve dhe tabelave numerike periodike. Për arsye të mos funksionalizimit të ueb aplikacionit në të gjitha njësit e Qendrave familjare një pjesë e profesionistëve shëndetësor hezitojnë të përdorin SISH ku jemi në shqyrtim të ndërmarrjes së masave në bazë të rekomandimeve të Inspektoratit shëndetësor dhe MSH. Vështirësi në aplikimin e ueb aplikacionit është edhe gravitimi i numrit të madh të pacientëve në QKMF Drenas dhe QMF Komoran.

Njësia e SISH

Si njësi e urgjencës në nivel regional me kapacitetet e disponueshme ka arritur që të realizojë objektivat në qasjen e shërbimeve urgjente. Ky sektor është në trend të riorganizimit deri sa të zbatohet sistemi i integruar i emergjencave në nivel Kombëtarë.

Spektori i Urgjencës i Si njësi e KPSH ka vështirësitë e organizimit dhe kostos së lartë operimit për arsye të kapaciteteve të plota në ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe mbrojtjen e avancuar të jetës(MAJ).

Në këtë sektor është e domosdoshme të intervenohet në trajnimin e personelit në MAJ duke marrë parasysh rritjen e numrit të aksidenteve, traumave dhe veprimin e shpejtë dhe profesional në trajtimin e rasteve urgjente dhe Emergjente. Ky sektor ka kryer edhe të gjitha aktivitetet dhe detyrat e rregullta në menaxhimin e rasteve urgjente si dhe rasteve tjera të cilat kanë kërkuar ndihmë në këtë sektor.

Spektori është i pajisur me aparaturë dhe ka pas furnizim kontinuel me medikamente, material shpenzues, mjete për mbrojtje personale si dhe dezinfektues. Vështirësitë të cilën e kanë përcjellë këtë sektor është, fluksi i shtuar i rasteve jo emergjente, futja jo e mjaftueshme në databazë e të dhënave në SISH.

Në fillim të tre mujorit të parë vështirësi ka pasur me numrin e Autoambulancave për arsye të skadimit të kontratës të operatorit ekonomik të kontraktuar meqë autoambulancat kërkojnë një mirëmbajte të vazhdueshme për shkak të amortizimit tyre. Në tremestrin e dytë është blerë

një autoambulancë e re nga buxheti I DSHMS për shëndetësi dhe është Kontraktuar OE I mirëmbajtjes së tyre dhe situata është përmirësuar.

Furnizimin nga ana e MSH për gjatë vitit 2023 në bazë të kërkesave tona mujore sipas Listës Esenciale, ka qenë i realizuar në një mesatare rreth 40%.

Mungesat janë relative nga muaji në muaj, varësisht prej furnizimit që kemi nga ana e MSH, shumë nga barnat esenciale kronike janë prezent në stok të Barnatores me përjashtime të vogla kur harxhohet sasia pasi që është fluks i madh i pacientëve në këta muajt e fundit.

Barnatorja
Qendrore

Po gjatë këtij vitit jemi furnizuar me 100% të kërkesave mujore për Insulina dhe Vaksina.

Përveç furnizimit nga MSh përmes operatorit ekonomik të kontraktuar (MADEKOS)“ jemi furnizuar me medikamenteve të cilat nuk janë ofruar nga DF/Msh. Hapësira e vogël dhe jo e përshtatshme për farmaci ku kryhet dhënia e barnave dhe insulinës për pacientë si dhe hapësira e depos qendrore ku ruhen medikamentet janë një nga vështirësitë më të cilat ballafaqohen ne këtë sektor.

Një pjesë e konsiderueshme e buxhetit nga lista esenciale shpenzohet për sigurimin e insulinave për pacientët insulinvarës.

Realizimi në % nga MeSH	Barna	Material shpenzues mjekësor
Për vitin 2023		
Janar	22.75%	86.95%
Shkurt	14.48%	60.86%

Mars	31.72%	65.21%
Prill	24.82%	69.56%
Maj	27.58%	77.27%
Qershor	26.90%	65.22%
Korrik	28.08%	56.52%
Gusht	22.90%	60.87%
Shtator	21.62%	60.87%
Tetor	30.26%	56.52%
Nëntor	34.22%	61.90%
Dhjetor	37.24%	39.13%

SEKTORI I SHËNDETIT ORAL

I Shërbimet e shëndetit Oral përveç në objektin e QKMF-së nuk ofrohen në njësit tjera të KPSH, me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më afër popullatës dhe plotësimit të standardit në bazë të U.A. 04/2020. një mjekë stomatolog në 5000 banorë DShMS është në proces të plotësimit të këtij standardi me rekrutimin e tre stomatologëve dhe tre asistent të stomatologut dhe hapjes së tenderit për furnizim me tri karrige stomatologjike. Edhe ky sektor është i pajisur me pajisje stomatologjike dhe material për punë në nivel të kënaqshëm gjatë këtij gjashtë mujori. Mbetet që me një menaxhim më adekuat nga ana e përgjegjëseve të eliminohen dhe përmirësohen dobësitë subjektive dhe qasje më e mirë ndaj aktiviteteve punuese gjë që duhet dëshmuar me rezultate konkrete.

MATERNITETI DHE VIZITAT E KONSULENTËVE NË KPSH

Materniteti si Departament në KPSH gjatë kësaj periudhe ka punuar sipas trendit të ofrimit të shërbimeve profesionale të lindjeve dhe kujdesin postnatal të foshnjave të porsalindura nga mjekët pediatër. Numri I lindjeve në maternitet ka një trend të shprehur të rënies së tyre, ku gjatë kësaj periudhe janë kryer 3 lindje.

Kujdesi ndaj shëndetit të gruas është realizuar në kuadër të vizitave të mjekut konsulent (gjinologut) me referim nga mjeku familjarë.

Vizitat e mjekut konsulent pediatër janë realizuar në bazë të udhëzimeve nga mjeku familjar në kujdesin parësorë shëndetësor.

Vizitat e mjekut konsulent Dermatologu ne bazë të referimeve nga mjeku familjarë janë të pasqyruara në diagramet e më sipërm të QKMF vizita dhe shërbime

KOMITETI I
SIGURIMIT TË
CILËSISË

Sigurimi i cilësisë" nënkupton mbajtjen e një cilësie të lartë të kujdesit shëndetësor duke matur vazhdimisht efektivitetin e njësive që e ofrojnë atë, përmes instrumenteve të ndryshme e të cilat ndihmojnë në vlerësimin e nivelit të cilësisë së shërbimeve të cilat ofrohen për qytetarët, detektohen mangësitë eventuale dhe hulumtohen e propozohen masat dhe rekomandimet e mundshme për përmirësimin e devijimeve dhe ngritjen e standardit apo standardeve të synuara të cilësisë. Rrjedhimisht "sigurimi i cilësisë" paraqet një metodë të vlefshme për evaluimin e kujdesit shëndetësor i cili ofrohet për pacientët. Komiteti për Sigurimin e Cilësisë së Shërbimeve Shëndetësore (KSCSHSH), gjatë periudhës gjashtë mujore ka realizuar një varg aktivitete të parapara me planin vjetor të punës për sigurimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore.

Qëllimi:

Sigurimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore përmes, hulumtimit, analizës, vlerësimit dhe përmirësimit të mangësive të konstatuara në procesin e punës.

Objektivat:

- Rritja e përgjegjësisë në punë dhe vetëdijesimi i stafit për nevojën e zhvillimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve të ofruara.
- Ruajtja e vazhdimësisë së implementimit të Auditimeve, Rishqyrtimeve Kolegjiale, monitorimeve dhe hulumtimit të kënaqshmërisë së pacientëve me shërbimet shëndetësore të cilat u ofrohen dhe hulumtimit të kënaqshmërisë së stafit me punën, kushtet e punës dhe motivimin për punë
- Zhvillimi i aktiviteteve për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore është bazuar në planin e punës, të hartuar dhe të dakorduar nga anëtarët e Komitetit për Sigurimin e Cilësisë së Shërbimeve Shëndetësore;
- Është përcaktuar orari për realizimin e aktiviteteve të parapara për t'u realizuar sipas planit të punës përgjatë tërë vitit;
- Aktivitetet janë zhvilluar nëpërmes grupeve punuese Menaxhmenti i QKMF ka përkrahur, krijuar mundësi dhe lehtësira për lirim nga aktivitetet e rregullta të punës për bartësit e aktiviteteve (anëtarët dhe kryesuesit

e grupeve punuese) për realizimin e aktiviteteve të parapara për t'u zhvilluar. Gjatë kësaj periudhe janë ndërmarrë një varg aktivitete me qëllim të vetëdijesimit të komunitetit për shëndetin faktorët e rrezikut dhe stilin e jetës

Ne këtë periudhë nga komiteti I cilësisë me qëllim të aplikimit të standardeve është në zbatim të rregulloreve të aprovuara.

Nga Këshilli drejtues pas diskutimit publik dhe njohjen me Draft rregullore e risistemimit, detyrave të punës dhe zonimit të hartuar nga komisioni përkatës është aprovuar rregullorja dhe në tremestrin e tretë ka filluar punën Komisioni emëruar me Vendim nga DSHMS në përcaktimin e kriterëve dhe zbatimit të risistemimit.

Në proces të përfundimit nga grupi punues është: Draft Plani i reagimit emergjent

Rregullore dhe
procedura
standard
aprovuara
të

- Rregulloren për menaxhimin e mbetjeve mjekësore.
- Rregullore për kontrollin e infeksionit .
- Shërbimi I kujdesit mjedisor –Standardet e Higjienës dhe Pastrimit. Rregullore e Dosjeve personale. Rregullore e menaxhimit të rrezikut. Rregullore për mirëmbajtjen e pajisjeve Mjekësore. Procedurat standarde të Mirëmbajtjes së Objektivit
Procedurat standarde të Dezinfectimit dhe sterilizimit. Dokument prezantues QKMF (MISSIONI , VIZIONI) Program orientues I Infermierëve të sapo punësuar Programi Orientimi I mjekëve të sapo punësuar. Dokument vlerësues i infermierëve për trajnim’
- Rregullore e përdorimit të Autoambulancave dhe veturave zyrtare
- Rregullorja e burimeve njerëzore dhe risistemimit

Në proces të përfundimit nga grupi punues është: Draft Plani i reagimit emergjent

AKTIVITETE
REALIZUARA
NË VITIN 2023

Bazuar ne strategjinë sektorin e shëndetësisë, Strategjinë e Infermierisë së Kosovës,

Ligjit për shëndetësi, bordi drejtues pranë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Drenas ne bashkëpunim me përfaqësuesit e Odes e Infermierëve të Kosovës, ka hartuar planin e aktiviteteve trajnuese për infermier/ve dhe profesionistë tjerë shëndetësor pranë QKMF-së në Drenas,

më qellim që të arrihen objektivat e zhvillimit profesional drejtë ngritjes së cilësisë dhe plotësimit të standardeve shëndetësore.

Trajnimet e mbajtura kanë për synim zhvillimin e aftësive të infermiereve në edukimin modern transferimin e mirë të njohurive dhe shkathtësive profesionale të mësuara përmes zbatimit të teorisë dhe praktikës.

Aktivitetet trajnuese të zhvilluara për infermier/e dhe profesionistët tjerë shëndetësor

- Edukim shëndetësor
- Komunikimi i punëtorit shëndetësor sa më i mirë me pacientin dhe anëtarët e tjerë të familjes
- Parandalimi i sëmundjeve
- Promovimin e shëndetit dhe kujdesit infermieror
- Menaxhimi i informacioneve të reja
- Vazhdimi i edukimit shëndetësor në komunitet
- Përmirësimi i relacionit infermier/e pacient (klient)

I tërë ky aktivitet është zhvilluar për të arritur ngritje profesionale, për të rritur vetëdijësimin në shërbimet infermiere në aspektin profesional. Dhe natyrisht përmes këtyre aktiviteteve trajnuese infermieret kanë fituar njohuri në përvojën praktike.

Të gjitha aktivitetet e planifikuara janë realizuar me sukses duke bashkëpunuar me OIK, koordinatorët profesional shëndetësor dhe profesionistët shëndetësor në QKMF

Komiteti i cilësisë me qellim të realizimit të objektivave si mbështetje ka AQH-në, përmes programit Kujdesi shëndetësor cilësor i qashtëm, MSH dhe OMK ka realizuar aktivitetet dhe

Ditës Ndërkombëtare të Gruas një Tryezë të rumbullakët në sallën e trajnimit në QKMF Lipjan pjesëmarrës:

Dr. Afërdita Podrimqaku edhe Zv. Kryeinfermierja Afërdita Krasniqi

Trajnimet nga AQH ku kanë marr pjesë 3 doktorë edhe 7 infermier

Këshillimi Motivues	Kujdesi ndaj të moshuarve	Bazat e Komunikimit dhe Këshillimit në KPSH	Këshillimi Motivues	Parandalimi i Infeksionit
6 dhe 7 Mars 2023	09 Mars 2023	10 Mars 2023	21 dhe 22 Mars 2023	24 Mars 2023

shënimin e ditëve
ndërkombëtare të
sëmundjeve dhe
menagjimit e
tyre, si dhe
pjesëmarren e
profesionistëve
shëndetësor në
trajtime për
KPSH.

Dita Ndërkombëtare e Tuberkulozit 24.03.2023 e mbajtur në Sheshin “Fehemi dhe Xhevë Lladrovci” nga punëtorët e QKMF “Dr. Hafir Shala” Drenas

Trajnimi për Dhunën në baza gjinore Mars-Prill

Trajnimin Ministria e Shëndetësisë, Divizioni i Kujdesit Parësor Shëndetësor dhe Divizioni i Shëndetit Mendor në bashkëpunim me projektin AQH “Menaxhimi i Burnout Sindromit” 28.03.2023 pjesëmarrës 1 doktor dhe 2 infermier

Trajnimin Ministria e Shëndetësisë, Divizioni i Kujdesit Parësor Shëndetësor dhe Divizioni i Shëndetit Mendor në bashkëpunim me projektin AQH “Menaxhimi i Burnout Sindromit” 28.03.2023 pjesëmarrës 1 doktor dhe 2 infermier

Trajnimet nga AQH ku kanë marr pjesë 3 doktorë edhe 11 infermier

Bazat e Komunikimit dhe Këshillimit KPSH	Këshillimi në Motivues	Kujdesi ndaj të moshuarve	Parandalimi dhe Kontrolli Infeksionit
07 Prill 2023	25/ 26 Prill 2023	27 Prill 2023	28 Prill 2023

Trajnimin Ministria e Shëndetësisë, Divizioni i Kujdesit Parësor Shëndetësor dhe Divizioni i Shëndetit Mendor në bashkëpunim me projektin AQH “Menaxhimi i Burnout Sindromit” 18.04.2023 pjesëmarrës 1 doktor dhe 2 infermier

Trajnimin Ministria e Shëndetësisë, Divizioni i Kujdesit Parësor Shëndetësor dhe Divizioni i Shëndetit Mendor në bashkëpunim me projektin AQH “Menaxhimi i Burnout Sindromit” 20.04.2023 pjesëmarrës 1 doktor dhe 2 infermier

Trajnimin Ministria e Shëndetësisë, Divizioni i Kujdesit Parësor Shëndetësor dhe Divizioni i Shëndetit Mendor në bashkëpunim me projektin AQH “Menaxhimi i Burnout Sindromit” 27.04.2023 pjesëmarrës 3 infermier

Trajnimit Planifikimi Familjar 25 - 27.04.2023 ne QZHMF nga AMC & UNFPA

Trajnimit "Programi Orientues mbi Shëndetin e Adoleshenteve" data 03 - 06.04.2023 I organizuar Divizionin e Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH) ne Ministrinë e Shëndetësisë pjesëmarrës 1 doktor edhe 1 infermier

Asociacioni i Mjekëve Familjar të Kosovës (AMFK), në koordinim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe me mbështetje të Projektit AQH organizon Kursin trajnues EKG në Kujdesin Parësor Shëndetësor”.

Trajnimi për Dhunën në baza gjinore Mars-Prill

Trajnimit Etika Profesionale dhe te drejtat e Pacienteve” dt: 02 Maj 2023 QZHMF

Trajnimin Ministria e Shëndetësisë, Divizioni i Kujdesit Parësor Shëndetësor dhe Divizioni i Shëndetit Mendor në bashkëpunim me projektin AQH “Menaxhimi i Burnout Sindromit” 03.05.2023 pjesëmarrës 1 doktor edhe 1 infermier

Trajnimin Ministria e Shëndetësisë, Divizioni i Kujdesit Parësor Shëndetësor dhe Divizioni i Shëndetit Mendor në bashkëpunim me projektin AQH “Menaxhimi i Burnout Sindromit” 04.05.2023 pjesëmarrës 2 infermier

Trajnimin Ministria e Shëndetësisë, Divizioni i Kujdesit Parësor Shëndetësor dhe Divizioni i Shëndetit Mendor në bashkëpunim me projektin AQH “Menaxhimi i Burnout Sindromit” 10.05.2023 pjesëmarrës 3 infermier

Trajnimin Ministria e Shëndetësisë, Divizioni i Kujdesit Parësor Shëndetësor dhe Divizioni i Shëndetit Mendor në bashkëpunim me projektin AQH “Menaxhimi i Burnout Sindromit” 16.05.2023 pjesëmarrës 2 infermier

Trajnimin Ministria e Shëndetësisë, Divizioni i Kujdesit Parësor Shëndetësor dhe Divizioni i Shëndetit Mendor në bashkëpunim me projektin AQH “Menaxhimi i Burnout Sindromit” 17.05.2023 pjesëmarrës 2 infermier

Trajnimin Ministria e Shëndetësisë, Divizioni i Kujdesit Parësor Shëndetësor dhe Divizioni i Shëndetit Mendor në bashkëpunim me projektin AQH “Menaxhimi i Burnout Sindromit” 23.05.2023 pjesëmarrës 2 infermier

Trajnim nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) një ditore në periudhën Maj - Korrik 2023 me punëtorët

shëndetësorë dhe bashkëpunëtorët në Kujdesin Parësor Shëndetësor për raportimin e Sëmundjeve kronike (masovike) jo ngjitëse.

Trajnim me datë 25.05.2023 "Parandalimin dhe menaxhimin e konflikteve me pacientë dhe kolegë", i cili zhvillohet në kuadër të Projektit AQH në QKMF Drenas.

LIGJËRATAT E MBAJTURA PËR EDUKIM TË VAZHDUESHË M PROFESIONAL NË QKMF I AKREDITUAR NGA OMK PËR QKMF DRENAS	Tema:	Ligjëruesi:	Data:
	1.Frakturat dhe menaxhimi i tyre	Dr.Dijon Musliu-Ortoped	27.01.2023
	2.Apendiciti akut	Dr.Fatbardha Tahiraj-Dr. e Mjekësisë	23.02.2023
	3.Artriti reumatoid	Dr.Besim Bytyqi-Reumatolog	30.03.2023
	4.Hipërtensioni gestacional	Dr.Rina Dobranja-Specializante në Gjinekologji	28.04.2023
	5.Insultet cerebrovaskulare	Dr.Fisnik Jashari -Neurolog	26.05.2023
	6.Dislipimite	Dr.Ibadete Bytyqi -Internist-Kardiolog	30.06.2023
	7. Tuberkulozi	Dr.Nurije Mehaj -Pulmolog	29.09.2023
	8.Çrregullimet psikike	Dr.Fahri Drevinja-neuropsikiater	27.10.2023
	9.Infeksionet e traktit të sipërm respirator	Dr.Etnik Bajraktari -specializant ORL	24.11.2023
	10.Insuficiencia renale	Dr.Fahredin Veselaj -urolog	29.12.2023

Koordinatorë për EVP Dr. Florije Hoxha e autorizuar

Aktivitetet trajnuese të

- *Edukim shëndetësor*
- *Komunikimi i punëtorëve shëndetësor sa më i mirë me pacientin dhe anëtarët e tjerë të familjes*
- *Parandalimi i sëmundjeve*
- *Promovimin e shëndetit dhe kujdesit infermieror*
- *Menaxhimi i informacioneve të reja*

planifikuara për
infermier/e dhe
profesionistet
tjerë shëndetësor
kanë te bëjnë me:

- *Vazhdimi i edukimit shëndetësor në komunitet*
- *Përmirësimi i relacionit infermier/e pacient (klient)*

--

Raporti financiar për vitin
fiskal 2023

Përshkrimi	Shuma e Alokuar	Aktuali	
BUXHETI	2, 720, 167.74	2, 574, 971.89	94.66
11 PAGA DHE SHTESA	1, 592, 722.74	1, 592, 722.74	
13 MALLRA DHE SHËRBIME	553, 445.00	511, 980.75	
14 SHPENZIME KOMUNALE	54, 000.00	45, 880.92	
30 PASURITË JOFINANCIARE	515, 000.00	424, 387.48	
38 REZERVAT	5, 000.00	0.00	
TE HYRAT VETANAKE	34, 000.00	32, 825.00	96.54
13 MALLRA DHE SHËRBIME	34, 000.00	32, 825.00	
TË HYRAT VETANAKE NGA VITI I KALUAR	6, 636.00	6, 626.70	99.86
13 MALLRA DHE SHËRBIME	6, 636.00	6, 626.70	
Totali I Përgjithshme	2, 760, 803.74	2, 614, 423.59	94.70

Evaluimi i Programit

Evaluimi i programit trajnues për zhvillimin e vazhdueshëm profesional infermieror për vitin 2023. Gjatë kësaj periudhe do të jemi korrekt në mbarëvajtjen e trajnimeve profesionale .

Aktivitetet trajnuese ju dedikohet të gjithë infermiereve, Teknik rëntgenit, mamive, laboratorit dhe asistent të stomatologjisë në QKMF – Drenas.

Aktiviteti trajnues ju mundësohet edhe atyre punëtorëve shëndetësor që punojnë punë vullnetare dhe atyre që nuk punojnë në QKMF – Drenas, janë pa punë po janë të interesuar të marrin pjesë në keto aktivitete

Evaluimi i programit trajnues do të realizohet pas përfundimit të aktiviteteve dhe në fund do të raportojmë me shkrim lidhur me ecurinë e trajnimit dhe i lëshojmë certifikata me pikë krediti.

<p>Aktivitetet në realizimin e projekteve kapitale</p>	<p>Për realizimin e projekteve kapitale janë kryer këto aktivitete kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Hartimi i deklaratave të nevojës për projektet e DSSMS-së, • Hartimi i kërkesave për zotim të mjeteve, • Hartimi i projekteve ideore për secilin projekt, • Hartimi i paramasave dhe paralogarive, • Caktimi i organeve për mbikëqyrjen e projekteve, • Faza e implementimit të projekteve, • Faza e pranimit teknik të projekteve. <p>Gjate këtij gjashtë mujori janë realizuar projektet një vjeçare dhe ato që janë me kontratë kornizë, të cilat po i paraqesim si me poshtë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rrethojat për QMF- dhe AMF <p>në kuadër të këtij projekti është bërë rregullimi i rrethojës në QMF Komoran</p> <ul style="list-style-type: none"> • Inventar QKMF, QMF dhe AMF • Projekti - Pjerrina në AMF Arllat, Gllanasellë, Nekoc dhe Abri • Projekti Instalimi i nxemjes në QMF dhe AMF Arllat, Nekoc, Dobroshec dhe Gradicë • Projekti Pajisje Speciale mjekësore mbi 1000 euro- karrige stomatologjike, usg, ekg, analizer hormonal dhe defebriator • Projekti vetura e ndihmës së shpejtë • Projekti Furnizim me material administrativ shëndetësor • Projekti: Dosje për personel, është nënshkruar kontrata
--	--

- Projekti: Furnizim me material shpenzues për analiza biokimike dhe hematologjike Reagensa është nënshkruar kontrata për tri vite
- Projekti: Furnizim me filma për RTG është nënshkruar kontratë për tri vite
- Projekti: Furnizim me material për stomatologji është nënshkruar kontrata për tri vite
- Projekti: Furnizim me kompjuter
- Projekti: Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve
- Projekti: Rregullimi i oborrit të QKMF dhe largimi i mbetjeve inerte, duke u implementuar.
- Projekti për shërbime DDD (Dezinf. Dezins. Daratiz është në procedura të prokurimit
- Projekti: Furnizim me Pelet
- Projekti: Furnizim me material higjienik
- Projekti: Mirëmbajtja dhe servisimi i kaldajave
- Projekti: Servisimi dhe mbushja e aparateve për zjarrfikës
- Projekti: Furnizimi dhe montimi i derës në hyrje të emergjencës në QKMF
- Projekti: Furnizimi me rrymë për pajisjen e rentgenit në QMF, Komoran
- Projekti: Furnizim me perde dhe çarçafë

Konkluzionet

Përvojat e fituara gjatë pandemisë janë në aplikim në raste tjera emergjente eventuale.

Është formuar grupi punues në përkufizimin dhe implementimin e Sistemit për Menaxhimin e Cilësisë

Qendra për Punë Sociale

Ka zbatuar standardet për punët profesionale të Shërbimeve sociale

Realizimi i detyrave programore është bërë në bazë të dispozitave ligjore në bashkëpunim permanent me Drejtorinë Komunale për SHMS, MPMS-DPSF, OSBE, Institucionet sociale, Shëndetësore, Edukativo-arsimore, OJQ-të dhe me subjektet tjera veprimtaria e të cilave është e lidhur me problematikën sociale.

Në vitin raportues u.d. i Shërbimeve Sociale është angazhuar në organizimin dhe ndarjen sa më të drejtë të punës sipas ZSHS përkatësisht lokalitetit që e mbulojnë, shtimi i disiplinës në punë dhe përgjegjësisë në realizimin me kohë

dhe cilësi të detyrave të përcaktuara dhe ndaj të gjithëve është bërë vlerësimi i rregullt adekuat i punës.

Menaxhimi dhe mbikëqyrja e tërësishme e punës Ekipit-Shërbimit:

Gjatë tërë kohës u.d. SHS është angazhuar në mbikëqyrjen e punës si dhe në dhënien e këshillave dhe udhëzimeve për punë të mëtejme e në disa raste të rënda edhe kyçje drejtpërdrejt në rast.

Angazhimi në punët administrative:

Përveç angazhimit në menaxhimin e rasteve të veçanta dhe të punës së tërësishme, është bërë angazhim i duhur në hartimin e vendimeve, aktvendimeve, raporteve, informatave, planeve javore, tremujore dhe vjetore, analizave, shkresave dhe akteve tjera drejtuar Drejtorisë komunale për Shëndetësi, MS. si dhe MPMS, Organeve komunale, Gjykatave dhe subjekteve tjera.

Puna me palë:

Përveç punës në menaxhimin të rasteve është punuar edhe në pranimin e palëve-nevojtarëve të shërbimeve sociale të cilëve u plotësohet form. 001 dhe udhëzohen për trajtim adekuat nga ZSHS.

Futja e klientëve dhe shërbimeve të ofruara në bazën e të dhënave pas trajtimit nga ZSHS, hartimit të planit të shërbimeve dhe fletës shoqëruese janë evidentuar në bazën e të dhënave dhe për çdo klient dhe shërbim të ofruar.

Punët e rënda te rrezikshme të fëmijëve

Nuk kemi raste të reja të paraqitura këtë vit.

Puna analitiko-hulumtuese:

USHS edhe gjatë këtij viti është angazhuar në sigurimin e të dhënave statistikore të klientëve sipas kategorive dhe shërbimeve nga të gjithë ZSHS dhe nga baza e të dhënave në bazë të të cilave vlerësohen, analizohen dhe krahasohen me trendet e rritjes apo uljes së numrit të përgjithshëm të të gjitha formave, masave dhe shërbimeve që ofrohen për të gjithë qytetaret në nevojë sociale.

Planifikimi dhe raportimi:

Planifikimi dhe raportimi janë realizuar me kohë dhe në mënyrë të kënaqshme.

Përgatitja, pjesëmarrja dhe udhëheqja e takimeve:

Përveç takimeve dhe informimeve reciproke të çdo ditshme, janë mbajtur mbledhja e ekipit profesional të ZSHS ku janë trajtuar dhe analizuar punët e përfunduara dhe në të njëjtën kohë janë përcaktuar kahet e aktivitetit dhe angazhimeve shtesë për periudhën vijuese sipas aktualiteteve si dhe pas çdo mbledhje të organizuar nga Divizioni i Shërbimeve Sociale janë njoftuar me konkluzionet dhe detyrat konkrete që dalin nga ato takime.

Komunikimi dhe bashkëpunimi:

Ka pasur bashkëpunim përmes kontakteve, bisedave, këshillimeve, udhëzimeve, trajnimeve dhe formave tjera të bashkëpunimit.

Përmes programit “Projekti i ndihmës Humanitare” nga UNDP-ja janë shpërndarë 293 kuponë për familjet në nevojë në vlerë prej 70 deri në 80 euro për një periudhë gjashtë mujore. 48 familje kanë përfituar nga 2-3 metra dru, 46 familje janë subvencionuar për pagesën e ujit në vlerën prej 80 eurove. Ndërsa, nga Organizata Humanitare Islamic Relief janë shpërndarë 235 pako ushqimore, 20 shporet për dru, 20 lavatriçe.

Ka pasur rritje të numrit të rasteve të dhunës në familje.

Përveç rasteve të bartura nga viti 2022, janë paraqitur edhe këto raste të reja sipas pasqyrës së mëposhtme:

Raporti statistikor për vitin 2023- i Shërbimeve sociale

Kategoria		Të bartura Nga 2022	Lëvizja e lëndëve (gjate vitit-2023)		Bartën në 2024
			Të reja	Të mbyllura	
1.	1.a-Fëmijët e braktisur	8	4	0	12
	1.b-Fëmijët jetim (pa dy prindër)	2	1	1	2
	1.c-Fëmijët e prindërve të penguar në kryerjen e kujdesit prindëror	6	0	1	5

	1.d-Fëmijë të strehuar në Familje Strehuese, apo SOS-fshatin	5	1	2	4	
2	Familje Strehuese	1	/	/	1	
3	Kërkesa për Adoptim vendor	/	1	/	1	
4	Kërkesa për Adoptim Ndërkombëtar	/	/	/	/	
5	Fëmijë të keqtrajtuar	16	7	5	18	
6	Fëmijët me sjellje asociale	22	24	12	34	
7	Të miturit në konflikt me ligjin	14	22	7	29	
8	Viktimat e dhunës familjare	43	22	23	42	
9	Viktimat e Trafikimit	/	1	/	1	
10	Viktimat e Krimeve seksuale	/	1	/	1	
11	Martesa e të miturve	/	/		/	
12	Punë të rënda(rrezikshme)te fëmijëve	/	/	/	/	
13	Kërkues të këshillimit martesor	9	17	2	24	
14	Të moshuarit	2	7	2	7	
15	Kl. Tjerë:	1.a-Nënat vetushqyese	8	1	1	8
		2.b-Persona me aftësi të kufizuar	14	7	3	18
		3.c-Përs. me aft. kufiz. me pagesë	74	11	7	78
		4.d-Dok. Administrative	/	573	573	/
		5.e-Arësye tjera	35	6	6	35
	<i>Gjithsej:</i>	260	704	645	319	

Numri i shfrytëzuesve të ndihmës sociale sipas muajve

Muaj

Nr. i Familjeve

Nr. i anëtarëve

Shuma në euro

Janar	994	4559	133.660.00
Shkurt	963	7271	130.910.00
Mars	894	3971	121.830.00
Prill	899	3973	122.680.00
Maj	894	3971	121.830.00
Qershor	873	3888	118.720.00
Korrik	868	3862	118.340.00
Gusht	847	3768	114.510.00
Shtator	839	3735	113.870.00
Tetor	825	3667	112.360.00
Nëntor	815	3589	111.950.00
Dhjetor	824	3681	113.130.00

Realizimi i punëve dhe detyrave në shërbimin e Skemës së asistencës sociale

Prioritetet	Aktivitetet e realizuara	Afatet	Resurset	Pengesat	Vërejtje
Angazhimi i nëpunësve të SNS-së në zbatimin e ligjit për SNS-në	Gjatë kësaj periode raportuese të gjithë NSNS-së janë angazhuar në implementimin e ligjit si dhe planit të punës për vitin 2023	Përherë	Ligji nr.2003/15 për skemën e ndihmës Sociale, Ligji nr.04/L-096 dhe ligjit 2003/15 me udhëzimet përcjellëse		
Zbatimi i kodit të etikës sociale në punë	Është zbatuar dhe respektuar kodi i etikës sociale	përherë	Kodi i etikës sociale		

Procedimi i kërkesave të reja për ndihmë sociale.	Të gjitha kërkesat e reja janë proceduar sipas afatit - 32 kërkesa të reja				
Procedimi i lëndëve me rastin e raiplikimit	Kërkesat për riaplikim janë plotësuar me kohë, me dokumentacion riverifikuar në terren.	përherë	Vetura zyrtare		
Vendosja e shënimeve në bazën e re të dhënave	Azhurnim i lëndëve sipas afatit, kanë proceduar shënimet për bazën e të dhënave.		Udhëzimi administrativ		
Procedimi i ankesave në komisionin e ankesave pranë DPSF	Janë përcjellë 49 ankesa, prej tyre dy (2) janë aprovuar, (43) refuzuar, në procedurë (3)				
Procedimi i lëndëve në komisionin mjekësor	Lëndët e kategorisë së parë janë proceduar në komision mjekësor sipas afatit ligjor.				
Raportimi dhe informimi DPSF dhe DSHMS	Raportimi i rregullt dhe sipas nevojës				
Detyrat shtesë nga Drejtori dhe	Stafi i SNS-së kanë kryer detyrat				

bashkëpunimi me stafin	e marra nga Drejtori i QPS-së				
Kërkesa për ndihmë të njëhershme	Janë paraqitur 2 kërkesa për ndihmë të njëhershme, janë aprovuara (njëra me 100 euro tjetra 300 euro)		QPS, DPSF		
Procedimi i lëndëve për Gjykatë (kthimi i pagesave të realizuar pa bazë ligjore)	Nuk është proceduar asnjë lëndë		DPSF		
Procedimi i lëndëve për kthimin e pagesave të realizuara pa bazë ligjore	Gjatë vitit 2023 gjithsej 35 familje kanë kthyer nga një pagesë të ndihmës sociale të realizuara pa bazë ligjore		QPS Udhëzimi administrativ Nr.08/2010		
Procedimi i lëndëve të Masës nr.15 për Gjykatë	Për zbatimin e Masës nr. 15 sipas Vendimit nr. 35/2020 të dt: 16.04.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ankimimit. Gjithsej pesë(2) lëndë me ankesa për Gjykatë		Vendimi nr.35/2020 i MFT		

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural - Raporti vjetor për vitin 2023

Në komunën e Drenasit, bujqësia po shndërrohet në sektor të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik, duke marr parasysh kushtet e volitshme si nga aspekti pedologjik po ashtu edhe nga ai klimatik.

Komuna e Drenasit ka për qëllim që të zgjerojë kapacitetet në zhvillimet bujqësore ku përmes saj do të hapën vende të reja të punës e po ashtu si qëllim kryesor do të jetë rritja e prodhimeve vendore dhe ulja e importit.

Sektori për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ka kryer këto punë:

- Përgatitja e raportit vjetor 2023 si dhe përgatitja e planit të punës për vitin 2024,
- Përgatitja e projekteve për vitin 2024,
- Këshillime fermerëve në të gjitha sektorët e bujqësisë,
- Regjistrimi në databazë i fermerëve aplikues për subvencione dhe përmbledhja e statistikave për secilin sektor,
- Këshillime rreth aplikimit të subvencioneve për pagesa direkte në sektorët e ndryshëm si dhe për aplikim për grante,
- Regjistrimi i fermerëve të rinj në regjistrin e fermës,
- Dhënia e certifikatave të fermerëve (NIF) si dhe informatat përcjellëse të fermerëve (ANEKS) për kërkesat e tyre,
- Janë pranuar aplikacionet e fermerëve për pagesa direkte për qumësht/litër sipas cilësisë dhe majmërisë së viçave për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2022, gjashtëmujorin e parë të viti 2023, aplikimi në sistem si dhe dorëzimi i aplikacioneve në MBPZHR-AZHB,
- Është bërë pranimi i kërkesave të ndryshme të fermerëve në sektorë të bujqësisë, shqyrtimi i kërkesave dhe kthimi i përgjigjeve,
- Punime në komisione të ndryshme,
- Takime në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë rreth subvencioneve të pagesave direkte-2023,
- Janë pranuar aplikacionet e fermerëve për pagesa direkte për vitin 2023, aplikimi në sistem si dhe dorëzimi i aplikacioneve në MBPZHR-AZHB,
- Takime më OJQ të ndryshme me qëllim përkrahjes të projekteve,
- Me kërkesën e zyrës së kryetarit janë dorëzuar të arriturat e drejtorisë gjatë vitit 2022,
- Monitorimi i Ambulacës Vetrinare “City Pet” e angazhuar nga Fondacioni StrayCoCo rreth trajtimit të qenve endacak,
- Është bërë thirrja publike në bashkëpunim me Islamik Relief Kosova për projektin e Makinave për Mbjelljen e Misrit,
- Është bërë thirrja publike në bashkëpunim me IADK-në për projektin “Përmirësimi i punësimit dhe mundësia për gjenerimin e të ardhurave në zonat rurale”,

- Janë dhënë këshilla fermerëve për plotësim të aplikacioneve, kompletimin e dokumentacionit për projektet e drejtorisë në bashkëpunim me OJQ-të,
- Janë bërë kërkesat për zotime për pagesa të faturave për shpenzimet e drejtorisë,
- Është punuar në planin gjithëpërfshirës komunal Janar- Qershor 2023,
- Përgatitja e raporteve mujore dhe dërgimi në Qendrën Informuese Këshilluese -QIK në MBPZHR-departamentin e shërbimeve këshillimore dhe teknike-DSHKT,
- Azhurnimi i lëndëve në mënyrë elektronike në kuadër të DBPZHR-së,
- Pjesëmarrje në hartimin e udhëzuesit administrativ më temën: Mbrojtja e fëmijëve nga punët e rrezikshme dhe të rënda në bujqësi dhe pylltari- projekt nga Ministria,
- Pjesëmarrja në trajnimin e organizuar nga MBPZHR-ja me temën forumi biznesor i boronicës në Kosovë,
- Pranimi i kërkesave të fermerëve që deklarojnë se sipërfaqet për të cilat kanë aplikuar për subvencione nuk kanë pasur mundësi që t'i mbjellin për shkak të kushteve klimatike dhe dërgimi i tyre në AZHB,
- Është bërë planifikimi dhe realizimi i mbjelljeve pranverore 2023 (të planifikuara 1880 ha, prej tyre janë realizuar 1729 ha) dhe raportimi i tyre në MBPZHR,
- Është bërë planifikimi dhe realizimi i mbjelljeve vjeshtore 2023-2024 (të planifikuara 2900 ha, prej tyre janë realizuar 2730 ha) dhe raportimi i tyre në MBPZHR,
- Shpërndarja e broshurave për fermerë në të gjithë sektorët e bujqësisë,
- Përgatitja rreth korrjeve, bashkëpunimi me MBPZHR, auto-kombajnerët, fermerët dhe pikat grumbulluese të drithërave në territorin e komunës së Drenasit,
- Është formuar komisioni që të bëjë përcjelljen dhe monitorimin e korrje-shirjeve në territorin e komunës së Drenasit,
- MBPZHR në bashkëpunim me drejtorit komunale ka dhënë si propozim çmimin 130 Euro për hektar për fushatën e korrje shirjeve (kjo nënkupton se çmimi mund të ndryshoj me marrëveshje në mes të fermerëve dhe auto kombajnerëve),
- Në bashkëpunim me MBPZHR-i mbështetur nga BE është mbajtur takim: “Ngritja e kapaciteteve në relacion me organizimin e tregut të përbashkët në BE dhe Statistikat Bujqësore”,
- Monitorimi i projekteve të viteve 2021, 2022,
- Monitorimi i projektit- vaksinimi e qenve shtëpiak 2023,
- Është punuar për zhvillimin e planit të integritetit për vitet 2022-2026,
- Është punuar lista e rreziqeve për vitin 2024.

Projekti nga Komuna në bashkëpunim me “Islamic Relief Kosova”:

- Furnizimi i fermerëve më makina për mbjelljen e misrit,
- Është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për bashkëfinancimin e projektit makina për mbjelljen e misrit në mes të komunës së Drenasit dhe “Islamic Relief Kosova”,

- Është bërë thirrja publike për projektin makina për mbjelljen e misrit,
- Dhënia e aplikacioneve për këtë projekt dhe pranimi i tyre,
- Komisioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar aplikacionet e fermerëve dhe ka rekomanduar për zyrën e kryetarit listën përfituese për marrjen e vendimit,
- Në këtë projekt kanë aplikuar 110 fermerë dhe kanë përfituar gjithsej 70 fermer,
- Projektet nga Komuna në bashkëpunim më IADK-në

- Furnizimi i fermerëve me pajisje për sektorin e blegtorisë

- Është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi tre vjeçare për bashkëfinancim në projektin “Përmirësimi i punësimit dhe mundësia për gjenerimin e të ardhurave në zonat rurale” ku këtë vit janë përkrahur fermerët blegtor,
- Nga IADK është bërë njoftimi për aplikim në këtë projekt, formimi i komisionit, pranimi i aplikacioneve, shqyrtimi dhe vlerësimi i aplikacioneve,
- Nga zyrtarët e DBPZHR janë dhënë këshilla fermerëve për plotësim të aplikacioneve si dhe pas kompletimit të aplikacionit është bërë pranimi i tyre dhe dorëzimi i aplikacioneve të komisioni shqyrtues,
- Në këtë projekt kanë aplikuar 17 fermer dhe kanë përfituar 14 fermer,
- Pajisjet që kanë përfituar fermerët blegtor janë laktofriza të kapaciteteve të ndryshme, makina mjelëse dhe bidonë,
- Trajnim dhe këshilla direkte për fermerët përfitues të këtij projekti i mbajtur nga IADK,
- Monitorimi i projektit të fermerët përfitues,

Projektet nga MBPZHR-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë

- Është bërë thirrja publike, aplikimi, kompletimi dhe dorëzimi në AZHB i lëndëve për pagesat direkte qumësht/litër sipas cilësisë dhe majmërisë së viçave për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2022 si dhe gjashtëmujorin e parë të viti 2023, aplikimi në sistem si dhe dorëzimi i aplikacioneve në MBPZHR-AZHB,
- Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2022 kanë aplikuar 51 fermerë ndërsa në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023 kanë aplikuar 53 fermerë për pagesat direkte qumësht/litër sipas cilësisë sipas kategorive: Ekstra klasë 0.07 €, klasa e parë 0.04€ , klasa e dytë 0.02 € ndërsa për majmëri të viçave subvencionimi për 1 krerë ka qenë 25 €,
- Është bërë informimi i fermerëve përmes thirrjes publike për aplikim rreth subvencioneve për pagesa direkte: grurë, sasi të grurit të dorëzuar në silose, mullinj ose pika grumbulluese, farë gruri, elb, thekër, misër, luledielli, vreshta, pemë, perime në serra, perime në fushë të hapur, lopë dhe buallica qumështore, dele, dhi, bletë, pula vojse, bimë aromatike, etj.

- Është bërë digjitalizimi i parcelave të mbjella me kultura të ndryshme, pranimi i të gjitha aplikacioneve të fermerëve që kanë aplikuar për pagesa direkte për subvencionime nga MBPZHR-AZHB, janë kompletuar dokumentacionet dhe janë dorëzuar në AZHB,
- Për pagesa direkte kanë aplikuar 1163 fermer në të gjitha sektorët e bujqësisë,
 - Subvencionimi i të mbjellave me grurë- është bërë digjitalizimi i parcelave prej 2631.63 ha, subvencionimi për 1 hektar 150 €, për plehërim 150 €/ha, për derivate/ha 54 €, si dhe 0.03€/kg të grurit të dorëzuar në mullinj, silose si dhe pika grumbulluese të licencuara (kriter është që fermeri të dorëzoj së paku 3000 kg),
 - Subvencionimi i të mbjellave me elb, është bërë digjitalizimi i parcelave 24.12 ha, subvencionimi për 1 hektar 150€, 54 €-derivate/ha,
 - Subvencionimi i të mbjellave me tërshërë, është bërë digjitalizimi i parcelave 77.04 ha, subvencionimi për 1 hektar 150€, 54 €-derivate/ha,
 - Subvencionimi i të mbjellave me misër, është bërë digjitalizimi i parcelave 2017.90 ha, subvencionimi për 1 hektar 175€, 100€-plehërim/ha, 54€-derivate/ha,
 - Subvencionimi i të mbjellave me thekër është bërë digjitalizimi i parcelave 2.40 ha, subvencionimi për 1 hektar 150 €, 54€-derivate/ha,
 - Subvencionimi i plantacioneve më pemë është bërë digjitalizimi i parcelave 184.04 ha, subvencionimi për 1 hektar 450€, 54€-derivate/ha,
 - Subvencionimi i perimekulturës është bërë digjitalizimi i parcelave 60.36 hektar, subvencionim për 1 hektar në fushë të mbyllur-serra 850€, në fushë të hapur 500 €/ha, kunguj 150 €/ha,
 - Subvencionimi i BMA-së është bërë digjitalizimi i parcelave 1.36 ha, subvencionimi për 1 hektar 450€, 54€ derivate/ha,
 - Subvencionimi i lopëve qumështore – fermerët kanë aplikuar për 1408 krerë lopë qumështore, subvencionimi për 1 krerë ka qenë 90€,
 - Subvencionimi i deleve qumështore – fermerët kanë aplikuar për 4863 krerë dele qumështore, subvencionimi për 1 krerë ka qenë 25€,
 - Subvencionimi i dhive qumështore - fermerët kanë aplikuar për 518 krerë dhi qumështore, subvencionimi për 1 dhi qumështore ka qenë 25€,
 - Subvencionimi i shoqërive me bletë- fermerët kanë aplikuar për 3686 koshere, subvencionimi për 1 koshere ka qenë 20 €,
 - Subvencionimi i pulave për vezë – fermerët kanë aplikuar për 27.000 copa pula për vezë, subvencionimi për një pulë ka qenë 0.50€,
 - Është bërë informimi i fermerëve për aplikim rreth subvencionimit të plehut artificial për 6 kulturat: grurë, farë të grurit, misër, patate, luledielli dhe fasule monokulturë si dhe për sasinë e grurit/kg të dorëzuar në pikat grumbulluese, silose, mulli apo pika tjera,
 - Pranimi i faturave të plehut dhe dëshmisë së grurit, aplikimi në sistem si dhe dorëzimi i tyre në AZHB.

Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Raport i punës për vitin 2023

Drejtoria ka vazhduar me dinamikën e punës në zbatimin e planit të punës, objektivave dhe qëllimeve të cilat i ka paraqitur kjo drejtori për vitin 2023. Veç punëve të përditshme të cilat rrjedhin si rezultat i kërkesave të qytetareve, DPUMM ka vazhduar punën në shqyrtimin e kërkesave për Legalizimin e objekteve pa leje, pajisjen e qytetarëve me leje të objekteve të kategorisë së parë dhe të dytë, mbjelljen drunjëve në qytetin e Drenasit, pajisjen me leje mjedisore dhe leje të tjera sipas kërkesës, vendosjen e shenjave para hyrjes së objekteve të banimit dhe të rrugëve në tërë territorin e komunës së Drenasit.

Gjatë këtij viti kemi pasur një numër të madh të shërbimeve që janë ofruar për qytetarë e komunës tonë, ku jemi angazhuar si drejtori në përmirësimin dhe lehtësimin e procedurave për aplikimin e lejeve, kërkesave të qytetarëve, investitorëve dhe përkrahjen e iniciativave për të pasur një planifikim të qëndrueshëm të qytetit. Në aspektin e planifikimit hapësinor dhe urban lëndët janë trajtuar brenda afatit ligjor, janë dhënë leje ndërtimi për objektet të cilat janë në harmoni me dokumentet e planifikimit hapësinor që janë të miratuara në Kuvendin e Komunës. Është hartuar edhe Plani Rregullues i Hollësishëm për qendrën e qytetit të Drenasit që është njëri ndër dokumentet me të rëndësishme.

Bazuar në ligjin për Trajtimin e Ndërtimeve pa leje janë shqyrtuar një numër i madh i lëndëve për objekte të ndryshme afariste dhe banesore të kategorisë së I-rë dhe II-të që janë ndërtuar pa leje, janë përgatitur Vendime për listë të Pritjes dhe Vendime për Certifikatë të legalizimit për objektet e ndërtuara pa leje në territorin e Komunës sonë.

Sa i përket punës në këtë vit nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit janë realizuar këto punë bazuar në shifra:

- Janë lëshuar 113 Certifikata – Vendime të Legalizimit
- Janë trajtuar 675 lende për legalizim për objekte të kategorisë I dhe II për objekte të ndërtuara pa leje dhe janë sistemuar në Listën e Pritjes;
- Janë lëshuar 8 certifikata-Vendime të Përdorimit;
- Janë hartuar 21 Vendime për ndërrim destinim të tokës;
- Janë dhënë 51 vendime për Leje Ndërtimore të Objekteve të kategorisë I dhe II;
- Janë hartuar 12 vendime për Leje Mjedisore;
- Janë hartuar 10 vendime për shfrytëzim të pronës;
- Janë hartuar 3 vendime të shndërrimit të objekteve banesore në objekte afaristë.

Sa i përket sistemit kontrollit të të dhënave për projektin e emërtimeve të rrugëve dhe futjen në sistemin ARIS janë realizuar këto punë:

- Vendosjen e 28 Shtyllave
- Vendosjen e 14 Tabelave në emërtim rrugësh;
- Vendosjen e 202 numrave të shtëpive apo para hyrjes së objekteve.

Drejtoria jonë ka qenë bartëse e projektit për gjelbërimin e qytetit ku është bërë mbjellja e një numri të konsiderueshëm të drurëve dekorativ si dhe mirëmbajtja e tyre.

Sa i përket planifikimit të të hyrave në DPUMM, vlera e planifikuar vitin 2023 ka qenë 75,000.00€, ndërsa realizimi në gjashtëmujorin e dytë të vitit është bërë në vlerën 183,170.95€ ndërsa shumata e përgjithshme e vitit në vlerën 366,059.94 € apo 488 %.

Sa i përket punëve të tjera të cilat zyrtaret e DPUMM janë angazhuar edhe në komisione të ndryshme duke përfshirë edhe Planin e Integritetit ku kemi qenë bartës të këtij procesi.

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Raport vjetor i punës - 2023

Përpilimi dhe hartimi i Raporteve të Punës nga Institucionet Komunale është prezantim i punës përballë transparencës dhe llogaridhënës ndaj qytetarëve tanë.

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka prezantuar në vazhdimësi punën e saj përmes raporteve javore e mujore, të cilat kanë pasqyruar ofrimin e shërbimeve gjeodezike e kadastrale për qytetarët dhe personat tjerë relevant dhe veprimet ligjore administrative për pronën publike duke dëshmuar njëkohësisht transparencën dhe llogaridhënien përballë përgjegjësive që i takojnë.

Raporti i Punës për gjashtë mujorin e parë për vitin 2023, vë në pah rritjen konstante të efikasitetit në ofrimin e shërbimeve kadastrale, gjeodezike ndaj qytetarëve, zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore gjatë përmbushjes së detyrave të punës, trajtimin profesional të kërkesave të palëve, kryerjen e shërbimeve në afat ligjor, ndërmarrjen e veprimeve konkrete për trajtimin e pronës komunale, rritjen e vazhdueshme të të hyrave vetanake, menaxhimin efikas të buxhetit të drejtorisë etj.

Misioni

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë është kompetente dhe përgjegjëse për organizimin e kapaciteteve kadastrale, rikonstruktimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informativ mbi tokën dhe pronën në përgjithësi, planifikimin e rrjetit gjeodezik me pika të reja kontrolluese dhe themelimin e pikave kontrolluese.

Misioni primar i saj është krijimi i një ambienti ligjor në sferën e kadastrit dhe pronës komunale.

Puna e drejtorisë orientohet që përmes matjeve kadastrale, sistemit informativ të tokës dhe regjistrave zyrtar të siguroj të drejtat mbi pronat e paluajtshme me krijimin e parcelave tokësore, ndërtesave si dhe përcaktimin e kufijve të tyre në komunën e Drenasit.

Qëllimi i drejtorisë është ofrimi i shërbimeve profesionale dhe shërbime të tjera subjekteve të ndryshme, përmirësimi i transferimit të tokës, menaxhimi i tokës komunale dhe efikasiteti në taksimin e tokave, evidencën për emërtimet e vendbanimeve, rrugëve, shesheve si dhe numrat e objekteve, shtëpive, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve etj.

Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronësi procedon shfrytëzimin e tokave komunale, zbaton vendimet e gjykatës për ndarje, bartje të pronësisë.

Ajo ka bashkëpunim të mirë me institucionet qendrore, konkretisht me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Agjencinë Kadastrale të Kosovës si autoritet qendror i menaxhimit të të dhënave kadastrale.

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ofron shërbime profesionale dhe shërbime të tjera në fushën e kompetencave dhe përgjegjësi të saj për subjektet e së drejtës dhe organeve shtetërore, dhe me një bashkëpunim të mirëfilltë arrijnë që t'i realizojnë punët e caktuara.

Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë është përgjegjëse për:

- a. zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve kadastrale, rrjetin referues homogjene, sigurimin e hartave Orto-Foto, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informative për tokën dhe pronën,
- b. sigurimin e zotërimit të tokës, reduktimin e kontesteve për tokën,
- c. përmirësimin e transferimit të tokës, menaxhimin e tokës shtetërore dhe efikasitetin në taksimin e tokave,
- d. planifikimin e rrjetit me pika të reja kontrolluese dhe themelimin e pikave të reja kontrolluese,
- e. digjitalizimin e pikave poligonale dhe trigonometrike, vektorizimin e planeve të skanuara (ngastrave dhe zonave kadastrale),
- f. azhurnimin e pjesës grafike në bazë të dokumenteve dhe matjeve të reja dhe transformimin me parametrat e dhëna për transformim,
- g. shërbimin e mirëmbajtjes së klasifikimit dhe kulturave të tokës,
- h. ndarjen e ngastrave dhe shënimin e kufijve në rastin e shpronësimit, dhe zhvillimin e procedurave.
- i. inspektimin e sipërfaqës së ndërtesave dhe përpunimi i skicave të ndarjeve për ndërtesa dhe banesa,
- j. regjistrimin e pronës së paluajtshme dhe regjistrimin e tokës komunale,
- k. zhvillimin e procedurës së regjistrimit, sipas detyrës zyrtare dhe kërkesave të palëve,
- l. korrigjimin e regjistrimit (RDPP) sipas procedurave dhe zbatimi i të gjitha dispozitat pozitive në fuqi, azhurnimin e pronës, në bazë të dokumenteve të verifikuara dhe shënimeve të tjera nga dokumentacioni arkivor, azhurnimin e regjistrimit të ndërrimeve të mjeteve nga terreni,
- n. kryerjen e procedurave rreth transaksioneve të pronës publike dhe kryerjen e procedurave të blerjes dhe shitjes së pronës për komunën,

- o. shqyrtimin dhe kryerjen e procedurave administrative për rikthimin e tokës pronarëve të mëparshëm,
- p. mbrojtjen e pronës komunale – publike dhe kryen procedurat lidhur me këtë çështje,
- q. vërtetimin dhe zbatimin e shitblerjes së pasurisë së patundshme,
- r. regjistrimin e ndërtesave kolektive dhe organizon mirëmbajtjen e pjesëve të përbashkëta të tyre,
- s. udhëheqjen me kadastrën etazh të banesave, ndërtesave, si dhe ngastrat kadastrale në të cilat janë të ndërtuara banesat,
- t. regjistrimin dhe çregjistrimin e hipotekave,
- u. aktvendimet mbi regjistrimin e servituteve, qirambajtjeve dhe barrëve të ndryshme,
- v. lëshimin e certifikatave personave që nuk kanë patundshmëri, ë. mirëmbajtjen, korrigjimin dhe harmonizimin e evidencave të vendbanimeve, fshatrave, shesheve, rrugëve dhe numrat e objekteve dhe ndërtesave,
- x. nxjerrjen e aktvendimeve për miratim ose refuzim të kërkesave,
- y. nxjerrjen e konkluzioneve për plotësimin e kërkesave të pakompletuara,
- z. përgatitjen e projektprogramit të punës për nevojat e Drejtorisë dhe raportin e punës,
- aa. kryerjen e punëve të tjera në pajtim me dispozitat ligjore (shpalljet publike, kërkesat për nevojat e Kuvendit, të gjykatave dhe të institucioneve tjera),
- bb. mbajtjen e shënimeve për tërë tokën dhe objektet, të cilat i posedon apo i shfrytëzon Komuna,
- cc. zhvillimin e procedurës së eksproprijimit, shpronësimit dhe deeksproprijimit të tokës në pronësi të Komunës,
- dd. trajtimin dhe zhvillimin e procedurës administrative për uzurpimet arbitrare të tokës në pronësi të Komunës.

Spektori i Gjeodezisë

Spektori i Gjeodezisë brenda kompetencës lëndore, kryen punët si në vijim:

-Shërbimet e mirëmbajtjes së klasifikimit dhe kulturave të tokës, -Ndarjen e parcelave, - Bashkimin e parcelave sipas kërkesës së palëve, Përpunimi i skicave të ndarjeve për ndërtesa dhe banesa, -Rilevimi i sipërfaqes së ndërtesave, -Përsëritja e kufijve të parcelës, -Shënimi i kufijve në rastin e eksproprijimit, -Identifikimi i ngastrave dhe objekteve kadastrale, -Nxjerr konkluzione lidhur me kërkesat e palëve,

Punët tjera gjeodezike

Ndërsa pas hyrjes në fuqi të udhëzimit administrative MMPH-NR 12/19 të dt.21.11.2019 Sektori i Gjeodezisë nuk kryen shërbime gjeodezike për prona private, por kryen shërbime vetëm për nevoja të Drejtorisë dhe Komunës- vetëm për prona komunale, dhe sipas këtij udhëzimi të drejta për kryerjen e shërbimeve Gjeodezike kanë vetëm Gjeodetët e Licencuar nga AKK.

Gjatë vitit 2024 sektori për gjeodezi në tërësi ka zbatuar punët e planifikuara për këtë periudhë të vitit ku me sukses kemi përfunduar këto planifikime.

Sektori i Gjeodezisë në vazhdimësi kryen të gjitha këto shërbime gjeodezike sipas ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi, si:

Është kompletuar dosja për elaborat për rrugën regjionale për Carralevë, me kërkesë nga Ministria e Mjedisit, Planifikimin Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Drejtoria ka vazhduar të bëjë azhurnimin e autostradës N9 në pjesën grafike dhe RDPP gati në të gjitha zonat të cilat janë jashtë masës komasative ndërsa autostrada që kalon në zonat kadastrale që janë në masën komasative kemi bërë azhurnimin vetëm në pjesën grafike ndërsa në pjesën tekstuale RDPP do të bëhet azhurnimi pas përfundimit të komasacionit.

Drejtoria e Gjeodezisë, Kadastër dhe Pronë ka qenë e angazhuar në ndarjen dhe bashkimin e parcelave të cilat parcela janë në listën e veçantë për tu dhënë në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite.

Gjatë gjashtë mujorit të dytë janë azhurnuar në pjesën grafike dhe janë future në sistemin RDPP parcelat të cilat kanë të bëjnë me rastin i Gjykatës Themelore Prishtinë- Dega në Drenas, si dhe rastin i Stacionit të Policisë në Drenas

Gjatë vitit 2023 Sektori i Gjeodezisë ka trajtuar kërkesat, si në vijim:

-Kërkesa për ndarje të parcelave kanë qenë 59 raste -Bashkim parcelave 1.208 raste -Modifikim i attributeve te parcelave 339 raste -Regjistrim të ndërtesave të legalizuara 105 raste - Koordinata dhe vektor 169 raste -Korrigjim kufiri të parcelave 39 raste -Kopje plani gjithsej 1.373 raste

-Gjithsej 18 përgjigje kemi kthyer për Gjykatën në Drenas, 37 përgjigje për Gjeodetë të Licencuar dhe 11 përgjigje për palë.

Sektori i Gjeodezisë është i ndërlidhur ngushtë me sektorin e kadastrit dhe është e pa mundur të funksionoj njëra pa tjetrën, të gjitha lëndët që fillojnë nga sektori i gjeodezisë dhe pas shqyrtimit dhe përpunimit të këtyre lëndëve aprovohen nga ky sektor dhe pastaj nga pala parashtrohet kërkesa në sektorin e kadastrit për t'i regjistruar në SIKTK-T.

Sektori i Gjeodezisë bashkëpunon me sektorin e pronës si në raste për definimin e pronave komunale, për përcaktimin e kufijve të parcelave, konstatime të ndryshme që janë të uzurpuara pronat dhe marrim pjesë gjatë lirimit të pronave komunale për t'i caktuar kufijtë e parcelave etj.

Përveç punëve që kemi në sektorin e gjeodezisë gjatë këtij viti kemi qenë të angazhuar edhe në komisione të ndryshme, si:

Komision për vlerësimin e dëmeve të shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore.

Komision për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore

Komision për dhënien e pronave komunale ne shfrytëzim më pak se një vit

Komision për krijimin e elaborateve në z. Kad. Nekoc

Ekipi Komunal për Hartimin e Planit të Veprimit për vitet 2023-2024 të SZHEL, i bazuar në dokumentin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024 (Drenas)

Monitorimi i futjes së të dhënave të komasacionit në sistemin RDPP dhe KADNAP.

Sektori i Gjeodezisë bashkëpunon edhe me Drejtoritë tjera për të ndihmuar në realizimin e projekteve, identifikimin e pronave komunale apo kërkesave të ndryshme.

Gjatë vitit 2023, kemi pranuar nga Drejtoritë e Komunës së Drenasit, 57 kërkesa të ndryshme të cilat janë kryer në një afat kohor të shpejt me qëllim që të ofrohet lehtësira për realizimin e projekteve të ndryshme që kanë ndikuar direkt në mirëqenien e qytetarëve.

Sektori i Gjeodezisë ka realizuar 39 kërkesa për Sektorin të Pronës të cilat kërkesa janë parashtruar nga administratorët e fshatrave që kryesisht kanë qenë kërkesa për lirim të rrugëve publike dhe pronave komunale.

Kërkesa të ndryshme ka pasur edhe në piketimin e rrugëve publike me qëllim që të bëhet asfaltimi i tyre dhe kërkesa të ndryshme për realizimin e kanalizimeve dhe kolektorëve.

Kërkesat janë realizuar edhe për drejtoritë, me përgjegjësi dhe përkushtim.

Sektori i Kadastrit

Brenda kompetencës lëndore, kryen punët si në vijim:

-Themelon regjistrin mbi pronën e paluajtshme, -Zhvillon procedurat e regjistrimit sipas detyrës zyrtare, -Zhvillon procedurat e regjistrimit sipas kërkesës së palëve, -Bën korrigjimin e regjistrimit sipas procedurave, -Zbaton të gjitha dispozitat pozitive në fuqi lidhur me regjistrimin e pronës, -Bën azhurnimin e pronës në bazë të dokumenteve të verifikuara dhe shënimeve të tjera nga dokumentacioni arkivor, -Bën azhurnimin e regjistrimit të ndërrimeve të matjeve nga tereni, -Nxjerr Aktvendime dhe Certifikata sipas ligjit mbi kadastrin dhe udhëzimeve administrative për kadastrin, -Nxjerr Aktvendime dhe Konkluzione lidhur me kërkesat e palëve, -Kordinon punët dhe zbaton udhëzimet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Gjatë vitit 2023, sektori i kadastrit ka kryer kërkesa të ndryshme si vijon:

Dhënja e certifikatave të pronës së paluajtshme

Dhënia e certifikatave që nuk posedojnë pronë
 Regjistrimin e shitblerjes së pronës së paluajtshme
 Modifikime attributeve të parcelës
 Modifikime të attributeve të pjesëve të ndërtesave
 Regjistrimin e ndarjeve të parcelave
 Regjistrimin dhe fshirjen e hipotekave etj.

Sektori i Kadastrit gjatë vitit 2023 ka pranuar, shqyrtuar, regjistruar këto kërkesa:

Lloji i shërbimit	Total
Bartja e posedimit - Ndarje fizike	59
Bartja e posedimit - Blerje	1277
Bartja e posedimit - Dhurim	412
Bartja e posedimit - Këmbim	12
Bartja e posedimit - Shpronësim	4
Bartja e posedimit - Trashëgimi	177
Bashkimi i parcelave	1208
Bashkimi i personave të njëjtë me ID të ndryshme	87
Fshirja e hipotekës pas skadimit të afatit	59
Fshirja e ngarkesës tatimore sipas vendimit të ATK	3
Fshirja e njësisë kadastrale	217
Krijimi i bashkëpronësisë	6
Krijimi i kopjes zyrtare te planit	1373
Modifikimi attributeve të ndërtesës	4
Modifikimi attributeve të parcelës	339
Modifikimi i attributeve të pjesës së ndërtesës	14
Modifikimi i të dhënave të personit pa njësi kadastrale	91
Modifikimi i të drejtave	539
Ndarja	403
Regjistrimi (krijimi) i parcelës së re	540
Regjistrimi i hipotekës	47
Regjistrimi i ndërtesës	105
Regjistrimi i ngarkesës tatimore	12
Regjistrimi i pjesëve të ndërtesës	12
Regjistrimi i posedimit të pronës shoqërore sipas detyrës zyrtare	32

Regjistrimi i qiramarrjes/nën qiramarrjes	11
Regjistrimi i servitutit	1
Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit	2
Regjistrimi i vërejtjes me vendim të gjykates	2
Regjistrimi i drejtës së shfrytëzimit	2
Shërbimi i të dhënave - nxjerrja e Certifikatës	2592
Shërbimi i të dhënave / Vërtetim që nuk posedon pronë	1436
Fletëpagesa nga intraneti	1952
Totali	13030

Sektorit të Pronës

-Zhvillon procedurat e shpronësimit të tokave në pronësi private për interesat e përgjithshme shoqërore, -Zhvillon procedurat e deekspropimit, gjegjësisht nulimit të aktvendimeve të plotfuqishme rreth shpronësimit në rastet kur plotësohen kushtet ligjore, -Kujdeset për mbrojtjen e të dhënave pronësore, ku bartës i së drejtës së shfrytëzimit është Komuna e Drenas-it, - Udhëheq procedurën administrative lidhur me uzurpimet arbitrare, -Mbanë evidence për lëndët e uzurpimeve, -Kujdeset për procedurat në përputhshmëri me ligjet në fuqi, -Kryen procedurat e eksproprijimit, -Nxjerr aktvendime, konkluzione lidhur me kërkesat e parashtruara, etj.

Në periudhën raportuese gjegjësisht nga muaj janar e gjerë në fund të muajt dhjetor 2023,

Në sektorin e pronës, janë kryer këto punë dhe detyra:

Në terren janë realizuar 70 kërkesa nga drejtorit e ndryshme të komunës si dhe nga administratorët e fshatrave.

Në zyre janë mbajtur takime me palë, si dhe janë kthyer përgjigje në kërkesat të cilat nuk ka pasur mundësi që të kryhen në teren.

Janë kthyer 13 përgjigje në kërkesa/ankesa.

Është bërë identifikimi i parcelave të pronave komunale në 7 raste, për të cilat dyshohet që janë të uzurpuara nga persona të ndryshëm, me objekte, rrethoja, parkingje, kulloso etj.

Kemi pranuar kërkesa për heqje dorë nga Pronësia dhe ti jipet Komunës gjithësejt 15, po ashtu edhe janë përpiluar Deklaratat e Mirëkuptimit dhe janë bërë regjistrimet në RDPP, dhe është bërë bartja nga prona private në emër të KK Gillogoc.

Janë nxjerrë 3 aktvendime për uzurpim.

Janë përgatitur të gjitha pagesat e kompensimit të pronarëve për pronave e shpronësuara, ku janë kompletuar 11 pagesa për banesat e shpronësuara në Drenas.

Janë në procedurë për shpallje të uzurpimit edhe 2 raste.

Të hyrat vetanake sipas programeve dhe fushave kryesore të të hyrave të planifikuara për vitin 2023- të hyrat për gjashtë mujorin e parë 2023, janë si më poshtë:

Taksa për regjistrim të pronës/pagesa për shërbime gjeodezike 83,977.00 euro

Taksa për fletë poseduese dhe kopje plani 19,450.00 euro

Është përfunduar futja e të dhënave të komasacionit në pjesën tekstuale RDPP dhe pjesën grafike KADMAP për 18 zona që janë në komasacion dhe të cilat nuk kana qenë të regjistruar pranë zyrës kadastrale në Drenas.

Lëndët e intranetit



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA GLOGOC - OPŠTINA GLOGOVAC - MUNICIPALITY OF GLOGOVAC



Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes

01/01/2023 - 31/12/2023, Drejtoria: DGJPK

Shkurtesa	Pershkrimi	Pranuar	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur Poshte	Pezulluar	Ceduar	Anuluar	Perfunduar	Totali
DGJPK	Drejtoria për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër	6	16	7,390	6	0	1	0	49	0	7,468
		6	16	7,390	6	0	1	0	49	0	7,468

Drejtoria për Infrastrukturë Lokale, Raport pune për vitin 2023

Drejtoria për Infrastrukturë Lokale, detyrat e punës i kanë kryer duke u bazuar në plan programin e punës, duke u mbështetur në Ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës, si dhe në bazë të detyrave e obligimeve të përcaktuara me Statutin e Komunës së Drenasit. Në bazë të detyrave që janë realizuar gjatë vitit 2023 zyrtarët e drejtorisë kanë përgatitur këtë:

Raport i punës për vitin 2023

Drejtoria për Infrastrukturë Lokale për realizimin e punëve të planifikuara bartin mbi vete shumë aktivitete në sektorin e Infrastrukturës lokale, duke filluar me hartimin e projekteve zhvillimore, kontraktimin e tyre, mbikëqyrjen e investimeve kapitale. Në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë paraqesim raportin e punës për vitin 2023 sipas sektorit :

Në sektorin e Infrastrukturës lokale jemi angazhuar si drejtori në përmirësimin e procedurave për aplikimin e lejeve, kërkesave të qytetarëve, investitorëve dhe përkrahjen e iniciativave për të pasur një planifikim të qëndrueshëm dhe realizim të projekteve kapitale. Gjithashtu janë shqyrtuar edhe kërkesa dhe ankesa tjera të palëve brenda afatit ligjor dhe me kohë i'u kemi përgjigjur dhe njoftuar palët për vendimet e marra në harmoni me ligjet ekzistuese.

Tabela e përgjithshme e lëndëve gjatë vitit:

N r	Emërtimi i kërkesave dhe shërbimeve	Pranuara	Aprovuar a	Të anuluar a	Refuzuar a	Në Proces	Hedhur Poshtë
1	Leje ndërtimi-projekte infrastrukture	1	1				
2	Pëlqime (për Infrastrukturë)	10	10				
3	Njoftime për lëndë të ndryshme(kërkesa, fatura, aktvendime)	744	744	7	16	1	7
	Totali:	755	755	7	16	1	7

Gjithashtu, janë trajtuar kërkesat për infrastrukturë rreth problemeve infrastrukture, etj. Klasifikimi, renditja dhe regjistrimi i lëndëve dhe projekteve të drejtorisë (të gjitha me numër dhe emër në databazën elektronike të krijuar në kuadër të drejtorisë).

-Kontrollimi i projekteve ideore dhe zbatuese në aspektin teknik profesional dhe dhënia e pëlqimit për hartimin e projektit zbatues.

-Hartimi i pëlqimeve të ndryshme për shfrytëzimin e objekteve infrastrukture

-Hartimi i pëlqimeve të ndryshme për kompani publike dhe private (Kompaninë e Ujësjellësit (KRU), Keds-it, Posta dhe Telekomit të Kosovës).

-Hartimi i aktvendimeve të ndryshme për mbikëqyrje dhe menaxhim të kontratës, pranime teknike të projekteve kapitale, përgatitja e raporteve të ndryshme për mbikëqyrje dhe pranimin teknik të projekteve kapitale në Komunën e Drenasit. Gjatë realizimit të projekteve kapitale që janë paraparë

për realizim gjatë vitit 2023 nga buxheti komunal, grantet dhe donacionet e ndryshme, ne si drejtori jemi angazhuar me tërë stafin që të realizojmë projektet kapitale dhe hartimin e planeve të nevojshme komunale. Janë kryer një numër i konsiderueshëm i projekteve zbatuese në konsultim me kompaninë projektuese. Projektet kapitale si: rrugët, trotuaret, ujësjellësit, kanalizimet, ura, mure mbrojtëse, gropa septike, kanale kulluese, ndriçim publik, pastrim i lumit, të cilat janë realizuar gjatë këtij viti janë sipas kontratave të kontraktuara. Në të njëjtën kohë kemi qenë të fokusuar edhe në rritjen e cilësisë së punës dhe në përgjithësi është e kënaqshme. Jemi angazhuar si drejtori që të kemi një performancë edhe më të mirë brenda mundësive dhe kapaciteteve profesionale që i kemi në dispozicion.

Projektet kapitale që janë realizuar gjatë vitit 2023:

LISTA E PROJEKTEVE TË REALIZUARA PËR VITIN 2023		
RRUGËT ME ASFALT DHE KUBËZA BETONI		
Nr.	Emërtimi i Projektit	Gjatësia e rrugëve të realizuara në m
1	RRUGË	
	Totali i përgjithshëm për Asfalt në m'	16,626.00m'
	Totali i përgjithshëm për zhavorr në m'	17,705.00m'
2	TROTUARET	
	Totali i përgjithshëm për Kubëza në m'	6,744.00m'
3	PARKINGJE	Sipërfaqja e parkingjeve të realizuara në m ²
	Totali i përgjithshëm për parkingje për asfalt në m ²	12,808.0 m ²
	Totali i përgjithshëm për parkingje për zhavorr në m ²	9,666.00m ²
4	KANALIZIMET	Gjatësia e kanalizimeve të realizuara në m'
	Kanalizimi Fekal dhe Atmosferik	2,200.0m'
	Rehabilitimi i kanalizimeve kontrata të lidhura	21,850.00 m'
5	KOLEKTORË	

	Total i përgjithshëm për Kolektorëve në m'	Gjatësia e kolektorëve të realizuara në m'
		350.00m'
6	UJËSJELLËS	
	Totali i përgjithshëm për ujësjellës në m'	Gjatësia e ujësjellësit të realizuara në m'
		3,067.50 m'
7	NDRIÇIM PUBLIK	
	Totali i përgjithshëm për ndriçim në m'	Gjatësia e rrjetit të ndriçimit publik të realizuara në m'
		89,130.0m'
8	LUMEJ, KANALE KULLUSE	
	Rregullim i shtratit te lumit dhe pastrim I tyre	Gjatësia e rregullimit dhe pastrimit të Lumit, përroskave realizuara në m'
		9,000.00m'
9	URA, TOMBINA	
	Rregullimi i urës, tombinave dhe mure mbrojtëse	5 tombina dhe 130.00 m' mure mbrojtëse

Hartimi i projekteve zbatuese

Hartimi i projekteve zbatuese “Ndërtimi i kapacitetit të ujësjellësit në Drenas”, “Asfaltimi i parkingut tek Qendra Tregtare në Drenas”, “Rregullimi i tregut në Drenas”, “Ndërtimi i rrugës Sankoc- Harilaq”, “Ndërtimi, zgjerimi dhe rikonstruktimi i rrjetit të kanalizimit”, “Zgjerimi i rrugës tek rreth-rrrotullimi në rrugën R102 në Drenas”, “Asfaltimi i rrugës Adem Mulaj, asfaltimi i parkingut dhe rregullimi i trotuarit në Drenas”, “Ndërtimi i rrugës Gjergjicë-Arllat”, “Rregullimi i infrastrukturës tek Parku i Pishave në Komoran- Fushticë” dhe “Ndërtimi, zgjerimi dhe rikonstruimi i rrethrrrotullimit në Komoran”.

Në këto projekte detale zbatuese janë paraparë zgjerimet e rrugëve, trotuare, ndriçim publik, rrjeti i kanalizimit fekal dhe atmosferik, rregullimi dhe asfaltimi i parkingjeve.

Gjithashtu kemi përgatitur me kohë listën me kërkesat dhe nevojat e qytetarëve për investime kapitale për vitin 2023, kemi pranuar me shkrim kërkesat e administratorëve të fshatrave për investime dhe i kemi paraqitur në kornizën afatmesme për planifikimin e buxhetit për vitet 2024-2026 para Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit Komunal. Jemi munduar ti japim prioritet projekteve të mbetura gjysmë dhe disa projekte që kanë qenë të domosdoshme. Në prioritet kemi vënë një numër të madh të ndriçimit publik, rehabilitimit të kanalizimeve, rrugëve, trotuareve dhe në krahasim me vitin që lamë pas sepse ishin edhe kërkesat e qytetarëve.

Projektet kapitale të përfituara nga donacionet me bashkëfinancim me komunën e Drenasit

Përveç projekteve që janë financuar me buxhetin e Komunës sonë me angazhimin e stafit të drejtorisë dhe me mbështetjen e kryetarit të Komunës në menaxhimin edhe të projekteve të financuar nga Ministria e Infrastrukturës. Projektet që janë financuar në Komunën tonë me ndihmën e granteve dhe donatorëve janë:

Asfaltimi i rrugëve nga memorandumet bashkëpunimit në periudhë 2 dhe 3 vjeçare të financuara nga niveli qendror:

Asfaltimi i rrugës Kroj i Mbretit deri tek Liqeni i Vasilevës- në proces

Asfaltimi i rrugës Transit Kroj i Mbretit-Drenas- në proces

- Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në vlerë prej 357,000.00€ (të planifikuara për vitin 2023 në shumë prej 57,000€ ndërsa vitet tjera 300,000.00€ për projektin:

1. Zgjerimi dhe asfaltimi i rrugës Vërboc, “lagja Dobra- përmendorja e Ilaz Kodrës”- projekti ka mbetur në fazën e rivlerësimit pas ankesave nga operatorët ekonomikë.

-Helvetas Swiss Intercooperation (DEMOS) në vlerë prej 905,811.86 Euro

(Granti i performancës 2021-të shpenzuara në këto projekte në shumën 400,973.90 sa ka qenë e alokuar për vitin 2023).

1. Rehabilitimi dhe Rikonstruktimi i rrugëve të asfaltuar në Drenas -

2. Ndërtimi i infrastrukturës (Asfaltim dhe kubëzim) Drenas I II III dhe IV-

3. Rregullimi i trotuarit dhe ndriçimit publik në komunën e Drenasit, Komoran, Arllat, Tërstenik, Dobroshec dhe Baicë.

- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Helvetas Swiss Intercooperation në vlerë prej 2,034,775.88€ (Granti i performancës- MAPL në shumë prej 916,388.80€ dhe DEMOS në shumë prej 1,118,387.08€ të shpenzuara në shumën € në projektin:

1. Ndërtimi dhe Zgjerimi i sheshit “Fehmi dhe Xhevë Lladrovci” Drenas

- Ministria e Zhvillimit Rajonal në vlerë prej 165,000.00€ të shpenzuara për projektin:

Rregullimi i parkut dhe shtigjeve për këmbësor çiklistë në parkun e Kamenicës, në Drenas.

Aktivitetet

Përgatitja e planit të prokurimit;

Përgatitja e planit të shpenzimeve për investime kapitale si dhe mallra-shërbim;

Përgatitja dhe dorëzimi i projekteve kapitale të komunës në Ministrinë e Infrastrukturës, MMPH, MAPL dhe donatorët;

Përgatitja e paramasave dhe parallogarive për projekte kapitale;

Përgatitja e dokumentacionit për tenderim të projekteve, deklarata e nevojave, kërkesave për të gjitha projektet e Drejtorisë për DIL.

Mbikëqyrja e punimeve gjatë realizimit të projekteve në teren;

Hapja dhe vlerësimi i tenderëve për projekte kapitale;

Hartimet e planeve të menaxhimit të kontratave, raporteve të kërkuara për pagesa nga mbikëqyrësit e projekteve kapitale ;

Përgatitja e platformës digjitale online të dhënave hapësinor në infrastrukturë (rrugë me asfalt dhe kubëza betoni, kanalizime, ujësjellësi, trotuare, ndriçim publik, hapje e kanaleve kulluese, rehabilitim i kanalizimeve, rregullimi dhe pastrimi i shtratit të lumit).

Përgatitja e detyrave projektuese për hartimin e projekteve zbatuese për projekte kapitale

Njoftime të ndryshme për palë rreth kompletimit të lëndëve;

Puna në komisione të ndryshme të caktuara nga Kryetari I Komunës dhe drejtorët e drejtorateve tjera si (komisioni për performancë komunale, komisione të pranimeve teknike të projekteve, komisione për rekomandim për leje mjedisore, komisione për procedura rekrutuese për pozitat e lira në Komunë, etj.).

Takimi me përfaqësuesit e Ujësjellësit Rajonal dhe punë kryesit për fillimin e punëve në rrjetin e ujësjellësit për fshatrat të komunës sonë.

Takim me përfaqësuesit e Postës dhe Telekomit të Kosovës për shtrirjen e rrjeteve të kablllove optike gjatë punimeve në qendrën e qytetit.

Përgatitja e raporteve të ndryshme për nevoja të drejtorisë sonë dhe drejtorive tjera të Komunës.

Pengesat dhe vështirësitë

Zyrtarët e drejtorisë, gjatë realizimit të mbikëqyrjes së projekteve janë ballafaquar me vështirësi të natyrave të ndryshme, ka pasur shumë pengesa nga banorët e zonave të ndryshme duke filluar nga uzurpimet e pronave dhe ngushtimi i rrugëve, moslejimi i realizimit të projekteve në pronat publike e private e deri te pengimi i realizimit të projekteve, si dhe në disa raste kanë ndikuar edhe në procedurat e prokurimit të stërzgjatura (vlerësimet e ofertave si dhe publikimi i kontratave). Gjithashtu duhet theksuar se për shkak të *inflacionit të çmimeve në vitin 2022* i cili ka ndikuar në rritjen e materialeve ndërtimore dhe ka zvogëluar sasinë, ku gjithashtu shkaktoi vonesa dhe pengesa në realizimin e projekteve të cilat ishin të kontraktuara në periudhën dy vjeçare 2021/2022 dhe që këto projekte janë bartur edhe në vitin 2023. Zyrtarët e drejtorisë tonë është dashur të marrin pjesë në çdo hapje dhe vlerësim të ofertave si dhe menaxhimin e mbikëqyrjen e punimeve në teren. Po ashtu kemi mungesë të veturave për dalje në teren për menaxhim të projekteve, takime dhe trajnime të ndryshme, sepse shumë herë kemi humbur ato për mungesë të veturës.

Problem tjetër është edhe mbikëqyrja e punimeve gjatë vikendeve nga ana e zyrtarëve të drejtorisë në mënyrë që të rritet cilësia në realizim të projekteve. Vlen të ceket edhe rrezikshmëria gjatë menaxhimit të kontratave sipas rregullores 08/2023 Shtesat për të punësuarit në sektorin publik.

Propozimet

Drejtoria për Infrastrukturë Lokale në fokusin e saj përmirësimin e infrastrukturës për mirëqenien e banorëve të Komunës dhe kjo do të arrihet duke pasur një planifikim të qëndrueshëm dhe realizimit të projekteve kapitale të cilat lidhen drejtpërdrejtë me infrastrukturën. Për të përmbushur misionin dhe vizionin e saj në drejtori, duhet të krijohen edhe disa parakushte për zyrtarët komunalë, të rritet numri i punëtorëve profesional, ka mungesë të inxhinierëve.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Raporti i punës
për Periudhën
Janar-Dhjetor
2023

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka realizuar në tërësi plan-programin e vet të punës në periudhën janar-qershor dhe ka kryer këto aktivitete:

Aktivitetet
kulturorë

Plani dhe programi i punës i DKRS-së për vitin - 2024

Përgatitja e raportit vjetor të DKRS për vitin - 2023,

Kërkesa fillestare buxhetore,

Aktivitete në Sektorin e Kulturës:

Takim individual më punëtorët e DKRS-së

Vlerësimi i punëtorëve për vitin 2022,

Manifestimi për 17 shkurtin Ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës filloi duke bërë homazhe tek të gjitha varrezat e dëshmorëve dhe martirëve në komunën e Drenasit, u mbajtur Seanca Solemne e Kuvendit,

Janë bërë homazhe në Kompleksin e Jasharajve më rastin e 25 vjetorit të sulmit nga forcat serbe ndaj familjes Jashari.

Është shënuar aktiviteti kulturorë i Sofrës Poetike “Ymer Elshani” 2023, në bashkëpunim me Karvanin e Shkrimtarëve “Agim Deva” .

Përgatitje e kërkesave fillestare për Buxhet të DKRS-së, 2023, 2024, 2025.

Në bashkëpunim me DKA-në kemi shënuar Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve-

“1 Qershori”, ku si DKRS kemi realizuar aktivitetin me fëmijët e Çerdhes “Ardhmëria”

Realizimi i Orës Letrare me shkollat e Drenasit në bashkëpunim me Karvanin e Shkrimtarëve “Agim Deva”

Me rastin e shënimit të 24 Vjetorit të Ditës së Çlirimit, qyteti ynë u dekorua me flamuj dhe Bilborda, më datë 12.06.2023, ndërsa më 14.06.2023 u mbajt Seancë Solemne e Kuvendit Komunal për të vazhduar me homazhe të shtatoret e heronjve në sheshin “Fehmi Lladrovci”, Komplekset Memoriale në Prekaz dhe Marinë si dhe homazhe tek të gjitha vend varrezat e dëshmorëve në komunën tonë.

Shënimi i muajt të Mërgatës.

Aktiviteti i realizuar “Kongresi i Manastirit”

Shënimi i festave të Nëntorit.

Zyra Administrative

Është mbajtur protokolli intern për Drejtorin, sektorët e DKRS-së (SHKA) ;

Janë përgatitur kërkesa për nevojat e DKRS-së dhe dërgimin e tyre për procedurat e pagesës,

Menaxhimi i kontratës për furnizim me letër,

Menaxhimi i kontratës “ Furnizim me Buqeta Lulesh të Freskëta për Homazhe”, plotësimin e procedurave në E- prokurim, përpunimin e planit të menaxherit, përgatitjen e lëndëve dhe procedimin për pagesë në Drejtoratin e Financave etj.

Përpunimin e lëndëve të DKRS-së në sistemin e Intranetit gjithsej 501 lëndë;

Menaxhimi i kontratës “Furnizim me inventar Lot I dhe Lot II”.

Operatori Teknik

Janë plotësuar formularët për masat detyruese për kursim të energjisë,

Kam punuar në Komisionin për pranimin e librave në Bibliotekën e Qytetit “Ymer Elshani” të Komunës së Drenasit.

Shërbim me mjete të zërimit në Aktivitete Komunale dhe DKRS-së, Akademi Përkujtimore, Aktivitete Kulturore, shërbim me zërim në Ditët e Shkollave të Komunës së Drenasit.

Përkrahja në promovimin e librit për dëshmorin “Bekim Xh. Hysenaj”.

Shërbim më mjetet e zërimit për aktivitetin e orës letrare, festës së Abetares.

Shërbimi me mjetet e zërimit për aktivitetin e 14 Qershorit ditës së Çlirimit, dhe promovimit të librit të autorit Hamzë Lladrovci.

Shërbim më mjete e zërimit për mbajtjen e Kongresit të Manastirit.

Shërbim me mjetet e zërimit për festat e Nëntorit.

Arkivi

Pjesëmarrje në komisionin e caktuar nga zyra e Kryetarit të Komunës, për Vlerësimin e pasurive jo Financiare në organet e Administratës së Përgjithshme të Komunës së Gllogocit për vitin 2022 dhe vitin 2023, vlerësimin e aseteve dhe përgatitjen e raportit përfundimtar, dërgimin ZKA, ZKF, DBF.

Pranimin e raporteve Narrative dhe Financiare nga OJQ-të përfituese të vitit 2022 , plotësimin e Formularit F20 të Raportimit të OJQ-ve, plotësimin e tabelave për OJQ-të dhe Individ, dërgimin DBF-së;

50 Lëndë të pranuar përmes Intranetit për arkiv, bashkëngjitjen e lëndëve përcjellëse, dhënien e statusit të lëndëve, përpunimin e tyre etj.

53 Kërkesa janë pranuar nga palët drejtuar arkivit historik Komunal; Janë lëshuar gjithsejtë:

11 Certifikata shkollore,

40 Njoftime për palët, dokumente për shtëpi, lokale afariste, kopje plani, fleta poseduese.

2 Palë kanë punuar për hulumtim Arkivor, Përgatitjen e materialeve nga zyrtari i arkivit për hulumtime për temë të masterit etj.;

Totali 53 palë që kanë marrë shërbime nga arkivi.

2 Kërkesa përmes e mailit zyrtar nga zyrtarja e Drejtorisë së Urbanizmit për të gjetur Gazetën Zyrtare nr. 20/1975, dhe përgatitjen e lëndëve kopje;

2 Vizita me karakter pune në arkivin historik të komunës së Skenderaj dhe të Klinës për tu njohur me punën e arkivave dhe bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet arkivave;

Një vizitë në arkivin e Drenasit kemi pas nga zyrtari i arkivit të komunës së Klinës së bashku me Drejtoreshën e DKRS-së dhe zyrtaren e Trashëgimisë Kulturore;

Përpunimin, skanimin e lëndëve të fondeve në vijim:

Fondit nr. 34 Këshillit Komunal për Financimin e Arsimit Shqip në Kosovë,

Fondit nr. 30 Drejtoratit për Administratë të përgjithshme dhe veprimtari Shoqërore

Fondit nr. 10 O.TH. Bujqësore “Agroprodukti”

Fondit nr. 9 BVI për Arsim dhe edukim fillor

Fondit nr. 31 Drejtoratit për Ekonomi e Financa

Fondit nr. 16 Drejtoratit të të Ardhurave Shoqërore; librit nr. 188 të vitit 1969 - 1970

Fondit nr. 48 Sekretariatit për Urbanizëm dhe punë Banesore përpunimi, evidentimi i lëndëve të fondeve arkivore: projekte, raporte me tabela statistikore, lista të pagave vendosjen e lëndëve, në kutit për ruajtje, vitet 1970 – 1997

Skanimin e gazetave zyrtare me rëndësi për komunën e Glllogocit të viteve 1975 – 1980,

18 Ditar, libra të amzave shkollore, libra të procesverbaleve të provimeve private të skanuara, të evidentuara në kompjuter me lista të suksesit të nxënësve të fondeve shkollore vitet: 1949 – 1985

Pranimin e një kërkesë përmes e mailit për grumbullimin e të dhënave për djegien, shkatërrimin e shkollave gjatë viteve 1998 – 1999 nga regjimi Serb, përgatitjen e materialit, dërgimin përmes e mailit zyrës së informimit;

Përgatitjen e raportit vjetor të punës së Arkivit historik të komunës për vitin 2023

Biblioteka

Me kërkesë të DKRS-ës kemi arritur të pasurojmë fondin e bibliotekave tona me libra të rinj të cilat janë dhuruar, donacion nga MKRS-ja.

Biblioteka	Dhuruesi	Titulli i veprës	Tituj	Exemp	2023
Drenas	MKRS	/	311	839	2023
Tërstenik	MKRS	/	214	1388	2023
Komaran	MKRS	/	273	1056	2023
Arllat	S'ka përfituar në mungesë të punëtorit	/	7	14	2023
Gjithsej			805	3297	2023

Bibliotekat; Drenas, Komaran, Tërstenik, Arllat për muajt; Janar-Dhjetor, 2023

Muaji- Janar- Dhjetor 2023	Nr. i ekzemp	Nr i titujve	i Ekzempl ar të ri	Tituj të ri	Libra të lexuara	Nr. i lexuesve	i Lexues të ri	Gjithsejt lexues
Drenas	10915	4461	869	311	383	246	30	273
Terstenik	4921	1592	1388	214	18	27	2	27
Komaran	5883	3072	1058	274	2630	525	44	525
Arllat	5168	961	14	7	1383	1305	40	1345
Gjithsejt	26,887	10,086	3329	806	4414	1830	116	2170

Rinia

Raporti Vjetor i punës i Zyrtarit të Rinisë për vitin 2023

- Ka bërë monitorimin dhe implementimin e vendimeve dhe komunikimin me OJQ-të.
- I angazhuar si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit me titullin “Fusha sportive dhe rekreacion Dritan, Llapushnik dhe Tërstenik II të cilat i ka inspektuar rreth punëve të realizuara.
- Takim pune me Auditorin për monitorimin e Subvencioneve të klubeve OJQ-ve.
- Ka prezantuar në mbajtjen e garave shkollore ne pingpong.

- Pranoi Aktvendim për komisionin e pranimit teknik “Ndërtim i stadiumit të qytetit –faza e dytë nr. kontratës nr.661-18-065-511.
- Menaxher i kontratës për Dekorimin e Qytetit për festat e fundvitit 2024 me numër 400/01-60406 .
- “Peace corpus counterpart conference” pjesëmarrës në Peace Corpus Kosovo.
- Takim pune me komisionin për zgjedhjen e sportistit për vitin - 2023.
- Inspektim i punimeve të kryera për Dekorimin e Qytetit në Drenas për vitin 2023.
- Përzgjedhja e sportistit në sallën e Kuvendit.
- Menaxher i kontratës Dekorim i Qytetit për vitin 2023.

Sporti

- Zyrtari i Sportit në bashkëpunim me SHFMU-të dhe SHML ka organizuar dhe zhvilluar garat në sporte të ndryshme sipas Kalendarit të garave të Federatës së Sportit Shkollor për vitin 2023, në lojërat si: 1.Pingpong; 2.Basketboll; 3.Futsall; 4.Volejboll; 5.Shah; 6.Hendboll; Në këto gara kanë marrë pjesë tridhjetë e dy(32) ShFMU dhe dy (2) ShML me gjithsej 1.300 nxënës pjesëmarrës.
- Në bashkëpunim me Shoqatën e Veteranëve të Edukimit Fizik dhe Sportit për nder të 17 Shkurtit 2023 ditën e Pavarësisë së Kosovës ka organizuar turnir me mësimdhënësit dhe sportistët veteran të Drenasit në sportin e Pingpongut dhe lojën e Shahut.
- Ka ndihmuar me shpërblime shumë turnire tradicionale memorial në futboll të vogël të organizuara për nder të dëshmorëve të kombit si: “Mehdi e Sylejman Bytyqi” Arllat; “Dëshmorët e Nekocit”; Nekoc; Turnirin për 14 Qershorin, ditën e Çlirimit të Komunës së Drenasit. Është ndihmuar me shpërblime për organizimin e turnirit në nivel të Kosovës Shoqata e Shurdhëve të Drenasit.
- Në Palestrën Sportive “Hysni Jetullahu”, ka monitoruar: garat e ShFMU-ve të nivelit Regional nga Federata e Sportit Shkollor në Volejboll, organizimin e Kampionatit të Kosovës Dhjetor 2023 në Shigjetari nga Federata e Shigjetarisë e Kosovës.
- Përgjigje ndaj kërkesave të ndryshme si zhvillimin e ndeshjeve kampionale, për Kupë dhe ndeshjeve miqësore nga klubet tona sportive dhe është dhënë përgjigja adekuate në bazë të ligjit për sport, Udhëzimeve Administrative dhe rregulloreve në fuqi.
- Zyrtari i Sportit është angazhuar për shënimin e Ditës Ndërkombëtare Olimpikë,
- Ka ndihmuar Ojq-Klubet Sportive në plotësimin e formularëve për subvencionim në sferën e Sportit, mbledhjet e kuvendeve të punës dhe Kuvendeve zgjedhore të mbajtura nga OJQ-klubet e regjistruara në DKRS.
- Ka përgatitë dhe mbajtur aktivitetin e Zgjedhjes së më të mirëve në lëmin e sportit të klubeve, individëve që kanë pasur rezultat gjatë vitit 2023.
- Zyrtari ka marrë pjesë në komisione të vlerësimit dhe shqyrtimit të ofertave për projekte të ndryshme si dhe komisione tjera. Inventarizimit të pasurive jo financiare, menaxhimi i kontratave në bazë të vendimit të kryetarit të komunës etj.

- Me datë 27.12.2023 është mbajtur evenimenti për zgjedhjen e më të mirëve në lëmin e Sportit, Sportisti i vitit 2023 u shpallën:
 Sportisti i vitit - Ibrahim Cervadiku futbollist K.F. Feronikli '74,
 Sportisti Perspektiv - Valmir Gllareva-Shigjetar KShigj.
 Qëndresa dhe Lea Selmani, Notare K.N.Ilirida;
 Klubi i vitit – KF.Feronikeli '74;
 Trajneri i vitit-Fehmi Bylykbashi KShigj. Qëndresa;
 Gjyqtar i vitit – Burim Zymeri – Volejboll;
 Punëtori sportive i vitit – Leutrim Krasniqi K.F. Feronikli '74;
 Mësimdhënësi i vitit – Zeqë Hasi-SHML Gj.K.Skënderbeu;
 Nxënësi i vitit – Dorinë Qorri-SHML Gj.K.Skënderbeu;
 Ndër dhjetë sportistët e vitit:
 Edi Dvorani- Shigjetar KShigj. Qëndresa;
 Luan Morina- Bokser-Klubi Boksit Drenasi;
 Lirigzona Bajrami-Volejbolliste, KV. Feronikeli(femrat);
 Siglinda Gashi- Volejbolliste, KV. Gryka(femrat);
 Leotrim Smakiqi-Futbollist KF. Fortuna;
 Erona Podrimqaku-Futbolliste K.F. Feronikeli (femrat);
 Mirsade Kuliqi-Shenjëtare e K. Të shenjtarisë Besim Mala-Murrizi;
 Mërgim Franca-Volejbollist K.f. Feronikeli (mëshkujt)

Përmbledhja e aktiviteteve në objektet sportive Janar- Dhjetor 2023

Muaj: Janar Dhjetor, 2023	Stërviçje	Orë	Numri lojtarëve	Shikues	Lojë Kampionale
Stadiumi Sintetik	1045	1681	23477	5835	145
Palestra Sportive	354	1181	9015	6424	73
Stadimu Rexhep Rexhepi	117	242	3094	3087	19
Gjithësejë	1516	3104	35596	15346	237

Objektiv e DKRS-së mbetet realizimi i planit në përpikëri për vitin-2024

Drejtorja e Inspeksionit, Raporti i punës Janar - Dhjetor 2024

<p>Menaxhimi, arritjet kryesore, performanca kyçe në periudhën janar-dhjetor</p>	<p>Drejtoria e Inspeksionit, punët dhe detyrat e punës për periudhën janar-dhjetor 2024 i ka kryer duke u bazuar në planin e punës. Gjatë kësaj periudhe është bërë edhe punë shtesë edhe jashtë orarit të punës posaçërisht gjatë muajit të mërgatës 20 korrik-20 gusht, ndërsa kompensimi është bërë me ditë të lira dhe në raste edhe me pagesë.</p> <p>Inspektorët vazhdimisht, kanë përpiluar raporte ditore të punës, ndërsa nga Shefi i Inspeksionit janë hartuar raportet javore si dhe raporti gjashtë mujor 2023 për punët e kryera në këtë Drejtori. Në vazhdimësi janë përcjellë dhe paguar të gjitha obligimet (faturat) për mallra dhe shërbime.</p> <p>Është hartuar buxheti kërkesat fillestare për periudhën 2024-2026 për Drejtorinë e Inspeksionit, si dhe zbatimin e planit të zotimeve dhe shpenzimeve për paga, mallra dhe shërbime për vitin 2024.</p> <p>Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 janë kryer punët nën mbikëqyrjet inspektuese si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Inspektimet në tregun me pakicë, pajisjen e subjekteve afariste me certifikata të biznesit (regjistrimi i bizneseve), inspektimet mbi blerjen, shitjen, çmimet, deklinacionin e mallit, mbrojtjen e konsumatorit, zbatimin e orarit të punës etj. • Inspektimet e ndërtimit në sektorin publik dhe privat rreth punimeve dhe pajisjes me leje të ndërtimit, si dhe ndalimi i punimeve të objekteve pa leje dhe marrja e masave të nevojshme. • Inspektimi rreth ndotësve të ambientit, djegies së mbeturinave, hamulloreve, lidhjet e kontratave me kompaninë për menaxhim të mbeturinave, inspektimi rreth ndotjeve me ujërave të zeza në zonat rurale dhe urbane. • Inspektimi i kompanive të transportit në komunikacionin rrugorë, taksitë ilegal, orari i udhëtimit, lejet e operimit, rendet e udhëtimit, stacionet, parkingjet etj.. • Inspektimi i mënyrës se shfrytëzimit të tokës bujqësore dhe mbikëqyrjes, nëse toka bujqësore shfrytëzohet për
--	--

Pasqyra e punës në shifra për periudhën janar-dhjetor 2024

<p>2024 për realizimin e prioriteteve</p>	<p>qëllime jo bujqësore. Inspektimi i barnatoreve bujqësore dhe produkteve të tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Inspektim për ruajtjen e hapësirave publike, mirëmbajtjen e parqeve, rrugëve dhe trotuareve, ruajtjen e pronës publike nga uzurpimet, inspektime rreth pajisjes me leje për shfrytëzim të hapësirave publike, etj. • Janë kryer edhe punë tjera sipas kërkesave të palëve dhe nevojave në terren.
<p>Nga lëmia e Inspektorit të Shërbimeve Publike</p>	<p>Nga lëmi i Inspektorit të Shërbimeve Publike:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Inspektimet rreth parandalimit të mbylljes së kanaleve kulluese të rrugëve të cilat e shkatërrojnë shtratin e rrugëve dhe trotuaret. • Inspektimet e pronave publike për mbrojtjen e tyre nga uzurpimet e ndryshme, pajisjet e tyre me leje për shfrytëzim, inspektim të rrjetit elektrik lidhur me ankesat e qytetarëve për vendosje të shtyllave nëpër pronat private, etj. • Inspektime të mirëmbajtje të shesheve dhe parqeve, drurëve dekorativ, ndërtimeve publike, etj. • Janë bërë rreth 60 inspektime, ku janë hartuar 23 procesverbale, 11 njoftime për palët dhe janë menaxhuar të gjitha lëndët në procedurë të rregullt.
<p>Nga lëmia e Inspektorëve të Tregut</p>	<p>Nga lëmi i tregut, konform Ligjit për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, Ligjit për Mbrojtje të Konsumatorit janë inspektuar subjektet afariste (mallrat bazike elementare ushqimore vaj, miell etj.), rreth përmbushjes së standardeve të vendosjen e tyre në treg, çmimet, deklaracionin e mallit, etj.</p> <p>Gjatë kësaj periudhe është inspektuar edhe:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në zbatim të Ligjit Nr. 08/L-018 dhe U.A. 03/2022 lidhur me tregtimin e derivateve dhe vendimeve të kohë pas kohe të MINT janë kontrolluar çmimet dhe tregtia me derivate të karburanteve. • Po ashtu janë inspektuar furrat e bukës, kontrollimi i përdorimit të njësive matëse dhe peshoreve në qarkullim. • Inspektimet e subjekteve afariste rreth regjistrimit të bizneseve. • Kontrolle rreth zbatimit të orarit të punës.

	<ul style="list-style-type: none"> • Inspektimi i sigurisë së produkteve ushqimore me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve. • Janë bërë 290 inspektime, ku janë hartuar 211 procesverbale, 43 aktvendime pëlqim për ushtrim të veprimtarisë, janë shqyrtuar 48 kërkesa të palëve dhe janë shqiptuar 9 gjoha mandatore në shumën prej 3,200.00 €.
<p>Nga lëmia e Inspektorit të Ndërtimit</p>	<p>Nga lëmi i ndërtimtarisë janë përcjellë në vazhdimësi ndërtimet rreth lejeve të ndërtimit dhe tërë dokumentacionin e nevojshëm, ndërtimet pa leje në prona private dhe publike. Gjatë kësaj periudhe raportuese janë inspektuar objekte të ndërtimit të kategorisë së I-rë dhe të II-të, mure rrethuese, rrethoja të ndryshme, rrugë të dëmtuara etj.</p> <p>Për të gjithë ata që nuk kanë respektuar urdhrat e inspektorit janë marrë masa ndëshkuese.</p> <p>Gjatë kësaj periudhe raportuese është bërë rrënimi i një objekti të ndërtuar në pronë publike me pronarë Infrakos-in të cilin rrënim e ka kryer vetë investitori pas ndërmarrjes së të gjitha masave nga inspektorati, është rrënuar një aneks i shkollës së vjetër në Llapushnik, me kërkesë të DKA-së me qëllim të adaptimit për qerdhe. Janë rrënuar dy objekte pa leje në pronë publike me qëllim lirim të pronës për ndërtim të objektit të gjykatës, si dhe është bërë largimi i pengesave në rrugë të vendosura pa leje nga DSHPE.</p> <p>Këto rrënime janë bërë nën mbikëqyrjen e DI dhe bartjen e shpenzimeve të rrënitimit i ka bërë kjo Drejtori.</p> <p>Gjatë kësaj periudhe është inspektuar edhe:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Inspektimi i ndërtimeve në pronën publike dhe private që përfshinë ngritjen instalimin, renovimin, zgjerimin, ndryshimin apo adaptimin e të gjitha strukturave ndërtimore. • Inspektimi i lejeve të ndërtimit • Inspektimi i dokumentacionit teknik (projektet ndërtimore, lejet ndërtimore). • Lëshimi i urdhër – masave dhe sanksioneve dhe përgatitja e vendimeve për ndërprerjen e ndërtimeve pa leje.
<p>Inspektime</p>	<p>1.130</p>

	<ul style="list-style-type: none"> Gjatë kësaj periudhe janë bërë rreth 255 inspektime, 55 Aktvendime për pezullim të punimeve me destinim të ndryshëm derisa të pajisen me leje, 35 urdhra për ekzekutim (në procedurë për konfirmim) të rrënimëve të objekteve pa leje, si dhe 38 gjoba mandatore në shumë prej 29,200.00 €
<p>Nga lëmi i Inspektorit të Mjedisit</p>	<p>Në lëmin e mjedisit gjatë kësaj periudhë Inspektori i mjedisit ka qenë i angazhuar rreth mbrojtjes së mjedisit nga ndotja, mbeturinat, zhurma e me theks të veçantë inspektimi rreth ujërave të zeza sidomos në zonat rurale sipas kërkesave të qytetarëve, pastaj hyrja e qytetarëve në sistem të menaxhimit të mbeturinave.</p> <p>Gjatë kësaj periudhe është inspektuar edhe:</p> <ul style="list-style-type: none"> Inspektimi i hedhjes së mbeturinave afër rrugëve, afër liqenit të Vasileves, parqeve dhe vendeve tjera publike. Inspektimi i largimit të mbeturinave inerte në vendet ku ka pasur ndërtime, Inspektim dhe identifikim i deponive ilegale në tërë territorin e komunës së Drenasit, Inspektimet sipas kërkesave të qytetarëve rreth kanalizimeve, ujërave të zeza, plehrave, etj. Inspektimi i Gurthyesve, dhe fabrikave të tjera që shkaktojnë ndotje në mjedis sipas kërkesave që kemi pasur; Punë të tjera inspektuese që bien në Drejtorinë e Inspeksionit, konkretisht në sektorin e Mjedisit. Gjithsejtë janë bërë 130 inspektime, 89 procesverbale, janë shqiptuar 10 gjoba mandatore me vlerë 2,620.00 €.
	<p>Inspektori i Komunikacionit është angazhuar konform Ligjit për Transportin Rrugor dhe Rregullores për transportin rrugor në territorin e Komunës së Drenasit ku problem i vazhdueshëm është edhe më tutje operimi i kombi-taksive (8+1).</p> <p>Për këtë Inspektori i komunikacionit së bashku me inspektorët e lëmive të tjera edhe me asistimin e PK-ës kanë zhvilluar aksione në parandalimin e punës së taksive ilegal dhe për këtë janë marrë masa ndëshkuese si gjoba mandatore, konfiskim të përkohshëm të automjeteve dhe tabelave të regjistrimit, etj. Janë inspektuar</p>

<p>Nga lëmi i Inspektorit të Komunikacionit</p>	<p>Opërorët Ekonomik-autobusët rreth respektimit të rendin të udhëtimit.</p> <p>Nga kjo lëmi është inspektuar edhe:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Inspektimi në komunikacionin rrugor të udhëtarëve të operatorëve ekonomik (autobusët, kombibusët, autotaksit). • Inspektimi i pajisjes së transportueseve me leje opërimi dhe orar të udhëtimit. • Inspektimi në stacionin e autobusëve, rrugë, parkingje etj, • Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës-Njësi të Drenas janë zhvilluar aksione për largimin e taksive ilegal (8+1) dhe të tjerave nga komunikacioni. Po ashtu mbulueshmëria me shënjim horizontal dhe vertikal. • Në kuadër të kësaj janë bërë 220 inspektime, janë hartuar 94 procesverbale, 44 aktvendime dhe janë përjashtuar apo konfiskuar, nga qarkullimi 44 automjete dhe tabela të regjistrimit, si dhe janë shqiptuar 27 gjopa mandatore në vlerë prej 4,100.00 €.
<p>Nga lëmia e Inspektorit të Bujqësisë</p>	<p>Inspektori i tokës bujqësore sipas planit të punës ka bërë mbikëqyrjen inspektuese rreth ruajtjes së tokave bujqësore dhe tokave në komasacionit. Në kuadër të kësaj është përcjellë që tokës bujqësore të mos i ndërrohet destinimi në teren pa u bërë paraprakisht ndërrimi i destinimit në kadastër.</p> <p>Nga kjo lëmi është inspektuar edhe:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Inspektimi i mënyrës se shfrytëzimit të tokës bujqësore dhe mbikëqyrjes nëse toka bujqësore shfrytëzohet për qëllime jo bujqësore. • Mbikëqyrjen dhe parandalimin e ndotjes së tokës bujqësore nga ndotësit • Inspektimet e barnatoreve bujqësore dhe kontrollimi i produkteve bujqësore (farërat, plehurat artificiale, preparatet për mbrojtjen e bimëve-PMB, materialet fidanore, pasurimi i miellit me hekur, etj.). • Inspektimi i tregut të gjelbër në Drenas rreth ekspozimit dhe shitjes së produkteve bujqësore brenda tregut.

	<ul style="list-style-type: none"> Gjithsejtë janë bërë 175 inspektime, ku në kuadër të kësaj janë hartuar 95 procesverbale, 10 aktvendim si dhe janë shqiptuar 3 gjoba mandatore në vlerë prej 1,500.00 €.
--	--

Procesverbale	683
Aktvendime për ndërprerje të punimeve	55
Aktvendime për konfiskim të tabelave dhe automjeteve	44
Aktvendim për ndërrim të destinimit dhe largim të materialit të fortë	10
Pëlqim për ushtrim të veprimtarisë	43
Gjoba Mandatore	87 (40,620.00 euro)
Draft-urdhër për ekzekutim	35
Rrenim të objekteve	4

Gjatë këtij viti ka pas bashkëpunim më shumicën e ministrive ku kemi respektuar vendimet dhe masat e marra nga qeveria. Inspektorët edhe gjatë këtij viti kanë inspektuar në mbarëvajtjen e “Muajit të Mërgatës”, por edhe vikendeve, kanë qenë në kujdestari varësisht prej nevojave të cilat kanë rrjedh si rezultat i dinamikës së punëve.

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Raporti i punëve të kryera gjatë vitit 2023

Arritjet/progresi/përformanca gjatë të vitit 2023

<p>Aktivitetet kryesore Janar - Dhjetor 2023</p>	<p>Në pajtim me nenin 17 pika f e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Drenasit, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, gjatë vitit 2023 është angazhuar që të realizojë punët dhe detyrat që kanë qenë të parapara me Plan programin e punës.</p>
<p>Aktivitetet për Ditën Ndërkombëtare të Tokës, Mjedisit dhe pastrimit</p>	<p>DShPE, me datë 22.04.2023 shënoi 22 Prillin - Ditën Ndërkombëtare të Tokës dhe më datën 05.06.2023 Ditën Botërore të Mjedisit (biodiversitetit)</p> <p>Në këto dy ditë mjedisore janë realizuar aktivitete të rëndësishme si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Pastrimi i hapësirave publike në Qendër të qytetit;</i> - <i>Mbjellja e Drurëve dekorativ në sheshin “Fehmi Lladrovci” dhe në parkun e qytetit.</i>
<p>Aktivitetet në fushën e menaxhimit të mbeturinave</p>	<p>Për të arritur objektivat Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave, përkatësisht aktivitetet që janë të parapara në këtë plan janë realizuar këto aktivitete:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Ka vazhduar procesi i shpërndarjes së shportave dhe rritja e numrit të shfrytëzuesve që ju ofrohet shërbimi i grumbullimit të mbeturinave nga KRM “PASTRIMI” me bashkëveprim me Inspektorin e Mjedisit. Ky proces në vazhdimësi është duke u realizuar dhe si rezultat i këtyre aktiviteteve gjatë këtij viti janë duke hyrë në sistem të menaxhimit të mbeturinave edhe disa ekonomi familjare, dhe biznese. Po ashtu është bërë edhe ndarja e komposterëve në disa fshatra.</i> - <i>Hartimi i Planit Komunal dhe Rregullores Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave, dhe njëherësh është bërë edhe miratimi i tyre në kuvendin e komunës dhe është kthyer ligjshmëria nga MAPL-ja ku është konfirmur se janë në pajtim me ligjet aktuale në fuqi lidhur me këtë fushë.</i> - <i>Hartimi i Raportit Vjetor për Mbeturina që është kërkuar nga Agjencia e Menaxhimit të Mbeturinave, ku do të jemi në garë për performancën për “Mjedis të Pastër”, nëse plotësohen kërkesat për qasje në këtë grant.</i>
	<p>Për realizimin e projekteve kapitale janë kryer këto aktivitete kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Hartimi i deklaratave të nevojave për projektet e DSHPE-së,</i> - <i>Hartimi i kërkesave për zotim të mjeteve,</i>

Aktivitetet
në realizimin
e projekteve
kapitale

- *Hartimi i projekteve ideore për secilin projekt,*
- *Hartimi i paramasave dhe parallogarive,*
- *Caktimi i menaxherëve për mbikëqyrjen e projekteve,*
- *Faza e implementimit të projekteve,*
- *Faza e pranimet teknik të projekteve.*
- *Gjate këtij gjashtë mujori janë realizuar projektet një vjeçare dhe ato që janë me kontratë kornizë, të cilat po i paraqesim si me poshtë.*
- **Rregullimi i rrethojave të varrezave në Komunën e Drenasit:**
Për këtë projekt janë kryer procedurat e prokurimit publik dhe është bërë rregullimi i varrezave në fshatin Tërstenik (lagja Gjoka dhe Dvorani), Komoran dhe Polluzhë)
- **Rehabilitimi i gropave në rrugët e asfaltuara (kontratë kornizë):**
Është bërë renvivimi i rrugeve të qenders se qytetit (rrugët “Ilaz Koda” dhe “Fehmi e Xhevë Lladrovci”, në Komoran, (rrugët “Shpëtim Robaj”, “Mentor Ibriqi” dhe “Avdullah Cakaj” dhe fshatrat Vërboc e Likoshan.
- **Riparimi dhe zgjerimi i vendndaljeve për autobusë dhe mbulimi i tyre:**
Është bërë rregullimi për dy vendndalje (stacione të autobusëve), në Llapushnik (lagja Thaçi) dhe Fushticë e Poshtme.
- **Zgjerimi dhe mirëmbajtja e kamerave në komunën e Drenasit:**
Është bërë rregullimi i defekteve për 15 kamerat e qytetit dhe është bërë vendosja e kamerave në NPL “Stacioni i autobusëve”
- **Mirëmbajtja dhe zgjerimi i ndriçimit Publik (kontratë kornizë):**
Ky projekt është duke u realizuar dhe bërë mirëmbajtja e ndriçimit publik në vazhdimësi, kryesisht kemi të bëjmë me ndërrimin e trupave ndriçues, ngjyrosjen e shtyllave të ndriçimit, lidhjen e kablllove aty ku ka dëmtime, ndërrim të kontaktorëve, fotocelulave, etj.
- **Blerja e kontejnerëve dhe shportave për mbeturina:**
Ky projekt është përfunduar dhe është bërë furnizimi me 5 kontejnerë me kapacitet prej 7 m³ dhe janë sjellë nga OE, të cilët i janë dhënë në shfrytëzim të përkohshëm, KRU “Pastrimi”, ku do të shërbejnë për ndarjen e mbeturinave në Deponinë Tranzite.
- **Shënjimi Vertikal dhe Horizontal i rrugëve (Kontratë Kornizë):**
Projekti i shënjimit vertikal dhe horizontal është duke u realizuar në të gjitha vendet ku kemi pasur kërkesa si: Shënjimi horizontal dhe vertikal i rrugëve në qendër të qytetit, parkingjeve, shënjimi vertikal për vendndalje të autobusëve, shënjimi horizontal në parkingun e taksive, kompletimi me shënjim vertikal tek rrugët ku takohen me hekurudhën, shënjimi horizontal dhe vertikal i zebrave në rrugët në qendër të Drenasit, dhe vendbanime tjera ku ka qenë e nevojshme, sidomos në rrugët që janë në afërsi të shkollave.
- **Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit dimëror për vitin 2022- 2023:**

Projekti ka filluar sipas sezonit dimëror dhe ka përfunduar sipas kontratës. Në këtë projekt kanë qenë të përfshira për mirëmbajtje dhe pastrim nga bora rreth 530 km rrugë dhe 26,405 m², sipërfaqe me parkingje, sheshe dhe trotuare, dhe është e lidhur kontrata kornizë me kompaninë “PASTRIMI”, dhe ka përfunduar kjo kontratë.

- Mirëmbajtja e rrugëve gjatë verës (projekt kornizë):

Ky projekt është duke u realizuar sipas kontratës, dhe OE, është duke bërë fshirjen dhe larjen e rrugëve në qytetin e Drenasit dhe në Komoran.

- Mirëmbajtja e kanalizimeve fekale dhe atmosferike dhe gropave septike (kontratë kornizë):

Ky projekt është duke u implementuar në gjithë territorin e Komunës, në bazë të kërkesave të ardhura nga administratoret e fshatrave, dhe detyrës zyrtare që është e paraparë me ligj për mirëmbajtje të ambientit (kanalizimeve atmosferike, fekale dhe gropave septike), të cilat po kryhen në mënyrën më të mirë të mundshme duke zhbllokuar kanalizimet të cilat me vite kanë qenë të pazgjidhura. Në këtë rast janë bërë deblokime të kanalizimeve me gypa duke filluar nga ata Ø (200, 250, 315, 400) (mm), dhe pastrimi i gropave septike dhe kanalizimit atmosferik, vendosjen e kapakëve metalik dhe atyre të betonit etj.

- Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të katërt me zhavorr:

Ky projekt është duke u realizuar varësisht nga kërkesat e Administratorëve të fshatrave.

- Mirëmbajtja e parqeve dhe gjelbërimi i qytetit të Drenasi (kontratë kornizë):

Ky projekt është duke u implementuar sipas paramasës dhe parallogarisë dhe njëherësh është duke vazhduar me punët si: pastrimi, fshirja dhe larja e sheshit, kositja e barit, prashitja e drurëve dekorativ, plehërimi, largimi i mbeturinave, krasitja dhe mbjellja e luleve.

- Projekti i eliminimit të deponive ilegale:

Janë eliminuar deponitë e egra sipas lokacioneve që janë identifikuar nga GIZ-i dhe zyrtarët komunal, gati në të gjitha lokacionet.

- Projekti për mirëmbajtjen e deponisë inerte në Llapushnik;

Ky projekt është projekt kornizë dhe është duke u mirëmbajtur nga OE, sipas kontratës, por duhet theksuar se shumë kompani të pa përgjegjshme po i hedhin mbeturinat e amvisërisë dhe atyre të marketeve në këtë deponi, andaj kërkojmë që të merren masa dhe kontrole me të shpeshta nga Inspektoret komunal, për të parandaluar këtë dukuri negative.

- Projekti për Intervenimet Emergjente (kontratë kornizë):

Ky projekt është realizuar në teren sipas kërkesave të adresuara nga qytetarët, si largimin e kafshëve të ngordhura dhe groposjen e tyre, vendosja e lëshesave në fytet e ngushta, dhe është përmblyllë si kontratë kornizë. Pas dhe njëherësh është dërguar për procedura të prokurimit dhe është në fazën e vlerësimit të ofertave.

- **Projekti rregullimit të trotuareve dhe parkingjeve:**
Është bërë riparimi i disa trotuareve në Drenas dhe Komoran, sipas vlerës së kontraktuar.
- **Rregullimi i tregjeve:**
Është bërë furnizimi me zhavorr në tregun e kafshëve në Komoran dhe është bërë shtrimi dhe rrafshimi dhe ngjeshja me zhavorr, duke krijuar kushte më të mira për punë në këtë treg.
- **Trajtimi i qenve endacak në komunën e Drenasit:**
Është hartuar paramasa dhe parallogaria dhe është lidhur një marrëveshje bashkëpunimi Fondacioni StrayCoCo/Stiftung Steinbüelëeg 8, CH-8332 Russikon nga Zvicra, dhe është bërë trajtimi i mbi 405 qenve endacakë, sipas marrëveshjes.
- **Projekti për Shërbimet e varrimit për qytetarët e Komunës së Drenasit:**
Ky projekt është duke u implementuar në bazë të shërbimeve të kryera nga Bashkësia Islame, i cili projekt ka ndikuar sa do pak në lehtësimin e familjeve në këto raste.
- **Eficienca e Energjisë:**
Pas aplikimit të komunës për 5 projekte në Fondin e Kosovës për Eficiencë të Energjisë të cilat projekte janë në listën e Planit komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë, ka filluar implementimi i 5 projekteve, në SHFMU si në: “Shaban Polluzha”-Polluzhë, “24 Korriku”-Fushticë e Epërme, “Migjeni”-Baicë, SHFMU “Shote Galica” - Abri, dhe AMF në Sankoc.

Ndarja e subvencioneve

- **Subvencione dhe Transfere:**
Janë bërë dy pagesa në bazë të vlerësimit të komisionit për vlerësimin e fatkeqësive natyrore dhe nga faktorët tjerë.

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave

- **Gjatë periudhës gjashtë mujore në adresë të DSHPE-së janë pranuar kërkesa dhe lëndë të natyrave të ndryshme, si vijon:**
 - 353 – kërkesa dhe lëndë të ndryshme siç janë:
 - kërkesa për mirëmbajtje të kanalizimit dhe gropave septike, të cilat janë realizuar dhe trajtuar të gjitha.
 - kërkesa për shënjim horizontal dhe vertikal të komunikacionit,
 - kërkesa për zhavorr për rrugët e rendit të IV,
 - kërkesa për renovimin e gropave të asfaltit,
 - kërkesa për zgjerim të ndriçimit publik,
 - kërkesa për parkingje të rezervuara,

- kërkesa për pastrimin e deponive ilegale të mbeturinave,
- kërkesa për rregullimin e rrethojave për varreza,
- kërkesa për kompensim të dëmeve nga FNFT
- kërkesa për furnizim me ujë higjienik dhe kërkesa të natyrave tjera të ndryshme.
- Të gjitha kërkesat janë shqyrtuar dhe sipas detyrës zyrtare ato që kanë qenë të realizueshme kanë përfunduar, ndërsa pjesa tjetër ose është refuzuar ose është ende në proces për shkak të mungesës së buxhetit, mirëpo u është kthyer përgjigje palëve.
- Janë bërë përgatitjet e kërkesave për pagesën e faturave për shërbimet komunale (Ndriçim Publik, ujë, Mbeturina, Energji elektrike, parkingje të rezervuara), dhe janë proceduar për pagesë.

Menaxhimi i Stacionit të Autobusve dhe parkingjeve publike

Kuvendi i Komunës ka formuar Kompaninë Publike “Stacioni i Autobusëve” Drenas, prandaj është hartuar Statuti i kësaj Kompanie, është zgjedhur Bordi i Drejtorëve dhe U.D i stacionit, por ende nuk është funksionalizuar. Po ashtu duhet theksuar që edhe pagat për punëtorët e SA, nuk janë realizuar pasi që është formuar si kompani Publike dhe duhet të operoj vet me buxhetin e krijuar nga të hyrat për peronizim.

Njësia profesionale e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit

DSHPE-ja në bashkëpunim të plotë me Njësinë Profesionale të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit (NJPZSH), gjatë kësaj periudhe pjesëmarrja ka qenë aktive në të gjitha rastet emergjente duke përfshirë të gjitha rastet e FNFT.

Intervenimet e NJPZSH-së ishin si në vijim:

- | | |
|--|-----|
| 1) Shuarje të zjarreve..... | 425 |
| 2) Vërshime | 24 |
| 3) Intervenime teknike..... | 22 |
| 4) Intervenime në aksidente rrugore..... | 9 |

Donacione të përfituara

Nga donacionet e fituara këtë vit vlen të përmendet, sjella një kamioni për bartjen e mbeturinave me kapacitet 8 m³, dhe kamionit Abroll, të cilët janë blerë me grantet e fituara për garën për Përformancë ”Mjedisi i pastër”, ku komuna vitin e kaluar ka fituar grantin për këtë garë, dhe të njëjtit i janë dhënë në shfrytëzim njësisë” KRM PASTRIMI” për kryerjen e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave.

Me nderime
Ramiz Lladrovci

